



RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

“Auditim i Përputhshmërisë dhe Rregullshmërisë Financiare”



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

<u>Nr .Përmbajtja</u>	<u>Faqe</u>
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3-8
HYRJA	8-13
Objektivat dhe qëllimi	8-9
Identifikimi i çështjes	9-10
Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	11-11
Përgjegjësitë e audituesve	11-12
Kriteret e vlerësimit	12-12
Standardet e auditimit	13-13
II. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	12-14
III. GJETJET DHE REKOMANDIMET	14-90
Pika 1 e Programit të Auditimit	14-27
<i>Auditimi i Zbatimi i rekomandimeve të auditimit të mëparshëm</i>	
Pika 2 e Programit të Auditimit.	27-32
<i>Auditimi i programimit dhe realizimit të të ardhurave doganore për periudhën e auditimit</i>	
Pika 3 e Programit të Auditimit	32-55
<i>Auditimi i sistemit të vlerësimit doganor dhe klasifikimit tarifor të mallrave</i>	
Pika 4 e Programit të Auditimit	55-60
<i>Auditimi i procedurave doganore të ndjekura nga sektori regjimeve doganore ekonomike.</i>	
Pika 5 e Programit të Auditimit	60-65
<i>Auditimi i borxhit doganor dhe masat e marra për zbatimin e tij.</i>	
Pika 6 e Programit të Auditimit	65-76
<i>Auditimi i procedurave mbi vendimet administrative të nxjerra nga Autoriteti Doganor Kompetent</i>	
Pika 7 e Programit të Auditimit	
Të Tjera	77-85
IV. REKOMANDIMET	85-90
ANEKSE	90-95
Komente dhe shpjegime nga subjekti i audituar	95-99
DOKUMENTE SHOQËRUESE	99-100

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Degën Doganore Rinas në bazë të programit të auditimit, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr.1347/1 datë 19.01.2018, nga data 18.01.2018 deri në datën 02.03.2018, për periudhën e juridiksionit të auditimit nga data 01.01.2016 deri në datë 31.12.2017 me lloj auditimi “*Auditim i Përputhshmërisë dhe Rregullshmërisë Financiare*” duke i kushtuar



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me realizimin e të ardhurave dhe zbatimin e legjislacionit doganor në Degën Doganore Rinas.

Qëllimi i auditimit ishte vlerësimi i pavarur i funksionimit të sistemeve të ngritura, procedurave të ndjekura nga Dega Doganore Rinas gjatë procesit të realizimit të objektivave në përputhje me legjislacionin në fuqi. Drejtimet e auditimit u përqëndruan në 7 pika auditimi të detajuara më konkretisht në pjesën e 3 (tretë) të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi dhe që u përqëndruan në sektorët dhe problematikat e konstatuara më parë në fazën paraprake planifikuese.

Në këtë auditim u angazhuan 3 (tre) auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Gjatë periudhës 01.01.2016-31.12.2017 është konstatuar se veprimtaria e Degës Doganore Rinas në drejtim të realizimit të të ardhurave doganore ka ardhur me një vijueshmëri në ulje të të ardhurave doganore për shkak të uljes së kapaciteteve deklaruese dhe importuese nga subjektet tregëtarë, por interesi i burimeve njerëzore të administratës doganore të këtij subjekti është përqëndruar në realizimin maksimal të këtyre objektivave.

Objektivat kryesorë të veprimtarisë së subjektit që u auditua konsistuan në rritjen e të ardhurave doganore, përmirësimin e shërbimeve kundrejt subjekteve të biznesit dhe individëve, ruajtjen e parimeve të barazisë gjatë procesit të vlerësimit doganor të mallrave, rritjen e transparencës me operatorët tregtarë, konstatimi dhe sanksionimi i veprimeve që krijojnë shkelje doganore me shmangie dhe mospagim të detyrimeve doganore.

Në përfundim të Raportit Përfundimtar të Auditimit u konstatuan të ardhura doganore të pallogaritura për të cilat janë rekomanduar rrillogaritje detyrimesh doganore dhe rekomandime për dhënie dhe ndjekje të destinacionit doganor për mallra të importuara me procedurë IMP5 për të cilat janë tejkalkuar afatet si dhe nuk është kërkuar procedura e verifikimit doganor të vlerave të transaktuara për periudhën nën juridiksion auditimi **në Buxhetin e Shtetit në shumën 9,527 mijë lekë**, nga të cilat **shuma prej 3,744 mijë lekë** të ardhura doganore të pallogaritura gjatë procesit të auditimit të procedurave të vlerësimit dhe klasifikimit doganor, **shuma prej 703 mijë lekë** gjatë procedurave doganore të nxjerrjes së vendimeve administrative, shuma e detyrimeve statistikore në vlerën **prej 4,752 mijë lekë** për mallra të hyra në regjime doganore IMP 5 sipas procedurave 5300 dhe 5500 dhe për të cilat janë tejkalkuar afatet autorizuese dhe nuk është dhënë akoma destinacion doganor përfundimtar dhe **shuma prej 328 mijë lekë** për ndjekje nga Dega Doganore Rinas për kryerjen e procedurave doganore verifikuese duke kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave verifikimin e plotë dhe të garantuar të klasifikimit tarifor të mallrave të përfshira në këto deklarime.

Auditimi u krye me zgjedhje, për vlerësimin e saktësisë së aktiviteteve dhe transaksioneve financiare, çështjeve që lidhen me organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, dhënia e opinionit për saktësinë e paraqitjes së zërave të aktivitetit dhe pasqyrave të tjera shoqëruese të bilancit, vlerësimin e saktësisë së informacioneve në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit ushtron veprimtarinë Dega e Doganës Rinas.

Në përfundim të procedurës audituese në këtë Raport Përfundimtar Auditimi për përmirësimin e situatës të konstatuar u rekomanduan **7 Masa Organizative** nga të cilat shuma **prej 5,080 mijë lekë** për ndjekje dhe zbatim nga Dega Doganore Rinas. Në këtë Raport Përfundimtar Auditimi janë rekomanduar **2 Masa Shpërblim Dëmi** në **shumën 4,447 mijë lekë**. Në përfundim të fazës së Raportit Përfundimtar të Auditimit u konstatuan problematika të ndryshme të cilat u përmblodhën në gjetje dhe rekomandime të klasifikuara sa më poshtë :



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	<p>Zbatimi i procedurave të sakta doganore në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave, klasifikimin tarifor dhe përfitimin e kushtit të trajtimit tarifor preferencial MSABE (reduktimit nga pagesa e tarifës doganore).</p> <p>I-Nga auditimi u konstatua se nga personeli përpunues doganor nuk janë rillogaritur të sakta elementët e vlerës doganore për efekt taksimi doganor që lidhen me vlerësimin doganor të disa mallrave për qëllime të vlerës doganore, janë deklaruar mallra të caktuar në mospërbushje të shpjegimeve të Nomenklaturës së Mallrave në RSH, raste të mospagimit të taksës kombëtare të ambalazhit plastik duke krijuar të ardhura doganore të munguara të rillogaritura nga grupi auditues dhe të rekomanduara në shumën 3,744 mijë lekë në këtë Raport Përfundimtar Auditimi për periudhën nën juridiksion auditimi nga data 01.01.2016 deri në datën 31.12.2017</p>	<p>Pika nr. 3 “<i>Auditimi i procedurave doganore të sistemit të vlerësimit doganor dhe procedura te tjera doganore</i>”. (trajtuar në faqet nr. 32-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)</p>	E lartë	<p>I-Dega Doganore Rinastë ndjekë të gjitha rrugët ligjore me qëllim analizimin dhe nxjerrjen e vendimeve administrative për kontabilizimin dhe më pas arkëtimin e detyrimeve doganore në shumën 3,744 mijë lekë përperiudhën nën juridiksion auditimi nga data 01.01.2016 deri në datën 31.12.2017 që lidhen me rillogaritje pagesash detyrime doganore në import për të cilat nuk është vepruar në përputhje dhe mbështetje të shpjegimeve të nenit 34 deri 37 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neneve 65-70 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 25 datë 16.05.2006 të DPD “Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore”, shkresës nr. 779 prot DPD datë 16.01.2013 “Mbi rishikimin e disa Indikatorëve shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE”,</p>
2	<p>Mosrealizim i të ardhurave doganore dhe masa të rekomanduara për përmirësimin e të ardhurave doganore.</p> <p>Nga auditimi i ushtruar mbi programimin dhe realizimin e të ardhurave doganore gjatë periudhës së audituar të viteve 2016 dhe 2017u konstatua se nga Dega e Doganës Rinas nuk janë realizuar të ardhurat doganore në krahasim me programimin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, duke krijuar një diferencë të përgjithshme në vlerën 239,029 mijë lekë të rezultuar gjatë viteve 2016-2017 në përmbushje të misionit që i janë ngarkuar sipas ligjit nr. 8449, datë 20.01.1999 “Kodi Doganor në RSH</p>	<p>Pika nr. 2“<i>Auditimi i të ardhurave doganore</i>”(trajtuar në faqet nr 27-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)</p>	Lartë	<p>Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas të marrë masa të plota ligjore e administrative me plane konkrete për të analizuar në mënyrë të përditësuar zbatimin e masave që janë marrë dhe që do të merren për realizimin e të ardhurave doganore sipas të gjithë zërave respektivë në përputhje të plotë me programimin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për përmbushjen e misionit që i është ngarkuar sipas ligjit nr. 8449, datë 20.01.1999 “Kodi Doganor në RSH” i ndryshuar dhe ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi i Ri Doganor në RSH” i ndryshuar, duke nxjerrë dhe përgjegjësitë përkatëse të stafit të doganor në përputhje me funksionet që ata kryejnë</p> <p>Menjëherë dhe në vijimësi</p>
3	<p>Zbatimin e legjislacionit doganor në përputhje me Ligjit nr.8449, datë 27.01.1999,“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i shfuqizuar.</p> <p>Nga auditimi i dokumentacionit për</p>	<p>Pika nr. 7“<i>Auditimi i procedurave doganore të indjekura gjatë marrjes së vendimeve administrative</i>”. (trajtuar në faqet nr. 65-76 të</p>		<p>Dega Doganore Rinas të kërkojë ndryshimin ose revokimin në rrugë ligjore për vendime administrative në shumën totale 703mijë lekë për raste vendimesh</p>



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

	<p>vendimet administrative të marra për shkeljet në fushën doganore për periudhën nën auditim rezultuan vendime administrative të nxjerra jo në përputhje me përcaktimet e nenit 107-112, 136-149, 256, 261, 273, 275 dhe 281/1 të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, dhe pikave 234-239, 272-325 dhe 463-472 të VKM nr. 205 datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar, në shumën totale 703 mijë lekë për raste vendimesh administrativë të nxjerra gjatë vitit ushtrimor 2016 dhe 2017.</p>	<p><i>Raportit Përfundimtar të Auditimit)</i></p>		<p>administrative të vitit 2016 dhe 2017 duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit me qëllim nxjerrjen dhe arkëtimin e detyrimeve doganore dhe gjobave doganore bazuar në ligjin nr. 8449, datë 20.01.1999 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe VKM nr. 205 datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar</p> <p>Menjëherë dhe në vijimësi</p>
4	<p>Mbi gjetjet që lidhen me veprimtarinë e subjekteve që operojnë sipas autorizimeve të regjimeve doganore ekonomike të konstatuara gjatë procedurës së nxjerrjes së vendimeve administrative.</p> <p>Nga auditimi i procedurave administrative të ndjekura nga Autoriteti Doganor Rinas u konstatua se dy subjekte “Reparti Ushtarak nr. 6640” me NIPT K51724025E dhe “Reparti Ushtarak nr. 3001” me NIPT K51723037A kanë tejkaluar afatet autorizuese për mallra të futura dhe të autorizuar brenda përcaktimeve të regjimeve të lejimit të përkohshëm. Nga Dega Doganore Rinas për deklarimet e regjimeve RLP që rezultojnë në shkelje të afateve autorizuese, janë vendosur sanksionet administrative deri në 100% të detyrimit doganor statistikor të deklaruar sipas deklaratave doganore respektive, bazuar në nenin 256 dhe 273 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Autoriteti Doganor Rinas pasi ka vendosur sanksione administrative ndaj operatorëve të autorizuar, nuk ka kërkuar dhënien e destinacionit doganor të ri doganor nga operatorët e mësipërm si dhe nuk ka ndërmarrë veprime të mëtejshme bazuar në nenin 83 dhe 160 të Kodit Doganor në RSH, me qëllim dhënien e destinacionit përfundimtar doganor për mallrat e hyra në territorin doganor shqiptar me deklarime doganore IMP5 sipas procedurave 5300 dhe 5500, sipas të dhënave të deklaratave doganore të pranuar me një shumë statistikore të detyrimit doganor në vlerën 4,752,118 lekë</p>	<p>Pika nr.4 “Auditimi i veprimtarinë e subjekteve që operojnë sipas autorizimeve ekonomike periudhës nën auditim” (trajtuar në faqet nr 88-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)</p>	E Mesme	<p>Dega Doganore Rinas në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, bazuar në nenin 83 dhe 160 të KD të vlerësojë situatën doganore të konstatuar sa më sipër, në funksion të afateve autorizuese të shkelura nga subjektet “Reparti Ushtarak nr. 6640” me NIPT K51724025E dhe “Reparti Ushtarak nr. 3001” me NIPT K51723037A, me qëllim kërkimin e dhënies së destinacionit përfundimtar doganor të mallit të autorizuar sa më sipër me një shumë statistikore të detyrimit doganor në vlerën 4,752,118 lekë sipas të dhënave të deklaratave doganore IM 5 me procedurë doganore 5500 dhe 5300. Gjithashtu të ndiqet nga nëpunësi doganor mbikëqyrës i autorizimeve doganor të regjimeve të lejimit të përkohshëm, dhënia dhe ndjekja përfundimtare e destinacionit të ri doganor të mallrave të përfshira në autorizimet e mësipërme, me qëllim mbylljen ose shtyrjen e procedurës doganore autorizuese në mbikëqyrje nga D.D.Rinas. t.</p> <p>Menjëherë dhe në vijimësi</p>
5	<p>Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm:</p> <p>Nga auditimi u konstatua se nuk rezultoi e zbatuar një masë për shpërbllim dëmi e rekomanduar më parë në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr. 1112/8 prot, datë</p>	<p>Pika nr.1 “Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm” (trajtuar në faqet nr 14-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)</p>	E Lartë	<p>Dega Doganore Rinas në cilësinë e organit administrativ juridiksional të analizojë rekomandimin e pazbatuar duke marrë masa të menjëhershme për analizimin e shkaqeve dhe përgjegjësi konkrete ligjore për moszbatimin</p>



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

	<p>31.03.2016, protokolluar pranë Degës Doganore Rinas me shkresën nr. 1084 prot, datë 05.04.2016 për subjektin “<i>Agjencia Kombëtare e Bregdetit</i>” me NIPT L41417451U për thyerjen e afatit të RLP-së është rekomanduar një detyrim doganor i papaguar në shumën 2,992,952 lekë dhe një gjobë sa një fishi detyrimit në vlerë 2,992,952 lekë, me një detyrim total të pazbatuar në shumën 5,985,904 lekë</p>		<p>e tyre. Nga Dega Doganore Rinas të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme verifikuese dhe administrative ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit me qëllim kontabilizimin e shumës prej 5,985,904 lekë rekomanduar më parë në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr. 1112/8 prot, datë 31.03.2016, protokolluar pranë Degës Doganore Rinas me shkresën nr. 1084 prot, datë 05.04.2016.</p> <p>Menjëherë dhe në vijimësi</p>
6	<p>Mbi gjetjet dhe rekomandimet që lidhen me veprimtarinë e Degës Doganore Rinas gjatë mbledhjes dhe arkëtimit të borxhit doganor</p> <p>Nga auditimi dhe analiza e borxhit doganor gjëndje deri më datë 31.12.2017, i krijuar gjatë viteve deri në periudhën e fundvitit 2017 u konstatua se nga autoriteti doganor kompetent Dega e Doganës Rinas nuk janë arritur të zbatohen plotësisht afatet ligjore të përcaktuara për rikuperimin e borxhit doganor, duke reflektuar një gjëndje borxhi doganor në fund të periudhës së audituar në vlerën 2,186,659 mijë lekë</p>	<p>Pika nr.5 “Auditimi i borxhit doganor, niveli i borxhit dhe analiza e tij dhe masat e marra për zbatimin e tij” (trajtuar në faqet nr 60-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)</p>	<p>Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinastë marrë masa të plota ligjore e administrative, për rikuperimin ose shuarjen e borxhit doganor të krijuar gjatë viteve 2009 deri në periudhën 31.12.2017 në vlerën 2,186,659 mijë lekë, si dhe të hartojë një program konkret me persona përgjegjës me afate kohore konkrete rikuperimi duke bashkëpunuar intensivisht me të gjitha institucionet e ngarkuara sipas ligjit për rikuperimin e borxhit si mësipërm bazuar në ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, indryshuar, Udhëzimin nr. 4, datë 07.04.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës</p> <p>Menjëherë dhe në vijimësi</p>
7	<p>Zbatimi i procedurave të sakta doganore në lidhje me përfitimin e kushtit të trajtimit tarifor preferencial MSABE (reduktimit nga pagesa e tarifës doganore).</p> <p>Nga auditimi u konstatua se nga personeli përpunues doganor nuk janë marrë në konsideratë përcaktimet ligjore të shpjegimeve të Udhërrëfyesit të MSABE “Mbi Rregullat e Origjinës Preferenciale të përdorura në tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe Vendeve të tjera sipas Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë” dalë sipas ligjit nr. 9590, datë 27.07.2006 për “Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit” duke mos dërguar për verifikim doganor Deklaratat Faturë dhe Dokumentet Eur I sipas praktikave të evidentuara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi</p>	<p>Pika nr.3 “Auditimi i procedurave doganore të sistemit të vlerësimit doganor dhe procedura të tjera doganore” (trajtuar në faqet nr. 32-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)</p>	<p>Dega Doganore Rinas të ndjekë të gjitha rrugët ligjore për analizimin e praktikave doganore të cituara në këtë Projektraport Auditimi me qëllim verifikimin e dokumentacionit tregëtar EUR.1 dhe Deklaratë Faturë të përdorur për përfitimin e kushtit të origjinës preferenciale MSABE dhe MTLTR pranë Autoriteteve Doganore Homologe sipas rasteve të përmendura në këtë Raport Auditimi për 3 (tre) raste pranë Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, të kërkojë dhe garantim të borxhit doganor që mund të lindë për deklarime doganore të evidentuara sa më sipër deri në përfundim të verifikimit që do të kryhet nga Administrata Doganore Shqiptare pranë Autoriteteve Doganore Homologe.</p>



IV.KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Konkluzionet dhe baza për opinionin mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërisë financiare (ISSAI 4100¹). Nga auditimi i përputhshmërisë², për sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat realizohet buxheti (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), në Degën Doganore Rinas, gjatë auditimit janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurat doganore të importit që lidhen me mosverifikimin e kushtit preferencial sipas marrëveshjeve në fuqi që lidhen me tarifën doganore të reduktuar, mosaplikimin e saktë të elementëve të vlerës së mallit për qëllime të vlerësimit doganor, klasifikime tariforë jo në përputhje me nomenklaturën e mallrave në RSH, mospërputhje me kuadrin ligjor në fuqi gjatë procedurave administrative të vendimmarrjes nga ana e autoritetit doganor, mangësi në procedurat e ndjekura për vjeljen e borxhit doganor.

Si konkluzion, nga auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Dega Doganore Rinas rezultoi se për një shumë totale popullate prej 5,206,378 mijë lekë të ardhurash doganore të arkëtuara për periudhën nën juridiksion auditimi, u konstatuan mospërputhje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (*kriteret*), me pasojë rrillogaritje të ardhurash doganore të munguara në vlerën totale prej 3,744 mijë lekë gjatë procesit të auditimit të procedurave të vlerësimit dhe klasifikimit doganor, shuma prej 703 mijë lekë gjatë procedurave doganore të nxjerrjes së vendimeve administrative, shuma e detyrimeve statistikore në vlerën prej 4,752 mijë lekë për mallra të hyra në regjime doganore IMP 5 sipas procedurave të lejimit të përkohshëm dhe për të cilat janë tejkaluar afatet autorizuese përdestinacion doganor përfundimtar dhe shuma prej 328 mijë lekë për ndjekje dhe kryerjen e procedurave doganore verifikuese deri në verifikimin e plotë dhe të garantuar të klasifikimit tarifor të mallrave të përfshira, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e *një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë*³.

Në Opinionin tonë, përveç mangësive të identifikuar më sipër dhe të trajtuara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi (të cilat janë materiale por jo të përhapura), informacioni mbi objektin dhe çështjet e audituara pranë subjektit Dega Doganore Rinas është në përputhje me aspektet materiale për të garantuar përputhshmërinë me aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë aktivitetin e këtij institucioni.

HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Degën Doganore Rinas në bazë të programit të auditimit, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 1347/1 prot datë 19.01.2018, nga data 19.01.2018 deri në date 02.03.2018, për

¹ISSAI 4100 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

²Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

³ISSAI 4000 - 4200 - Audituesi shpreh një konkluzion me rezerve kur në gjykimin profesional të tij, efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aq materiale sa që të justifikojnë një konkluzion të kundërt ose një refuzim të konkluzionit.



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

periudhën nga 01.01.2016 deri në 31.12.2017 me lloj auditimi “*Auditim i Përputhshmërisë dhe Rregullshmërisë Financiare*” i cili u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

- 1-Altin Dinaj
- 2-Livan Hoxha
- 3-Elida Kocani

Auditimi u krye me zgjedhje, për vlerësimin e saktësisë së aktiviteteve dhe transaksioneve financiare, çështjeve që lidhen me organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, dhënia e opinionit për saktësinë e paraqitjes së zërave të aktivitetit dhe pasqyrave të tjera shoqëruese të bilancit, vlerësimin e saktësisë së informacioneve në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit ushtron veprimtarinë Dega e Doganës Rinas.

Qëllimi i auditimit:

Qëllimi i auditimit është vlerësimi i pavarur i funksionimit të sistemeve të ngritura, procedurave të ndjekura nga Dega Doganore Rinas gjatë procesit të realizimit të objektivave në përputhje me legjislacionin në fuqi, vlerësimi objektiv, profesional e i pavarur i përputhjes së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare, me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe përcaktimet në marrëveshjet ndërkombëtare në lidhje me liritë dhe kufizimet në sistemin doganor, vlerësimi dhe evidentimi i shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike si dhe dhënien e rekomandimeve me qëllim dhënien e një sigurie objektive kësaj Dega Doganore gjatë veprimtarisë së saj nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë kryer në përputhje dhe rregullshmeri sipas legjislacionit në fuqi.

Objektivat e auditimit:

Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e sistemeve të ngritura, procedurave të ndjekura nga Dega Doganore Rinas gjatë procesit të realizimit të objektivave në përputhje me legjislacionin në fuqi janë

-Vlerësimi i realizimit të treguesve të të ardhurave, shpenzimeve, mënyrës dhe saktësisë në pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare dhe rakordimit me thesarin.

-Opinion në lidhje me përputhshmërinë e veprimtarisë në bazë të kërkesave të kuadrin rregullator për periudhën objekt i auditimit, sipas kriterëve të vlerësimit

Identifikimi i çështjes :

Veprimtaria përpunuese e personelit doganor të Degës Doganore Rinas është realizuar në mbështetje të Ligjit nr. 8449 datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”; Ligji nr. 8474 datë 14.04.1999 “Për miratimin e Nomenklaturës dhe të Tarifës Doganore”, i ndryshuar dhe VKM-se nr. 205 datë “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” dhe Ligjit nr. 61, datë 24.05.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Veprimtaria e Degës Doganore Rinas realizon kontrollin dhe përputhshmërinë e deklarimeve dhe procedurave të kryera nga operatorë ekonomikë sipas legjislacionit të fushës. Gjithashtu përgatitja dhe miratimi i pasqyrave financiare në Degën Doganore Rinas, është realizuar në mbështetje të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” i ndryshuar, dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi, në funksion të këtij ligji. Pasqyrat financiare janë dorëzuar brenda afateve të parashikuara në ligjet dhe aktet nënligjore të sipërcituarasi edhe shoqërohen me relacion shpjegues (si lista e debitorëve, akt-rakordimet me sistemin e Thesarit, si edhe shpjegime të tjera sa i takon evidentimit të transaksioneve në llogaritë respektive)



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

Përgjegjësia e Drejtimit për Përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi dhe Pasqyrat Financiare:

-Kryetari i Degës Doganore (*Nëpunësi autorizues*) është përgjegjës për veprimet dhe vendimet e nxjerra gjatë veprimtarisë funksionale e rregulluar kjo me përshkrimin e dhënë në “Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore”, miratuar me shkresën nr. 19095/2 prot, date 12.11.2012 në zbatim Ligjit nr. 8449 datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”; Ligji nr. 8474 datë 14.04.1999 “Për miratimin e Nomenklaturës dhe të Tarifës Doganore”, i ndryshuar dhe VKM-se nr. 205 datë “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” dhe Ligjit nr. 61, datë 24.05.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe urdhërave , udhëzimeve dhe shkresave të dala në mbështetje të legjislacionit doganor,

-Specialist i Financës (*Nëpunësi zbatues*) është personi përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare.

-Personeli përpunues doganor i sektorëve operacional (*nëpunës zbatues*), të kontrollit të Terminalit të Pasagjerëve në aeroportin e Rinasit (*nëpunës zbatues*), personeli përpunues doganor i sektorit operacional (*nëpunës zbatues*), i kontrollit të zyrës Cargo të përpunimit të mallrave në aeroportin e Rinasit (*nëpunës zbatues*) përfshirë edhe personelin doganor që mbikëqyr dhe përpunon deklaratimet e operatorëve që kanë përfituar autorizime doganore ekonomike RPA, Magazina Doganore dhe regjime RLP pranë zyrës Cargo, specialisti i sektorit të kontrollit pas zhdoganimit (*nëpunës zbatues/kontrollues*), juristi/specialisti borxhit (*nëpunës zbatues*) , janë përgjegjës për veprimet e kryera gjatë veprimtarisë funksionale e rregulluar kjo me përshkrimin e dhënë në “Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore”, miratuar me shkresën nr. 19095/2 prot, date 12.11.2012 në zbatim Ligjit nr. 8449 datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, Ligji nr. 8474 datë 14.04.1999 “Për Nomenklaturën dhe Tarifën Doganore”, i ndryshuar dhe VKM-se nr. 205, “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” dhe Ligjit nr. 61, datë 24.05.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe urdhërave, udhëzimeve dhe shkresave të dala në mbështetje të legjislacionit doganor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Përgjegjësia e Audituesit të KLSH për auditimin Përputhshmërisë dhe Rregullshmërisë Financiare

Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar

-Të vlerësojë nëse informacioni mbi çështjen në të gjitha aspektet materiale është në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi dhe në ç’masë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara (*ISSAI 4100*), të krijohen bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare dhe Raportimit Financiar. Në këtë funksion, auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne si auditues t’i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për përputhshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimeve të ndjekura nga subjekti i audituar ,për faktin nëse pasqyrat financiare, nuk kanë gabime materiale, pra pasqyrat në tërësi nuk përmbajnë gabime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi.

-Të kryejë në mënyrë efektive auditimin (*ISSAI 1300*)



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

-Të vlerësojnë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në këtë evidence ai mund të formojë konkluzionet përkatëse. (ISSAI 1500, ISA 300).

-Të kryeje procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objekti.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion u konsiderua i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Projekt Raporti i Auditimit.

Kriteret e vlerësimit:

-Ligji nr. 8449 datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

-Ligji nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”;

-Ligji nr. 8474 datë 14.04.1999 “Për miratimin e Nomenklaturës dhe të Tarifës Doganore”, i ndryshuar;

-Ligji nr. 8485 datë 12.05.1999, Ligji nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

-Ligji nr. 61, datë 24.05.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

-Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin”, i ndryshuar dhe akte të tjera nënligjore në funksion të tyre.

- Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

-Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar nga Ministri i Financave (2010);

-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”.

Marrëveshjet e Republikës së Shqipërisë me vendet e tjera të EU apo NEU lidhur me trajtimin preferencial të mallrave etj.

Standardet e Auditimit

Auditimi u bazua në:

-Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.2015, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit si:

-Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë. Referencë në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISAI) të IFAC

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit mbështetur në ISSAI 1315.

Metodat dhe teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit konkluduan në metodologjinë e aplikuar gjatë planifikimit në auditimin e të dhënave të siguruar nga vetë subjekti. Objektivi i audituesve ishte identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale që konsistoi në vlerësimin e kontrolleve të brendshëm në institucion sa i



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Vlerësimi i kontrollit të brendshëm u krye nëpërmjet testeve të kontrolleve.

1.1. Kontrolli aritmetik që konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).

1.2 Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

1.3. Kontrolli i vlerësimit për të përcaktuar nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

2-Verifikimi i transaksioneve duke marrë informacion shtesë nga burime të tjera verifikuese

3-Intervistimi i personelit që ka pasur role specifike në subjektin që u auditua.

4-Raporte dhe informacione nga shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve që lidhen direkt me objektivat e auditimit.

5-Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm lidhje me informacionet e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm të subjektit

6-Pyetsorët sipas teknikës së grumbullimit të të dhënave në rastet kur veprime të caktuara kanë karakteristika të ngjashme dhe janë të përsëritura në struktura të ndryshme të organizatës.

7-Modelimet statistikore në formën e serive kohore mbi shpenzimet e pagesave dhe treguesit përkatës

PERSHKRIMI I AUDITIMIT.

Dega Doganore Rinas është një njësi funksionale që varet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave e cila është nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Financave në Republikën e Shqipërisë. Dega Doganore Rinas është e vendosur në Aeroportin “Nënë Tereza” në Rinas si dhe kryen veprimtari mbikëqyrëse doganore në zonën e aeroportuale të lejuar nga koncensionari “TIA”. Dega Doganore Rinas ka në përbërjen e saj një administratë të vogël prej 35 persona të punësuar. Dega Doganore Rinas e ushtron veprimtarinë e vet sipas 2 sektorëve operacionalë nga të cilët, 1 sektor operacional në zonën e aeroportuale të aeroportit Rinas, 1 sektori operacional me personel përpunues të kontrollit dokumentar dhe regjim/akcizë/preferencë/përjashtime pranë sektorit të zyrës CARGO të cilët kryejnë përmbushjen e operacioneve përpunuese të magazinës Cargo, strukturave të tjera funksionale si specialist/jurist që mbulon veprimtarinë e ndjekjes së borxhit, veprimtarinë juridike dhe kryen njëkohësisht, specialisti i Kontrollit Pas Zhdoganimit. Administrata e Degës Doganore Rinas funksionon sipas rregullores së Brendshme të Degëve Doganore me nr. 19052 prot DPD date 11.02.2011. Dega Doganore gjatë veprimtarisë së aktivitetit të saj përmbush vizionin e shërbimit doganor të afruar nga Administrata Doganore Shqiptare në gjithë territorin doganor shqiptar **me qëllim:** “sigurimin mbrojtjen e interesave të Republikës së Shqipërisë, që kanë të bëjnë me importet, eksportet dhe transitet e mallrave, pavarësisht nga mënyra e transportit, lidhur me dërgesat ndërkombëtare, me kalimin në pikat kufitare dhe me qarkullimin e lire të mallrave, të personave dhe të bagazheve të tyre kryerjen e të gjitha veprimeve të përcaktuara në Kodin Doganor për mallrat në hyrje dhe në dalje të territorit



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

doganor shqiptar, verifikimin dhe vjeljen e detyrimeve doganore qe duhen paguar, parandalimin, verifikimin dhe luftën ndaj veprimtarisë kontrabande, shkeljeve dhe trafikut te paligjshëm te mallrave te ndaluara, konstatimin dhe verifikimin e shkeljeve te dispozitave te këtij Kodi, te parashikuara ne pjesën VIII, mbikëqyrjen ne te gjithë territorin doganor te Republikës se Shqipërisë te mallrave qe i nënshtrohen mbikëqyrjes se autoriteteve doganore”.

Dega Doganore Rinas kryen funksionet zbatuese, përpunuese dhe autorizuese te deleguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe legjislacioni doganor në fuqi si më poshtë:

Përpunon, ndjekë, mbikëqyrë dhe autorizon deri në çlirimim e mallrave dhe përfundimin e procedurave deklarimet e subjekteve operatorë ekonomikë dhe personave fizikë gjatë procedurave deklaruese që kryhen me qëllim pagesa të detyrimeve doganore dhe procedura të tjera autorizuese që kryhen në veprimtarinë e saj të përditshme .

Harton dhe nxjerr akte administrative me fuqi ligjore të cilat kanë pasoja juridike mbi operatorët ekonomikë dhe palë të tjera të përfshiratë cilët konstatohen në shkelje te parashikuara në pjesën VIII të Kodit Doganor në RSH, për vepra dhe mallra që i nënshtrohen mbikëqyrjes së autoriteteve doganore”.

Ndjek me të gjitha format e parashikuara nga legjislacioni doganor në fuqi vjeljen e detyrimeve doganore nga subjektet debitorë të kontabilizuar më parë nga administrata doganore vetë Dega Doganore Rinas dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe përfaqësohet në procese gjyqësore në lidhje me ankime gjyqësore të ndryshme

Komunikon me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për probleme që lidhen me juridiksionin e çështjeve dhe problemeve të ndodhura në juridiksionin e territorit doganor mbikëqyrës të Degës Doganore Rinas. Harton dhe miraton dokumentacion kontabël për njësinë, kryejnë shpenzime dhe blerje të nevojshme sipas kërkesës, hartojnë dhe përpilojnë pagat e punonjësve dhe të tjera.

Në lidhje më realizimin e treguesve financiarë konstatohet se:

Të ardhurat doganore për vitin 2016 të realizuara nga kjo degë doganore paraqiten në shumën 2,673,484 mijë lekë kundrejt 2,777,000 mijë lekë të planifikuara, duke realizuar më pak të ardhura në masën 103,516 mijë lekë ose realizim në masën 96%.

Realizimi të ardhurave 2016

(në 000 lekë)

Nr	Te ardhura doganore	Planifikuar	Realizuar	Diferenca	Realizimi në %
1	Taksa Doganore	112,408	110,349	3,922	103%
2	TVSH	2,604,164	2,557,207	-52,937	98%
3	Akciza	54,522	5,919	-48,603	11%
4	Renta Minerare	5,906	8	-58,98	0%
	Shuma	2,777,000	2,673,484	-103,516	96%

Të ardhurat doganore për vitin 2017 të realizuara nga dega e doganës paraqiten në shumën 2,532,894 mijë lekë. Të ardhurat janë realizuar më pak nga planifikimi në masën 135,528 mijë lekë ose ato janë realizuar në masën 95%.

Realizimi të ardhurave 2017

(në 000 lekë)

Nr	Te ardhura doganore	Planifikuar	Realizuar	Diferenca	Realizimi në %
1	Taksa Doganore	118,819	112,937	-5,882	95%
2	TVSH	2,544,889	2,401,854	-143,035	94%
3	Akciza	4,696	18,077	13,381	385%
4	Renta Minerare	18	26	8	144%
	Shuma	2,668,422	2,532,894	-135,528	95%



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

Gjatë periudhës së audituar viti 2016 dhe 2017 konstatohet se Dega e Doganës Rinas nuk i ka realizuar të ardhurat doganore në total dhe në strukturë në zbatim të programeve të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, duke krijuar *një diferencë në të ardhurat doganore në vitin 2016 në vlerë 103,5016 mijë lekë, ose në masën 96% dhe diferencë në realizimin e të ardhurave doganore gjatë vitit 2017 në vlerën 135,528 mijë lekë, osenë masën 95 %*, veprim i cili tregon për punën e pamjaftueshme që ka kryer autoritet doganor kompetent, lidhur me përmbushjen e njërit prej misionëve më të rëndësishme që i ka ngarkuar atij “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”.

Objekt i këtij auditimi është auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare të subjektit Dega Doganore Rinas, përgjatë vitit ushtrimor 2016 dhe 2017. Qëllimi i auditimit në Degën Doganore Rinas ka qenë vlerësimi objektiv, profesional e i pavarur i përputhjes së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare, me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe përcaktimet në marrëveshjet ndërkombëtare në lidhje me liritë dhe kufizimet në sistemin doganor, vlerësimi dhe evidentimi i shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar si dhe shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 4100, ISSAI 4000 dhe ISSAI 1315)³ është dhënia e opinionit dhe hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Fushëveprimi i auditimit ka qenë auditimi i procedurave të deklarimeve doganore të importit dhe eksportit, rreth 93,000 deklarime doganore (pesha të vogla specifike të shërbimeve postare përfshirë gjithë procedurat import–eksport) për periudhën 2016-2017 rreth 3 aktivitete dhe procedura me veprimtari autorizuese të rregjimeve doganore ekonomike, rregjime doganore ekonomike të lejimit të përkohshëm, rreth 170 akte dhe vendime administrative të nxjerra nga Autoriteti Doganor për vitin 2016 dhe 2017 dosje të subjekteve debitorë për periudhën 2016-2017, të ardhura doganore për periudhën 2016-2017, realizimi faktik dhe i planifikuar si dhe pasqyrat financiare të subjektit për periudhën nën auditim 01.01.2016-01.12.2017.

GJETJET DHE REKOMANDIMET

🚩 Drejtimi i parë i auditimit “*Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm*”.

Në zbatim të pikës 1 të Programit të Auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë :

Në zbatim të pikës 1, të programit të auditimit nr. 1347/1, datë 19.01.2018, u shqyrtua dokumentacioni i paraqitur nga autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas si më poshtë:

1. *Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet e dërguara nga KLSH-ë me shkresën përcjellëse nr. 1112/8 prot, datë 31/3/2016, protokolluar në doganë me nr. 1084 prot, datë 05.04.2016.*

2. *Informacionet e paraqitur nga Zyra Jurist/Borxhit, Sektori Cargos (Vlerës), Zyra Aposteriori, Zyra e Financës dhe Zyra e Rregjimeve, lidhur me masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH-së.*

3. *Evidenca e borxhit doganor gjendje më 31.12.2015, në strukturë.*



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

4. Evidenca e të ardhurave doganore, të realizuara gjithsej për vitet 2014-2015.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm u konstatua se:

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas nuk i ka zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna nga KLSH-ë në auditimin e mëparshëm, të cilat vijnë si pasojë moszbatimit të plotë të legjislacionit doganor e veçanërisht disa nga dispozitat kryesore të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, kryesisht nenet 11, 23-27, 28, 29-31, 32, 33-40, 216-227, 245, 256-280, kërkesat e vendimit të KM nr. 205, datë 13.04.1999 “Për miratimin e Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar, kërkesat e udhëzimit nr. 25 datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhënat e disponueshme, si dhe zhdoganimin e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit”, si dhe udhëzimet nr. 6, datë 23.07.2013 dhe nr. 4, datë 07.04.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave “mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës.” Nga auditimi i ushtruar mbi dokumentet e paraqitura nga Zyra Jurist/Borxh, Zyra Aposteriori dhe Zyra Protokoll-Arkivit, pranë Degës së Doganës Rinas për masat e marra lidhur me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në auditimin e mëparshëm dërguar me shkresën përcjellëse nr. 1112/8 prot, datë 31.03.2016, protokolluar nga Zyra e Protokoll-Arkivit pranë doganës, me nr. 1084 prot, datë 05.04.2016. Kontrolli i Lartë i Shtetit në zbatim të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenet 10, 15, 25 dhe 30, ku janë përcaktuar kompetencat, të drejtat dhe detyrat, përgjegjësitë, rekomandimet dhe ecuria e zbatimit të tyre për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen ka kërkuar zbatimin e masave të miratuara me vendimin nr. 25, datë 31.03.2016 të Kryetari të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas, në vijim të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, me qëllim realizimin e detyrave të lëna ka nxjerr Urdhërin e brendshëm nr. 1084/1, datë 25.04.2016, i cili u është dërguar të gjithë sektorëve doganorë të atakuar në këtë raport që;

-“të shqyrtojnë dhe të rishikojnë të gjitha rekomandimet e KLSH-së, duke i parë rast pas rasti problematikat që mbulon secili, lëna detyrë për tu zbatuar sipas rekomandimeve të KLSH-së”

-“secili sektorë të shprehë mendimin e tij për çdo problematikë që mbulon të lënë detyrë nga KLSH-ja, duke dërguar informacion me shkrim tek Kryetari”

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas referuar Raportit Përfundimtar të KLSH-së, në përmbushje të kërkesave të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe kërkesat e vendimit nr. 25, datë 31.03.2016 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, ka nxjerr urdhërine brendshëm nr. 1486, datë 09.05.2016 me të cilin ka urdhëruar zbatimin 11 rekomandimeve të përgatitur për zbatim deri më 30.06.2016 nga Zyra e Financës dhe Zyra Juridike.

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas në vijim të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, me qëllim realizimin e detyrave të lëna ka nxjerr Urdhërin e brendshëm nr. 1900, datë 17.06.2016, i cili u është dërguar të gjithë sektorëve doganorë të atakuar në këtë raport auditimi;

- Në këtë urdhër janë përcaktuar detyra specifike për çdo sektorë lidhur me administrimin e shkeljeve doganore nëpërmjet përgatitjes së procesverbaleve përkatës bazuar në dokumente dhe të mbështetura në ligj. Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, me shkresën përcjellëse nr. 1112/8 prot, datë 31.03.2016, të Urdhërit të brendshëm nr. 1900, datë 17.06.2016, në mbështetje të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i RSH-së”, të VKM-së nr. 205, datë 13.04.1999



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

“Për miratimin e Dispozitive Zbatuese të Kodit Doganorë”, ndryshuar me VKM nr. 919, datë 29.12.2014 “Për miratimin e dispozitive zbatuese të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me qëllim marrjen e masave të plota për shqyrtimin, analizimin dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja, të cilat deri në këto moment nuk janë zbatuar, për këtë arsye është nxjerr urdhëri i brendshëm nr. 2198 prot, datë 18.07.2016 ku është përcaktuar;

1. Ngritja e grupit të punës me përfaqësues të Sektorëve dhe Zyrave doganore sa më poshtë;
-Sektori i Kargos, z. Artan Bicprendi dhe Ilir Rustemi, Sektori i Terminalit të Pasagjerëve, z. Baftjar Kazia, Besnik Cenko, Alma Pulake dhe Përparim Tollia, Specialistja e Kontrollit Aposteriori, zj. Angjelina Kallpi dhe Juristi Kushtrim Elezaj.

2. Grupi i punës të shqyrtojë rast pas rasti rekomandimet e lëna nga KLSH-ja.

3. Grupi i punës mbas verifikimit dhe analizimit të rekomandimeve të lëna, të përgatisë Relacionin Përfundimtar me propozimet përkatëse për Kryetarin e Degës së Doganës, brenda datës 29.07.2016.

4. Në këtë urdhër janë përcaktuar dhe masat e marra nga autoriteti doganor kompetent për shmangien e konfliktit të interesave nëpërmjet ndryshimit të vendeve të punës nga një sektorë në tjetrin dhe anasjelltas.

Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën përcjellëse nr. 1112/8 prot, datë 31.03.2016, protokolluar nga Zyra e Protokoll-Arkivit pranë doganës, me nr. 1084 prot, datë 05.04.2016, ka dërguar raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimet përkatëse si më poshtë;

1. Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas me shkresën nr. 1084/2 prot, datë 25.04.2016 ka informuar Kontrollin e Lartë të Shtetit lidhur me urdhërat e brendshëm që ajo ka nxjerr për shqyrtimin e rekomandimeve dhe konkluzioneve të lëna bazuar në problematikat e konstatuara nga KLSH-ja sipas sektorëve përkatës.

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas e ka njoftuar Kontrollin e Lartë të Shtetit brenda afatit ligjorë prej 20 ditësh për masat e marra për fillimin e auditimit, por ai nuk ka përgatitur një program të posaçëm pune me afate kohore të përcaktuara dhe me persona përgjegjës, për zbatimin e rekomandimeve veprim ky që bie ndesh me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa J, “ku është vendosur një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituar ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve”

2. Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas me shkresën nr. 2278, prot, datë 26.07.2016 dhe nr. 3243 prot, datë 18.10.2016 ka informuar Kontrollin e Lartë të Shtetit lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30/2, ku përcaktohet se; “subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna”, e konkretisht:

I. Auditim mbi Zbatimin e Rekomandimeve të lëna nga KLSH-ë, në auditimin e mëparshme; Grupi i Auditimit, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1114, datë 04.11.2016 dhe autorizimit nr. 1114/8, datë 04.11.2016 miratuar nga KLSH-ë, ka audituar zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm me shkresën përcjellëse nr. 1112/8, datë 31.03.2016, e cila është protokolluar nga Zyra e Protokoll Arkivit, pranë Degës së Doganës Rinas me nr. 1084, datë 05.04.2016. Grupi i Auditimit në përfundim të auditimit të



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

rekomandimeve ka përgatitur Aktverifikimin nr. 1, datë 07.12.2016, protokolluar në doganë me nr. 4025 prot, datë 07.12.2016.

Nga auditimi i ushtruar është konstatuar se

I- Nga 10 Masa Organizative të rekomanduara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për zbatim; autoriteti doganor kompetent Dega e Doganës Rinas ka zbatuar plotësisht **7 masa**, nga të cilat **3 Masa** janë zbatuar pjesërisht ku mund të cilësohen masat nr. 2, 3 dhe 7.

II-Nga 8 Masa për Shpërblim Dëmi të rekomanduara; autoriteti doganor kompetent Dega e Doganës Rinas ka zbatuar plotësisht 1 masë, ka zbatuar pjesërisht 4, ka në proces zbatimi 2 dhe nuk ka zbatuar 1.

III- Nga 4 Masa Disiplinore të rekomanduara, autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas me shkresën nr. 3989, datë 06.12.2016 me objekt “Kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor” ka kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme të Doganave, të fillojë procedurat disiplinore për katër punonjës civil të kësaj dogane, trajtuar më sipër.

Autoriteti doganor kompetent Dega e Doganës Rinas, mbasi është njohur me aktverifikimin nr. 1, datë 07.12.2016 përgatitur nga grupi i auditimit të KLSH-së, i cili është protokolluar në doganë me nr. 4025 prot, datë 07.12.2016, për të cilin është përgatitur observacioni nr. 4107 prot, datë 13.12.2016 ku theksohet se nga 21 rekomandime të lëna janë zbatuar plotësisht 10 rekomandime, janë zbatuar pjesërisht 7, janë në proces zbatimi 2 dhe nuk janë zbatuar 2.

Mbi këtë bazë, autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas ka paraqitur kundërshtitë dhe pretendimet e saj, ku theksohet se:

Për mos zbatimin e rekomandimeve nr. 2, 3, 7 dhe 9 Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rerekomanduar si më poshtë;

1. Për rekomandimin nr. 2.

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas të marrë masa të plota organizative me qëllim që dokumentacioni shoqëruar i pranuar për vlerësimin doganor të mallrave të jetë original apo fotokopje e noterizuar.

2. Për rekomandimin nr. 3.

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas, të marrë masa të plota organizative me qëllim që praktikat doganore të pranuar me transaksion në përcaktimin e vlerës së mallrave për qëllime doganore, të mbështeten me procesverbale vlerësimi të indikatorëve në zbatim të neneve 285-287 e në vijim të “Kodit Doganor të RSH”, si dhe të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 25, datë 30.11.2007 “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhënat e disponueshme, zhdoganimi i automjeteve dhe pjesëve të këmbimit”, pika 6 në të cilën theksohet se; “Përcaktimi i vlerës së artikullit, bazuar në pikat e mësipërme, gjithmonë duhet të shoqërohet nga një procesverbal sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, ku duhet të plotësohen indikatorët e kontrolluar....”.

3. Për rekomandimin nr. 7.

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas, nëpërmjet specialistit të Kontrollit Pas Zhdoganimit, Përgjegjësit të Zyrës së Cargos dhe doganierit që ka mbikëqyrur Regjimin e Përpunimit Aktiv, të saktësojë në ambientet e operatorit ekonomik diferencat e lindura nga krahasimi i deklaratimit të subjektit me formularin model 3 për peshat bruto, nëpërmjet ballafaqimit të të dhënave të konstatuara dhe dokumenteve kontabile me analiza të hollësishme të nxirren shkaqet dhe përgjegjësitë, e më pas të llogariten detyrimet për destinacionin e ri doganor.

4. Për rekomandimin nr. 9. Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas, të marrë masa për zbatimin e kërkesave dhe afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar për të rivlerësuar dhe



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

revokuar vendimet administrative për 17 operatorë ekonomik duke rillogaritur diferencat e gjobave (sanksioneve) të pa aplikuara në vlerë 2,562,337 lekë, veprimet apo mosveprimet të analizohen dhe të nxirren përgjegjësitë përkatëse (Aneksi nr. 6 i RPA)

II. Për zbatimin e rirekomandimeve të lëna nga KLSH-ë

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas me shkresën nr. 4227 prot, datë 19.12.2016 ka dërguar në Kontrollin e Lartë të Shtetit observacionin përkatës në lidhje me zbatimin e rirekomandimeve të dërguara me shkresën nr. 1114/25 prot, datë 12.12.2016 protokolluar në doganë me nr. 4149 prot, datë 14.12.2016, e konkretisht;

1. Për rirekomandimin nr.2.

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas, të marrë masa të plota organizative me qëllim që dokumentacioni shoqëruar i pranuar për vlerësimin doganor të mallrave të jetë origjinal apo fotokopje e noterizuar. Dega e Doganës Rinas lidhur me këtë rekomandim sqaron se ajo është doganë specifike, e cila shërbimet e saj i kryen nëpërmjet shërbimit postar të cilat kërkojnë shpejtësi në kryerjen e procedurave të zhdoganimit. Postat e shpejta përfaqësojnë/deklarojnë mallrat e transportuara të subjekteve që operojnë në të gjithë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë. Për këtë arsye shumë subjekte e komunikojnë agjentin e tyre me anën e emaile-ve, të cilat më pas konfirmohen me vulë të njomë nga agjencia doganore duke shënuar në çdo dokument tregtar numrin e DAV-it, ndërsa në raste të tjera subjektet paraqesin fatura origjinale.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht;

2. Për rirekomandimin nr. 3.

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas, të marrë masa të plota organizative me qëllim që praktikatat doganore të pranuar me transaksion në përcaktimin e vlerës së mallrave për qëllime doganore, të mbështeten me procesverbale vlerësimi të indikatorëve në zbatim të neneve 285-287 e në vijim të “Kodit Doganor të RSH”, si dhe të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 25, datë 30.11.2007 “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhënat e disponueshme, zhdoganimi i automjeteve dhe pjesëve të këmbimit”, pika 6 në të cilën theksohet se; “Përcaktimi i vlerës së artikullit, bazuar në pikat e mësipërme, gjithmonë duhet të shoqërohet nga një procesverbal sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, ku duhet të plotësohen indikatorët e kontrolluar”, Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas ka sqaruar se Sektori i Cargos ka punuar dhe punon me staf të reduktuar ku çdo ditë është përpunuar dhe përpunohet një numër i konsiderueshëm deklarata doganore, për këtë arsye thekson se; mbajtja e procesverbalit të rekomanduar për zbatim në përputhje me kërkesat e udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave, për vlerësimin e indikatorëve, nuk ka qenë e mundur të përgatitej në çdo rast, por ai është mbajtur dhe do të mbahet për subjekte të veçanta, ose për mallrat e papërfshira në dosjen me të dhënat e disponueshme në RSH, (çmimet referuese), apo tek mallrat identikë.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht;

3. Për rirekomandimin nr. 7.

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas, nëpërmjet specialistit të Kontrollit Pas Zhdoganimit, Përgjegjësit të Zyrës së Cargos dhe doganierit që ka mbikëqyruar Regjimin e Përpunimit Aktiv, të saktësojë në ambientet e operatorit ekonomik diferencat e lindura nga krahasimi i deklarimit të subjektit me formularin model 3 për peshat bruto, nëpërmjet ballafaqimit të të dhënave të konstatuara dhe dokumenteve kontabile me analiza të hollësishme të nxirren shkaqet dhe përgjegjësitë, e më pas të llogariten detyrimet për destinacionin e ri doganor. Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas në zbatim të këtij rekomandimi ka nxjerr urdhëratë e brendshëm nr. 3624-3625 prot, datë 11.11.2016, për



KONTROLLI I LARTE I SHTEPIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

të ushtruar kontrolle në ambientet e subjekteve “EVIS” dhe “SINA”, që kanë operuar me Regjimin e përpunimit Aktiv.

-Subjekti “EVIS”, me NIPTJ64102203D, e ka mbyllur aktivitetin e përpunimit të formave të Petromaksit me RPA. Nga kontrolli fizik i ushtruar në ambientet e brendshme të subjektit nuk është konstatuar mall i pa eksportuar, por vetëm paleta të importuara nën RPA, pa kod tarifor të parashikuar në autorizim, për këtë shkak është dhënë destinacion i ri doganor duke e ngarkuar subjektin me 4,767 lekë detyrime doganore dhe në bazë të nenit 267 të Kodit Doganor të ndryshuar është aplikuar një gjobë në vlerë 50 %, të detyrimit të papaguar ose në vlerë 2384 lekë, gjithsej 7,151 lekë. Për pa rregullsi të konstatuara në DAV-in përkatës subjekti është gjobitur me 50.000 lekë, në total është krijuar një borxh doganor në vlerë 57.150 lekë.

-Subjekti “SINA” me NIPT K41712202V, nga kontrolli fizik i ushtruar në ambientet e brendshme të subjektit nuk është gjetur lëndë e parë k dhe aksesorë të importuar nën regjimin e përpunimit aktiv, lidhur me autorizimin nr. 3372/1. Nga kontrolli i ushtruar janë gjetur vetëm ambalazhet me të cilat është importuar lënda e parë. Ambalazhi gjetur nga kontrolli është vlerësuar i papërdorshëm për tu eksportuar. Konstatimi i KLSH-së, për diferencën ndërmjet peshës bruto të lëndës së parë të importuar me peshën bruto të produktit të gatshëm të eksportuar është i drejtë; pasha neto e lëndës së parë dhe produkteve kompensuese ishte riekportuar e gjithë sasia. Ndërkohë nga verifikimi dokumentacionit kontabël është konstatuar se e gjithë lënda e parë dhe aksesorët në peshë neto ishin eksportuar. Për ambalazhet me të cilat është ju dha destinacion duke paguar detyrimet doganore në vlerë 3000 lekë dhe në bazë të nenit 267 të Kodit Doganor të ndryshuar është aplikuar një gjobë në vlerë 50 %, të detyrimit të papaguar ose në vlerë 1500 lekë, gjithsej 4.500 lekë.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

4. Për rekomandimin nr. 9.

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas të marrë masa për zbatimin e kërkesave dhe afateve ligjore të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i RSH”, për të vlerësuar dhe revokuar vendimet administrative për 17 operatorë duke rillogaritur diferencat e sanksioneve të pa aplikuar në vlerën 2,562,337 lekë

Grupi i punës ka shqyrtuar në mënyrë të detajuar vendimet administrative dhe në relacionin nr. 2532 prot, datë 18.08.2016 ka shprehur qëndrimin e tij;

Në njoftimin nr. 2532 prot, datë 18.08.2016 cilësohet se janë zbatuar vendimet për subjektet Geniusa, Nikolla Elektronuk, Printinga Salution, por të zbatuara janë dhe vendimet për subjektin Profarma dhe subjektin TNT Ekspres Albania, për të cilat D.D.Rinas ka nxjerrë vendimet përkatëse.

-Në lidhje me këtë rekomandim sqarohet se; për vendimet që kanë të bëjnë me subjektet “B2” dhe “S&T” nuk është kërkuar rishikimi i vendimeve nga grupi i audituesve, por meqenëse për të njëjtën çështje në këto vendime D.D.Rinas ka vendosur penalitete të cilat në Raportin Përfundimtar të Auditimit janë trajtuar si reference për të rishikuar vendimet e vitit 2013, mbi të cilat nuk janë vendosur penalitete.

Për vendimin e subjektit “TIA”, njoftohet se është në verifikim, për të cilin D.D.Rinas me shkresën nr. 3946 prot, datë 02.12.2016 drejtuar Drejtorisë së Origjinës ka kërkuar informacion për ecurinë e verifikimit të DAV R-229, datë 08.10.2015, përgjigja akoma nuk është marrë. Për vendimet e subjekteve “Cene” “Vodafone”, Altek dhe Altek Shpk njoftohet se mbas verifikimit të bërë nga Drejtoria e Origjinës, pranë D.P.Doganave kanë ardhur përgjigjet se mallrat e deklaruara në provat e origjinës përfitojnë trajtim tarifor preferencial. Për të katër rastet D.D.Rinas ka zbatuar urdhërat e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave nr. 8455 dhe nr. 14936/1 prot, datë 19.06.2015 ku theksohet se; “pas verifikimit nëse përgjigja



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

është negative të penalizohet subjekti, ndërsa nëse përgjigja është pozitive duhet të rimbursohet detyrimi doganor i mbajtur.”

Rekomandimi është zbatuar plotësisht;

A-MASA ORGANIZATIVE

1. *Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas të ripërsërit kërkesat dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave ti jepet zgjidhje problematikës së trajtuar, nga ku rezulton;*

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas me shkresën nr. 1838, datë 10.06.2016, ka kërkuar rishikimin e marrëveshjes nr. 5999/2 prot, datë 18.06.2007 të nënshkruar nga Posta Shqiptare me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. Ndërsa lidhur me investigimin e faturave D.D.Rinas me shkresat nr. 1417 prot, datë 10.04.2013 dhe nr. 1756, datë 03.05.2013 ka kërkuar verifikimin e DAV; R-6168, R-12543 të vitit 2012 dhe DAV R-4043 datë 28.02.2013. Për DAV, R-6168, R-12543, ka ardhur përgjigje pozitive nga DOH, ndërsa DAV R-4043, datë 28.02.2013 ka rezultuar me shkelje doganore për të cilën ka dalë vendimi administrative nr. 938, datë 19.03.2014, në përputhje me aktin e verifikimit dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit. Për deklaratën doganore R-21485 e vitit 2012 të subjektit “Alb-Pipe” Dega e Doganës Rinas ka nxjerr vendimin administrative 286, datë 27.01.2015.

Dega e Doganës Rinas me shkresën nr. 1262 prot, datë 14.04.2014 ka dërguar për verifikim fature pranë Departamentit Operativ Hetimor (DOH), DAV-et nr. R-15779, datë 14.08.2013 dhe R-9413, datë 17.05.2013, R-21485, datë 14.11.2012, R-10578, datë 09.06.2012, R-16173, datë 20.08.2013 dhe R-24890, datë 28.12.2012. D.P.Doganave mbas verifikimit të kryer me shkresë nr. 2944 prot, datë 19.09.2014 i ka kthyer përgjigje D.D.Rinas se DAV R-24890, datë 28.12.2012 e subjektit “BNT Elektroniks” ka rezultuar e rregullt. Me shkresën nr. 1746 prot, datë 06.06.2016 D.P.Doganave pas verifikimit të praktikave doganore ka kthyer përgjigje se DAV R-15779, datë 14.08.2013, R-9413, datë 17.05.2013, janë të rregullta dhe përputhen me librat e kontabilitetit.

D.D.Rinas me shkresën nr. 3977 prot, datë 18.12.2014 i ka kërkuar Drejtorisë së Tarifave interpretim për kalsifikimin tarifor të mallit lidhur me DAV-et R-10578, datë 09.06.2012, R-16173, datë 20.08.2013 dhe R-24890, datë 28.12.2012. Drejtoria e Tarifave me shkresën nr. 105 prot, datë 13.01.2015 ka sqaruar se; klasifikimi tariforë përputhet me deklarin në deklaratat doganore R-16173, datë 20.08.2013 dhe R-24890, datë 28.12.2012, ndërsa për DAV R-10578, datë 09.06.2012, për mungesë të specifikimeve teknike si funksionon pajisja për kontrollin e hyrjeve si dhe të elementeve përbërës të saj ka kthyer përgjigje se është i pamundur klasifikimi i saktë i mallit të deklaruar.

Të bashkëpunohet me D.P.Doganave, për të parë mundësinë e investimit për ndërtimin e Zyrave të Degës së Doganës Rinas. Për këtë investim nuk është dërguar një përgjigje ligjore nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme e Doganave.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

2. *Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas, të marrë masa të plota organizative me qëllim që dokumentacioni shoqërues i pranuar për vlerësimin doganor të mallrave të jetë origjinal apo fotokopje e noterizuar”.*

Dega e Doganës Rinas lidhur me këtë rekomandim sqaron se ajo është doganë specifike, e cila shërbimet e saj i kryen nëpërmjet shërbimit postar, të cilat kërkojnë shpejtësi në kryerjen e procedurave të zhdoganimit. Postat e shpejta përfaqësojnë/deklarojnë mallrat e transportuara të subjekteve që operojnë në të gjithë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë..



KONTROLLI I LARTE I SHETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

Për këtë arsye shumë subjekte e komunikojnë agjentin e tyre me anën e emaile-ve, të cilat më pas konfirmohen me vulë të njomë nga agjencia doganore duke shënuar në çdo dokument tregtar numrin e DAV-it, ndërsa në raste të tjera subjektet paraqesin fatura origjinale.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht,

3. Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas, të marri masa që praktikata doganore të pranuar me transaksion gjatë përcaktimit të vlerës së mallrave për qëllime doganore të mbështeten me procesverbale vlerësimi të indikatorëve në zbatim të Kodit Doganor, si dhe të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 25, datë 30.11.2007 “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhënat e disponueshme dhe zhdoganimin e automjeteve dhe të pjesëve të këmbimit”, pika 6 në të cilën theksohet se: “Përcaktimi i vlerës së artikullit, bazuar në pikat e mësipërme, gjithmonë duhet të shoqërohet nga një procesverbal sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, ku duhet të plotësohen indikatorët e kontrolluar....”, si dhe në zbatim të Kodit Doganor neni 34 “vlera e transaktuar” dhe neni 35/a, “vlera e mallrave identikë.

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas sqaron se Sektori i Cargos punon me një staf të reduktuar ku çdo ditë përpunohet një numër i konsiderueshëm deklaratah doganore dhe procesverbali sipas VKM nr. 205 datë 13.04.1999, si dhe udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave, është dhe do të mbahet për subjekte të veçanta, ose për mallrat e papërfshira në dosjen me të dhënat e disponueshme në RSH, (çmimet referuese), apo tek mallrat identikë.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht,

4. Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas, të nxjerr menjëherë urdhërin e brendshëm për funksionimin e Komisionit të Vlerësimit Doganor, për vlerësimin e mallrave për të cilët nuk ka të dhëna të disponueshme të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, si dhe për mallrat e përdorur.

Në zbatim të këtij rekomandimi ka dalë urdhëri i brendshëm nr. 1006/1, datë 06.05.2016, me të cilin është ngritur grupi i vlerës doganore, i përbërë nga punonjës të D.D.Rinas.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht;

5. Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas të marrë masa të plota me qëllim që vlerësimi dhe zhdoganimi i mallrave të parashikuar nga Kodi i Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave në kodet tarifore “Pjesë Këmbimi për automjete” të miratohet nga DP Doganave. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me shkresën nr. 1678 prot, datë 17.05.2016, i ka kthyer përgjigje D.D.Rinas se të dhënat e zhdoganimit të artikujve të ngjashëm (identik) gjenden në të gjitha degët e doganave që kanë kryer zhdoganime të kësaj natyre, ndërsa me shkresën nr. 12206, datë 12.05.2016 ka udhëzuar përdorimin e Data-base për vlerësimin doganor vetëm në raste urgjente.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht;

6. Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas, specialisti i Kontrollit Pas Zhdoganimit, Përgjegjësi i Zyrës së Cargos dhe doganieri që ka mbikëqyrur magazine doganore përkatëse, për diferencat e lindura nga krahasimi i deklarimit të subjektit me inventarin fizik të kryer, diferencat të saktësohen në ambientet e subjektit duke i ballafaquar të dhënat e konstatuara me dokumentet kontabile duke bërë analiza të hollësishme me specialist të licensuar “Survejob”, me qëllim që të nxirren shkaqet dhe përgjegjësitë duke përcaktuar detyrimet shtesë edhe për diferenca të tjera nëse mund të rezultojnë.

Në lidhje me këtë rekomandim, për mos respektim të autorizimit KLSH-ja ka rekomanduar dhe 200.000 lekë të tjera gjobë për kryerje të procedurave Imp. 4 të pa parashikuara në autorizim, subjekti ka marrë shtesë autorizimi pas rekomandimit të KLSH-së dhe vendim



KONTROLLI I LARTE I SHTESTIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

marrja është në proces. Dega e Doganës Rinas për zbatimin e rekomandimit ka nxjerrë urdhërin e brendshëm nr. 1946, datë 23.06.2016 për ushtrimin e kontrollit në ambientet e magazinës doganore “Air BP Albania”Sha. Me kërkesë të Degës së Doganës Rinas subjekti ka njoftuarurvejorin, për kryerjen e matjeve të karburantit gjendje në prezencë të grupit të punës dhe përfaqësuesve të subjektit. Nga matjet ka rezultuar një diferencë prej 1310 litra karburante për avionë. Dega e Doganës Rinas ka marrë vendimin administrative nr. 2129, datë 08.07.2016 me të cilin ka vendosur që subjekti “Air BP Albania Sha”, duhet të paguaj 59,993 lekë detyrime doganore dhe gjobë sa njëfishi i detyrimit të papaguar, ose gjithsej në vlerë 119,986 lekë. Gjithashtu D.D.Rinas ka marrë vendimin administrative nr. 522, datë 15.02.2016 me të cilin është vendosur që subjekti duhet të paguaj dhe 4,251,639 lekë detyrime doganore dhe gjobë sa njëfishi i detyrimit në vlerë 4,251,639 lekë, ose gjithsej 8,503,278 lekë. Në këto kushte është sistemuar dhe situatë e këtij subjekti në Sistemin Assycuda Eorld.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht:

7. Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas, nëpërmjet specialistit të Kontrollit Pas Zhdoganimit, Përgjegjësit të Zyrës së Cargos dhe doganierit që ka mbikëqyrur Regjimin e Përpunimit Aktiv, të saktësojë në ambientet e operatorit ekonomik diferencat e lindura nga krahasimi i deklarimit të subjektit me formularin model 3 për peshat bruto, nëpërmjet ballafaqimit të të dhënave të konstatuara dhe dokumenteve kontabile me analiza të hollësishme të nxirren shkaqet dhe përgjegjësitë, e më pas të llogariten detyrimet për destinacionin e ri doganor.

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas në zbatim të këtij rekomandimi ka nxjerrë urdhërat e brendshëm nr. 3624-3625 prot, datë 11.11.2016, për të ushtruar kontrole në ambientet e subjekteve “EVIS” dhe “SINA”, që kanë operuar me Regjimin e përpunimit Aktiv.

-Subjekti “EVIS”, me NIPTJ64102203D, e ka mbyllur aktivitetin e përpunimit të formave të Petromaksit me RPA. Nga kontrolli fizik i ushtruar në ambientet e brendshme të subjektit nuk është konstatuar mall i pa eksportuar, por vetëm paleta të importuara nën RPA, pa kod tarifor të parashikuar në autorizim, për këtë shkak është dhënë destinacion i ri doganor duke e ngarkuar subjektin me 4,767 lekë detyrime doganore dhe në bazë të nenit 267 të Kodit Doganor të ndryshuar është aplikuar një gjobë në vlerë 50 %, të detyrimit të papaguar ose në vlerë 2384 lekë, gjithsej 7,151 lekë. Për pa rregullsi të konstatuara në DAV-in përkatës subjekti është gjobitur me 50.000 lekë, në total është krijuar një borxh doganor në vlerë 57.150 lekë.

-Subjekti “SINA” me NIPT K41712202V, nga kontrolli fizik i ushtruar në ambientet e brendshme të subjektit nuk është gjetur lëndë e parë k dhe aksesore të importuar nën regjimin e përpunimit aktiv, lidhur me autorizimin nr. 3372/1. Nga kontrolli i ushtruar janë gjetur vetëm ambalazhet me të cilat është importuar lënda e parë. Ambalazhi gjetur nga kontrolli është vlerësuar i papërdorshëm për tu eksportuar.

Konstatimi i KLSH-së, për diferencën ndërmjet peshës bruto të lëndës së parë të importuar me peshën bruto të produktit të gatshëm të eksportuar është i drejtë; pasha neto e lëndës së parë dhe produkteve kompensuese ishte riekportuar e gjithë sasia. Ndërkohë nga verifikimi i dokumentacionit kontabël është konstatuar se e gjithë lënda e parë dhe aksesoret në peshë neto ishin eksportuar. Për ambalazhet me të cilat është ju dha destinacion duke paguar detyrimet doganore në vlerë 3000 lekë dhe në bazë të nenit 267 të Kodit Doganor të ndryshuar është aplikuar një gjobë në vlerë 50 %, të detyrimit të papaguar ose në vlerë 1500 lekë, gjithsej 4.500 lekë.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht:



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

8. Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas, në bashkëpunim me strukturat e specializuara të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të marrin masat përkatëse nëpërmjet zbatimit të procedurave ligjore dhe ato në kuadrin e marrëveshjeve të nënshkruara me strukturat e ndryshme shtetërore e private, që janë ngarkuar nga ligja për të ndihmuar rikuperimin e borxhit doganor duke synuar trajtimin profesional-ligjorë për rastet e operatorëve ekonomik që zënë peshën më të madhe të borxhit gjendje.

Dega e Doganës Rinas me shkresën nr. 1835 prot, datë 10.03.2016 me objekt “kërkesë për bashkëpunim” ka kërkuar bashkëveprimin e këtyre strukturave për të mundësuar rikuperimin e rasteve më të vështira të borxhit dhe për t'i detyruar këto subjekte të shlyejnë borxhin doganor të krijuar D.D.Rinas ka ndjekur rast pas rasti e në vazhdimësi procedurat ligjore-administrative, për rikuperimin e borxhit doganor.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht;

9. Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas, të marri masa për zbatimin e kërkesave dhe afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar për të rivlerësuar dhe revokuar vendimet administrative për 17 operatorë ekonomik duke rillogaritur diferencat e gjobave (sanksioneve) të pa aplikuar në vlerë 2,562,337 lekë, veprimet apo mosveprimet të analizohen dhe të nxirren përgjegjësitë përkatëse (Aneksi nr. 6 i RPA)

Dega e Doganës Rinas, për zbatimin e këtij rekomandimi ka nxjerr urdhërin e brendshëm nr. 2198 prot, datë 18.07.2016 për ngritjen e grupit të punës i cila ka shqyrtuar rast pas rasti në mënyrë të detajuar rekomandimet e KLSH-së, lidhur me aplikimin e diferencave të gjobave (sanksioneve) të pa aplikuar në vendimet administrative të nxjerra nga autoriteti doganor kompetent, ndaj 17 operatorëve, përshkruar në aneksin nr. 6.

Grupi i punës me shkresën nr. 2532 prot, datë 18.08.2016 me objekt relacion për zbatim të urdhërit të mësipërm, mbasi ka shqyrtuar dhe verifikuar rast pas rasti rekomandimet e KLSH-së, ka informuar Kryetarin e Degës së Doganës Rinas, lidhur me gjykimin e grupit të punës për zbatimin e rekomandimeve, sa vijon;

Për 17 operatorë ekonomik në 20 raste, për të cilët autoriteti doganor kompetent ka dalë me vendime administrative por pa aplikuar penalitetet e nevojshme, për të cilat KLSH-ja ka rekomanduar rast pas rasti gjoba në vlerë 2,562,337 lekë, sipas Aneksit nr. 6.

Nga shqyrtimi dhe analiza e 17 subjekteve të përshkruara në këtë aneks në vlerë 2,562,337 lekë, grupi i punës ka konstatuar me shkelje 15 subjekte në vlerë 1,848,426 lekë, ose në masën 72 %. Aneksi 6, bashkëlidhur aktkonstatimit.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht;

10. Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas, në bashkëpunim me strukturat e specializuara të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të marrin masa për vënien në funksion të peshores, të certifikuar dhe të kalibruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, me qëllim kryerjen e saktë të procedurave doganore në import-eksport të mallrave.

Dega e Doganës Rinas, për zbatimin e këtij rekomandimi me shkresën nr. 1834 prot, datë 10.06.2016 i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për vënien në funksion të peshores, e cila është certifikuar dhe kalibruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht;

Nga 10 masa organizative të rekomanduara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, autoriteti doganor kompetent Dega e Doganës Rinas, ka zbatuar plotësisht 9 masa, është zbatuar pjesërisht një masë, (masa 3)

B. MASA SHPERBLIM DEMI



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas, të kryejë kontabilizimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative , si dhe të gjitha shkallët e gjyqësorit me qëllim shpërblimin e demit në vlerë 18,418,733 lekë,

Konkretisht nga 8 rekomandime në vlerë 18,418,733 lekë detyrime doganore të papaguara të rekomanduara për zbatim nga Kontrolli i Lartë i Shtetit janë zbatuar plotësisht 7 rekomandime në vlerë 11,100,154 lekë, ose në masën 60 %, nuk është zbatuar një rekomandim në vlerë 5,985,904 lekë, konkretisht;

1. Vlera prej 1,672,444 lekë, e krijuar nga 26 operatorë ekonomik (30 raste) të pasqyruara në Aneksin 1, të RPA-së trajtuar në faqet 14-48 për rivlerësimin e detyrimit doganor i pranuar me vlerë transaksioni, veprim i kryer në shkëlqje të neneve 35-39 të Kodit Doganor, për vitin 2014. Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas në zbatim të relacionit nr. 2532 prot, datë 18.08.2016 paraqitur nga grupi i punës, bazuar në urdhërin e brendshëm nr. 2198 prot, datë 18.07.2016, ka nxjerr 24 vendime administrative në vlerë 1,354,065 lekë, ose në masën 81 %. Nga rekomandimi i lënë, nuk janë pranuar nga grupi i punës i D.D.Rinas rekomandimet për 6 operatorë (subjekte) në vlerë 225,414 lekë, të cilat janë vlerësuar se bien ndesh me legjislacionin doganor gjithashtu janë nxjerrë 3 vendime administrative në vlerë 112,047 lekë më pak dhe një vendim administrative në vlerë 19,081 lekë më shumë se sa rekomandimet e lënë nga KLSH-it. Aneksi 1, bashkëlidhur aktkonstatimit.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht;

2. Vlera prej 604,238 lekë, e krijuar nga 10 operatorë ekonomik (11 raste), pasqyruar në Aneksin nr. 2, të RPA-së trajtuar në faqet 14-48, për llogaritjen dhe rivlerësimin e detyrimit doganor të krijuar nga keqklasifikimi tarifor i artikujve jo në përputhje me Kodin e Nomenklaturës së Kombinar të Mallrave, parashikuar nga neni 256/1/2/3 dhe 275 të Kodit Doganor.

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas në zbatim të relacionit nr. 2532 prot, datë 18.08.2016 paraqitur nga grupi i punës bazuar në urdhërin e brendshëm nr. 2198 prot, datë 18.07.2016, ka nxjerr 8 vendime administrative në vlerë 290,713 lekë, ose në masën 48 % Nga rekomandimi i lënë, nuk janë pranuar nga grupi i punës i D.D.Rinas rekomandimet për 2 operatorë (subjekte) Irena Myrtaj dhe AMC në vlerë 180,000 lekë penalitete, të cilat janë vlerësuar se bien ndesh me legjislacionin doganor, (shkresën nr. 83, datë 20.01.2008 të DPDoganave), ndërsa për 3 operatorë janë nxjerrë 3 vendime administrative në vlerë 100,000 lekë nga 150000 lekë të rekomanduara nga KLSH-ë. Aneksi 2, bashkëlidhur aktkonstatimit.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht;

3. Vlera prej 201, 325 lekë, e krijuar nga 2 operatorë ekonomik, pasqyruar në Aneksin nr. 3, të RPA-së, trajtuar në faqet 14-48, për llogaritjen dhe rivlerësimin e detyrimit doganor në bazë të diferencës në peshën e deklaruar të artikullit, jo në përputhje me peshën e artikullit të rezultuar në fletën e peshimit të lëshuar nga dogana, veprim i kryer në shkëlqje të ligjit parashikuar nga nenet 256/1/2/3 dhe 261/1/2 të Kodit Doganor.

Nga rekomandimi i lënë nga KLSH, për operatorët (subjektet) Biometrik në vlerë 187,670 lekë dhe Hashim Piro në vlerë 11,210 lekë, ose gjithsej 201,325 lekë, autoriteti doganor kompetent, D.D. Rinas në zbatim të relacionit nr. 2532 prot, datë 18.08.2016 paraqitur nga grupi i punës bazuar në urdhërin e brendshëm nr. 2198 prot, datë 18.07.2016, ka nxjerr dy vendime administrative në vlerë 100,342 lekë gjithsej, nga të cilat 89,132 lekë në ngarkim të subjektit Biometrik dhe 11,210 lekë ndaj subjektit Hashim Piro. Aneksi 3, bashkëlidhur aktkonstatimit.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht;

4. Vlera prej 100,000 lekë gjobë, e krijuar nga operatorë ekonomik IL Bano dhe Sulo Liçaj trajtuar në Aneksin nr. 4 të RPA, për diferencë peshe të artikullit instrumente për përdorim



KONTROLLI I LARTE I SHTESTIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

dentar) dhe vlerësimin e detyrimit doganor për përfitim të gabuar të origjinës preferenciale të mallit, jo në përputhje me dokumentet shoqëruese dhe kriteret ligjore të protokollit nr. 5 të MSABE-së.

Nga rekomandimi i lënë nga KLSH, gjoba për operatorët (subjektet) IL Bano në vlerë 50,000 lekë dhe Sulo Liçaj në vlerë 50,000 lekë, autoriteti doganor kompetent, D.D. Rinas në zbatim të relacionit nr. 2532 prot, datë 18.08.2016 paraqitur nga grupi i punës bazuar në urdhërin e brendshëm nr. 2198 prot, datë 18.07.2016, ka nxjerr një vendim administrative në vlerë 30,000 lekë në ngarkim të subjektit Sulo Liçaj, ndërsa rekomandimi me gjobë 50,000 lekë për subjektin “**IL Bano**” nuk është pranuar nga grupi i punës D.D.Rinas, mbasi nuk është në përputhje me legjislacionin doganor. Aneksi 4, bashkëlidhur aktkonstatimit.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht;

5. Vlera prej 292,938 lekë, e krijuar nga 2 operatorë ekonomik pasqyruar në Aneksin nr. 5, të RPA-së, trajtuar në faqet 14-48, për gjoba (penalitete) kundërvajtje administrative të evidentuara në procesin e vlerësimit të detyrimit doganor, parashikuar nga neni 256/1/2/3 dhe 275 të Kodit Doganor, për vitin 2014.

Nga rekomandimi i lënë nga KLSH, gjobë në vlerën 47,646 lekë dhe penalitete 245,292 lekë në total për operatorët (subjektet) SINA dhe EVIS, autoriteti doganor kompetent D.D.Rinas mbas kontrollit të ushtruar në ambientet e subjekteve në zbatim të rekomandimit të lënë nga KLSH-ë ka nxjerr dy vendime administrative në vlerë 6000 lekë në ngarkim të subjektit Sina dhe 57,150 lekë ndaj subjektit EVIS, ose gjithsej në vlerë 63,150 lekë. Aneksi 5, pika 1, bashkëlidhur aktkonstatimit.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

6. Vlera prej 8,903,278 lekë, e krijuar nga 2 operatorë ekonomik, nga AIRBP-Albania-Sha me NIPT J92302002L në vlerë 8,703,278 lekë dhe operatorin ekonomik Duty Free-Shop Albania me NIPT J91914004L, në vlerë 200,000 lekë, pasqyruar në Aneksin nr. 5/3, trajtuar në faqet 48-63 të RPA.

Operatori ekonomik Air BP Albania-Sha me NIPT J92302002L, ka krijuar një detyrim të papaguar në vlerë 8,703,278 lekë, pasqyruar në Aneksin nr. 5/3, trajtuar në faqet 48-63 të RPA për llogaritjen dhe vlerësimin e detyrimit doganor lidhur me diferencën e rezultuar në artikullin karburant me gjoba (penalitete) për kundërvajtje administrative të evidentuara në procesin e mbikëqyrjes së magazinës doganore Për shkeljet e konstatuara mbas kontrollit të ushtruar nga D.D.Rinas në prezencë tëurvejorit të jashtëm dhe përfaqësuesve të subjektit ka nxjerr vendimin administrative nr. 522 prot, datë 15.02.2016 me të cilin ka vendosur ndaj subjektit 4,251,639 lekë detyrime doganore dhe 4,251,639 gjoba (penalitete), por nuk ka pranuar rekomandimin e KLSH-së për vendosjen e një gjobe në vlerë 200.000 lekë, për mos respektimin e autorizimit duke kryer procedura Imp. 4, të paparashikuara në autorizimin përkatës, parashikuar nga neni 256/1/2 dhe 275 të Kodit Doganor, por ka zbatuar gjobë në vlerë 100,000 lekë ose gjithsej në vlerë 8,603,278 lekë. Detyrimet në vlerë 4,251,639 dhe gjobat e aplikuar në vlerë 4,351,639 lekë, gjithsej 8,603,278 lekë janë arkëtuar në masën 100 %, nga subjekti. Ndërsa, për operatorin ekonomik Duty Free-Shop Albania me NIPT J91914004L, KLSH-ja ka rekomanduar aplikimin e një gjobe në vlerë 200.000 lekë për mos respektim të autorizimit, mbasi subjekti ka kryer deklarime me status Imp.4, për të cilën D.D.Rinas ka nxjerr vendimin administrative nr. 944 prot, datë 21.03.2016, vendim i cili mbas apelimit është lënë në fuqi nga DPDoganave, por është rrëzuar nga Gjykata Administrative dhe nuk është zbatuar.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

7. Vlera prej 6,644,510 lekë, e krijuar nga 2 operatorë ekonomik, nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit me NIPT L41417451U në vlerë 5,985,904 lekë dhe Prokuroria e Përgjithshme me



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

NIPT J62410014F, në vlerë 658,606 lekë, pasqyruar në Aneksin nr. 5, pika/2, trajtuar në faqet 48-63 të RPA, për mos llogaritje të detyrimit doganor dhe mos aplikim gjobe (penaliteti) për kundërvajtje administrative të evidentuara në procesin e mbikëqyrjes së Regjimit të Lejimit të Përkohshëm të mallrave në përputhje e në zbatim të nenit 99, nenit 157-164 dhe nenit 275/1/2 të Kodit Doganor.

Agjencia Kombëtare e Bregdetit me NIPT L41417451U, me R-15364 datë 23.07.2014, ka importuar nga USA “Pajisje kërkimore nënujore” me KT 90158099 nën Regjimin e Lejimit të Përkohshëm, për të cilin D.D.Rinas ka lëshuar autorizimin nr. 2349 prot, datë 23.07.2014 me afat kohor 90 ditë, subjekti ka kërkuar shtyerjen e afatit të RLP-së nr. 2349/1, datë 10.10.2014, i cili nuk është marrë në konsideratë nga D.D.Rinas, por është pranuar në heshtje. Për thyerjen e afatit të RLP-së është mbajtur procesverbali nr. 3292, prot datë 30.10.2015 dhe me shkresën nr. 3284 prot, datë 30.10.2015 është njoftuar D.D.Sarandë, për tejkalimin e afatit të autorizimit. Nga shkelja e kryer rezulton një detyrim doganor i papaguar në vlerë 2,992,952 lekë, për të cilin është zbatuar një gjobë sa njëfishi detyrimit në vlerë 2,992,952 lekë, ose në total në vlerë 5,985,904 lekë.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

8. Prokuroria e Përgjithshme me NIPT J62410014F, në vlerë 658, 606 lekë ka importuar një “makinë përpunimi automatik” të dhënash, për të cilën Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka lëshuar autorizimin nr.15043/1, datë 13.09.2011. DPD-ja me shkresën nr. 29340/1, datë 09.12.2014 ka miratuar shtyerjen e afatit të autorizimit deri më 09.11.2015. Në praktikat shkresore nuk jepet sqarim për shkelje doganore. DPD-ja me shkresën nr. 26792, datë 04.11.2015 ka miratuar shtyerjen e afatit të autorizimit deri më 09.05.2016 edhe në këtë rast nuk bëhet fjalë për shkelje të RLP-përkohshëm. Grupi i Auditimit të KLSH-së vlerëson se mund të kemi të bëjmë me thyerje të afateve të RLP-së dhe për rrjedhojë rezulton një detyrim doganor në vlerë 329,303 lekë, për të cilin është rekomanduar të zbatohet një gjobë në vlerë sa njëfishi detyrimit të papaguar në vlerë 329,303 lekë ose në total 658,606 lekë.

Nga auditimi i procedurave të zbatuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Dogana (Departamenti Teknik), bazuar në kërkesat e dërguara nga Prokuroria e Përgjithme, për shtyerjen e afateve të përdorimit të Regjimit të Lejimit të Përkohshëm të përcaktuar në autorizimet doganore nr. 14836, datë 09.11.2010, nr. 15043/1, datë 13.09.2011 dhe nr. 2159/1, datë 07.02.2012, me shkresat nr. 15816/1 prot, datë 20.09.2013 ka njoftuar subjektet përkatëse për shtyerjen e afateve deri më datë 09.11.2014, me shkresën nr. 29340/1 prot, datë 09.12.2014 ka njoftuar shtyerjen e afateve deri më 09.11.2015, me shkresën nr. 26792/1, prot, datë 04.11.2015 ka njoftuar shtyerjen e afateve deri më 09.05.2016, me shkresën nr. 1605 prot datë 19.05.2016 (protokolli i doganës) ka njoftuar shtyerjen e afatit deri më 09.11.2016, me shkresën nr. 28889/1 prot, datë 16.12.2016, ka njoftuar shtyerjen e afatit deri më 09.05.2017, me shkresën nr. 10876/2 prot, datë, 05.05.2017 ka njoftuar shtyerjen e afatit deri më 09.08.2017, me shkresën nr. 17031/1, date 26.07.2017 ka njoftuar shtyerjen e afatit deri më 09.10.2017 dhe me shkresën nr. 45/2 prot, datë 02.11.2017 ka njoftuar shtyerjen e afatit deri më 09.04.2018, në

Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

C-MASA DISIPLINORE

1. Në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” neni 59 dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Degës së Doganës Rinas dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, që në vlerësim të shkeljeve të mëposhtme, në zbatim të nenit 57/1 dhe 58, të ligjit 152/2013, të fillojnë procedurat për shqyrtimin dhe dhënien e masës, sipas nenit 59/2;



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

“pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë , përfshi rritjen e shkallës së pagës për një periudhë kohe deri në dy vjet”, për punonjësit civil;

- Athina Fagu, me detyrë doganier, kontroll fizik, klasifikim-vlerësim doganor
- Suzana Këlliçi, me detyrë doganier, kontroll fizik, klasifikim-vlerësim doganor
- Alma Pulake, me detyrë doganier, kontroll fizik, klasifikim-vlerësim doganor
- Kreshnik Çeliku, me detyrë doganier, kontroll fizik, klasifikim-vlerësim doganor

Nga 4 masa disiplinore të rekomanduara për zbatim nga KLSH-ë, janë zbatuar 4.
Rekomandimi është zbatuar plotësisht;

Në përfundim

I. Nga auditimi i ushtruar në Degën e Doganës Rinas, *“Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në auditimin e mëparshëm”*, u konstatua se

-nga **10 Masa Organizative** të rekomanduara janë zbatuar plotësisht 9 masa, është zbatuar pjesërisht 1 masë, (Masa 3).

-nga **8 Masa Shpërblim Dëmi** të rekomanduara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në vlerë 18,418,733 lekë, janë zbatuar plotësisht 7 masa, në vlerë 11,100,154 lekë, ose në masën 60 %, nuk është zbatuar një rekomandim (masa 7) **në vlerë 5,985,904 lekë dhe**

-nga **4 Masa Disiplinore** të rekomanduara janë zbatuar plotësisht 4 masa.

II. Nga auditimi dhe analiza e dokumenteve për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ë, në auditimin e mëparshëm u konstatua se; subjekti *“Agjencia Kombëtare e Bregdetit”* me NIPT L41417451U, nëpërmjet DAV-ë R-15364 datë 23.07.2014, ka importuar nga USA *“Pajisje kërkimore nënujore”* me KT 90158099 nën Regjimin e Lejimit të Përkohshëm, për të cilin D.D.Rinas ka lëshuar autorizimin nr. 2349 prot, datë 23.07.2014 me afat kohor 90 ditë, subjekti ka kërkuar shtyrjen e afatit të RLP-së nr. 2349/1, datë 10.10.2014, i cili nuk është marrë në konsideratë nga D.D.Rinas. Për thyerjen e afatit të RLP-së është mbajtur procesverbali nr. 3292, prot datë 30.10.2015 dhe me shkresën nr. 3284 prot, datë 30.10.2015 është njoftuar D.D.Sarandë, për tejkalimin e afatit të autorizimit. Nga shkelja e kryer rezulton një detyrim doganor i papaguar në vlerën 2,992,952 lekë, për të cilin është zbatuar një gjobë sa njëfishi detyrimit në vlerë 2,992,952 lekë, ose në vlerën totale në vlerë **5,985,904 lekë**.

Për sa më sipër mbajtur dhe trajtuar nga ana e audituesit është mbajtur **Akt-Konstatimi nr .1 datë 02.03.2018**dhe nga subjekti i audituar nuk ka komente dhe shpjegime:

Gjetje dhe Rekomandime për këtë pikë auditimi

Drejtimi nr. 1 *“Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshëme”*

Titulli i Gjetjes 1

Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm

Situata:

Nga auditimi u konstatua se nuk rezulton e zbatuar një masë për shpërblim dëmi e rekomanduar më parë në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr. 1112/8 prot, datë 31.03.2016, protokolluar pranë Degës Doganore Rinas me shkresën nr. 1084 prot, datë 05.04.2016 për subjektin *“Agjencia Kombëtare e Bregdetit”* me NIPT L41417451U për thyerjen e afatit të RLP-së është rekomanduar një detyrim doganor i papaguar në shumën 2,992,952 lekë dhe një gjobë sa njëfishi detyrimit në vlerë 2,992,952 lekë, me një detyrim total të pazbatuar në shumën **5,985,904 lekë**.

Kriteri :

Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*.



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

Ndikimi/Efekti	Konstatohet moszbatim i rekomandimeve të lëna më parë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në shumën totale 5.985.904 lekë .
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	Dega Doganore Rinas në cilësinë e organit administrativ juridiksional të analizojë rekomandimin e pazbatuar duke marrë masa të menjëhershme për analizimin e shkaqeve dhe përgjegjësive konkrete ligjore për moszbatimin e tyre. Nga Dega Doganore Rinas të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme verifikuese dhe administrative ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit me qëllim kontabilizimin e shumës prej 5,985,904 lekë rekomanduar më parë në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr. 1112/8 prot, datë 31.03.2016, protokolluar pranë Degës Doganore Rinas me shkresën nr. 1084 prot, datë 05.04.2016.

Menjëherë

Drejtimi i II “Auditim mbi të Ardhurat Doganore”

Në zbatim të pikës 2 të programit të auditimit nr. 1347/1, datë 19.01.2018, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1. Programimi nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për të ardhurat vjetore detajuar sipas muajve dërguar në Degën e Doganës Rinas, për periudhën në auditim, vitet 2016-2017.*
- 2. Evidencat me të dhënat e programimit dhe realizimit të të ardhurat doganore të përgatitura dhe të administruara nga Drejtoria e Monitorimit, Planifikimit Strategjik dhe Analizës së të Ardhurve, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit si mësipër u konstatua se:

Nga autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas nuk janë zbatuar dispozitat e :

- Ligjit nr. 147/2015, datë 24.12.2015 “Për buxhetin e vitit 2016”, nenet 1, 2 dhe 8, mbështetur në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 30, Aktin Normativë nr. 1, datë 29.07.2016 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr. 147/2015, datë 24.12.2015 “Për Buxhetin e vitit 2016”, nenet 1 dhe 2.

- Ligjit nr. 130/2016, datë 15.12.2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, nenet 1, 2 dhe 8, mbështetur në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 30. Aktin Normativë nr. 2, datë 16.08.2017 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr. 130/2016, datë 15.12.2016 “Për Buxhetin e vitit 2017”, nenet 1 dhe 2; Aktin Normativë nr. 3, datë 06.11.2017 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr. 130/2016, datë 15.12.2016 “Për Buxhetin e vitit 2017”, nenet 1 dhe 2.

- Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 11 pikat 3-9 “Formalitetet, kontrollet, mbikëqyrja dhe kompetencat e autoriteteve doganore”.

- Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 i Ministrisë së Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhënat e disponueshme, si dhe zhdoganimin e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit të tyre”, pika 2.

- Plani të ardhurave doganore dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për vitet 2016-2017. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për DDRinas, ka dërguar me shkresa te veçanta mujore, planin e të ardhurave doganore për tu mbledhur për vitin 2016 në vlerë 2,777,000 lekë i detajuar sipas muajve dhe në strukturë. Të ardhurat doganore për tu mbledhur për vitin 2017 janë programuar në vlerë **2,668,422** mijë lekë, të dërguara nga DPD



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

me shkresën nr. 3053 prot, datë 06.02.2017 për janar – qershor 2017. Për 6-mujorin e II-të 2017, nuk u paraqit shkresë e DPD, dhe për evidencë u morr evidenca e raportuar nga DPD.

Planikimi i të ardhurave paraqitet si më poshtë vijon:

Planifikimi të ardhurave doganore 2016-2017

(në 000 lekë)

Nr	Te ardhura sipas llojit	Plani 2015	Plani 2016	Plani 2017
1	Taksa Doganore	166,877	112,408	118,819
2	TVSH	3,026,244	2,604,164	2,544,889
3	Akciza	5,122	54,522	4,696
4	Renta Minerare	23	5,906	18
	Shuma	3,198,266	2,777,000	2,668,422

Plani i të ardhurave të vitit 2016 është programuar në shumën **2,777,000 mijë lekë**, ose në vlerë absolute 421,266 mijë lekë ose 13% më pak krahasuar me planin vitin 2015. Në vitin 2017 të ardhurat janë planifikuar në shumën **2,668,422 mijë lekë**, ose në vlerë absolute në masën 108,578 mijë lekë ose 4% më pak se plani të ardhurave të vitit 2016. Siç shihet nga të dhënat e mësipërme plani i të ardhurave për këtë degë doganore nga viti në vit ka pësuar ulje. **Të ardhurat doganore për vitin 2016** të realizuara nga kjo degë doganore paraqiten në shumën 2,673,484 mijë lekë kundrejt 2,777,000 mijë lekë të planifikuara, duke realizuar më pak të ardhura në masën 103,516 mijë lekë ose realizim në masën 96%.

Realizimi të ardhurave 2016

(në 000 lekë)

Nr	Te ardhura doganore	Planifikuar	Realizuar	Diferenca	Realizimi në %
1	Taksa Doganore	112,408	110,349	3,922	103%
2	TVSH	2,604,164	2,557,207	-52,937	98%
3	Akciza	54,522	5,919	-48,603	11%
4	Renta Minerare	5,906	8	-58,98	0%
	Shuma	2,777,000	2,673,484	-103,516	96%

Të ardhurat doganore 2016 të programuara dhe të realizuara sipas muajve, në strukturë:

2016	Taksa		Akciza		Tvsh		Renta		Totali		Ne %
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	
Janar	8,508	7,688	48,442	33	137,144	185,339	5,906	4	200,000	193,065	97
Shkurt	6,800	13,045	30	93	178,170	172,919	-	-	185,000	186,057	101
Mars	10,000	7,536	100	40	234,900	175,101	-	-	245,000	182,677	75
Prill	9,800	9,090	100	1,741	205,100	209,409	-	4	215,000	220,245	102
Maj	9,500	8,646	1,500	258	209,000	194,068	-	-	220,000	202,972	92
Qershor	10,000	9,819	450	938	249,550	258,126	-	-	260,000	268,883	103
Korrik	10,000	9,259	1,000	210	243,000	214,868	-	-	254,000	224,337	88
Gusht	7,000	7,798	200	846	182,800	171,223	-	-	190,000	179,867	95
Shtator	9,000	8,974	1,000	251	208,000	171,697	-	-	218,000	180,921	83
Tetor	12,000	9,152	500	784	232,500	207,083	-	-	245,000	217,018	89
Nëntor	10,000	8,769	1,000	176	229,000	238,027	-	0	240,000	246,972	103
Dhjetor	9,800	16,553	200	549	295,000	353,367	-	-	305,000	370,470	121
Viti	112,408	116,330	54,522	5,919	2,604,164	2,551,227	5,906	8	2,777,000	2,673,484	96

Nga analiza e të ardhurave doganore rezulton:

Me mosrealizim rezulton TVSH si zëri kryesor i të ardhurave, me peshë specifike 95.7% të planit të të ardhurave. Ky zë është realizuar në vlerën 2,557,208 mijë lekë, ose 46,956 mijë lekë më pak se plani, ose me realizim në masën 98 %.

Me mosrealizim paraqiten të ardhurat nga taksa doganore, akciza dhe renta minerare, të cilat në total zënë 4.3% të planit të të ardhurave. Edhe pse këto zëra kanë peshë të vogël specifike në totalin e të ardhurave, për çdo zë ato rezultojnë me mosrealizim, si taksa doganore rezulton me mosrealizim në shumën 2,059 mijë lekë ose realizim në masën 98%, akciza




KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

rezultojnë me mosrealizim në shumën 48,603 mijë lekë ose realizim në masën 11% dhe renta minerare me mosrealizim në shumën 5,898 mijë lekë ose realizim në masën 0.1%.

Grafikisht planifikimi të ardhurave 2016-2017 paraqitet si më poshtë vijon:



Të ardhurat doganore për vitin 2017 të realizuara nga dega e doganës paraqiten në shumën 2,532,894 mijë lekë. Të ardhurat janë realizuar më pak nga planifikimi në masën 135,528 mijë lekë ose ato janë realizuar në masën 95%.

Realizimi të ardhurave 2017

(në 000 lekë)

Nr	Te ardhura doganore	Planifikuar	Realizuar	Diferenca	Realizimi në %
1	Taksa Doganore	118,819	112,937	-5,882	95%
2	TVSH	2,544,889	2,401,854	-143,035	94%
3	Akciza	4,696	18,077	13,381	385%
4	Renta Minerare	18	26	8	144%
	Shuma	2,668,422	2,532,894	-135,528	95%

Të ardhurat doganore 2017 të programuara dhe të realizuara sipas muajve, në strukturë:

2017	Taksa		Akciza		Tvsh		Renta		Totali		Ne %
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	
RINAS											
Janar	10,263	6,370	364	28	191,981	200,855	1	-	202,610	207,253	102
Shkurt	9,425	6,218	339	429	205,324	176,496	1	-	215,089	183,142	85
Mars	8,194	8,563	313	4,052	199,440	200,179	0	0	207,948	212,794	102
Prill	9,256	7,932	381	189	209,639	197,037	1	-	219,278	205,157	94
Maj	11,370	9,235	371	586	211,667	213,323	10	-	223,418	223,144	100
Qershor	9,376	12,093	396	812	207,701	198,956	0	15	217,474	211,875	97
Korrik	11,651	9,733	426	895	244,327	191,746	1	1	256,404	202,375	79
Gusht	11,095	9,471	471	3,234	223,082	158,797	1	0	234,648	171,502	73
Shtator	8,196	7,977	327	752	181,083	170,897	0	8	189,606	179,634	95
Tetor	9,914	12,630	435	1,820	213,740	202,675	0	-	224,090	217,126	97
Nentor	10,040	11,119	436	4,786	227,381	221,295	1	2	237,858	237,202	100
Dhjetor	10,040	11,597	436	493	229,523	269,599	1	0	240,000	281,689	117
Viti	118,819	112,937	4,696	18,077	2,544,889	2,401,854	18	26	2,668,422	2,532,894	95


Nga analiza e të ardhurave doganore rezultojnë: TVSH-ja si zëri kryesor i të ardhurave rezultojnë me mosrealizim Ky zë është realizuar në vlerën 2,401,854 mijë lekë, ose më pak se plani në shumën 143,035 mijë lekë, ose me realizim në masën 94%. Me mosrealizim paraqiten të ardhurat nga taksa doganore për 5,882 mijë lekë më pak se plani, ose me realizim në masën 95%. Me realizim rezultojnë akciza në shumën 13,381 mijë lekë, ose realizim në masën 385% dhe renta minerare me realizim në shumën 8 mijë lekë ose realizim në masën 144%, por tregues që nuk influencojnë në performancën e degës doganore pasi këto zëra përbëjnë vetëm 0.18% të totalit të të ardhurave.

Grafikisht të realizimi të ardhurave kryesore në vitet 2016-2017 paraqitet si më poshtë:



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”



Të ardhurat dytësore të realizuara nga DD Rinas në:

➤ **vitin 2016** paraqiten në total 7,720,917 lekë, nga të cilat të ardhurat nga gjobat, sekuestrot, kamatëvonesat janë 7,464,351 lekë ose 97% e totalit të këtyre të ardhurave, të ardhurat nga shitja e mallrave e shërbimeve janë 194,650 lekë ose 3% të totalit të këtyre të ardhurave dhe të ardhurat nga tarifa administrative dhe rregullatore janë realizuar në masën 61,916 lekë ose 1% të këtyre të ardhurave.

➤ **vitin 2017** të ardhurat dytësore paraqiten në total **4,312,913** lekë, nga të cilat të ardhurat nga gjobat, sekuestrot, kamatëvonesat janë 3,876,188 lekë ose 96 % e totalit të këtyre të ardhurave, të ardhurat nga shitja e mallrave e shërbimeve janë 141,100 lekë ose 4% të totalit të këtyre të ardhurave .

Nr	EMERTIMI	Llog.	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017
			(lekë)	(lekë)	(lekë)
1	Të ardhurat nga tarifa administrative dhe rregullatore		349,734	61,916	0
2	Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	7113	153,250	194,650	141,100
3	Të ardhura nga gjoba dhe kamatëvonesa, sekuestime e zhdëmtime	7115	6,224,994	7,464,351	3,876,188
Totali			6,727,978	7,720,917	4,017,288

Veprimet në kontabilitetin e degës mbahen në programin Alfa Platinum. Dega doganore ka dorëzuar llogarinë vjetore Degën e Thesarit Tiranë dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave sipas përcaktimeve në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 14 datë 28.12.2006, i ndryshuar, për:

- vitin 2016, në me shkresën nr. 649, datë 21.02.2017.

- vitin 2016, në me shkresën nr. 751, datë 26.02.2018.

Nga auditimi i rregullshmërisë në paraqitjen e të ardhurave rezulton se ato janë të pasqyruara në Formatin Nr. 3/2 të bilancit vjetor. Të ardhurat dytësore jo tatimore për vitin 2016 paraqiten 7,720,917 lekë dhe për vitin 2017 paraqiten 4,017,288 lekë. Nga krahasimi të ardhurave dytësore të pasqyruara në bilanc dhe të ardhurave dytësore të raportuara në situacionin përfundimtar, konfirmuar nga dega e thesarit, rezultoi se ato ishin pasqyruar saktë dhe nuk ka devijime.

Në përfundim të dhënat e paraqitura si mësipër tregojnë se gjatë periudhës së audituar vitet 2016,2017 dhe autoriteti doganor kompetent Dega e Doganës Rinas nuk i ka realizuar të ardhurat doganore në total dhe në strukturë në zbatim të programeve të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, duke krijuar **një diferencë në të ardhurat doganore në vitin 2016 në vlerë 103,501 mijë lekë, ose në masën 96% dhe diferencë në realizimin e të ardhurave doganore gjatë vitit 2017 në vlerë 135,528 mijë lekë, osenë masën 95 %**, veprim i cili tregon për punën e pamjaftueshme që ka kryer autoritet doganor kompetent, lidhur me përmbushjen e njërit prej misionëve më të rëndësishme që i ka ngarkuar atij “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

Nw lidhje me sistemet e kontrollit qw funksionojnë pranw Degws Doganore Rinas verifikua veprimtaria e kryer nga specialisti i kontrollit pas zhdoganimit dhe u konstatua se:

Për periudhen një vjecare të vitit 2017 nga ana e sektorit Kargo rezulton se janë bërë 2145 kontrole fizike si dhe janë bërë 1048 rivlerësime deklaratah doganore. Ushtrimi i sistemeve të kontrollit në Degën e Doganës Rinas ushtrohet nga një specialist i vetëm, i cili mbulon edhe detyrën e analizës së rrishtit njëkohësisht etj. Sektori i kontrollit pas zhdoganimit gjatë kësaj periudhe një vjetore në ushtrimin e kontroleve ka patur përparësi sidomos një kategori të caktuar artikujsh dhe produktesh qe zhdoganohen prane kesaj dege doganore dhe qe paraqesin nje rrisht me te larte sic jane: implantet e ndryshme dentare me qellim verifikimin e faktit nese perfitojne nga perjashtimi i TVSH-se apo jo, ku per kete qellim i eshte drejtuar nje kerkese edhe Qendres Kombetare te Barnave; artikullit “skeletet e syzeve” me qellim verifikimin e vleres se tyre ku jane derguar per verifikim fature disa nga keto praktika prane autoriteteve homologe; artikujt e celulareve ku ka patur ne disa raste rivleresime te ketyre artikujve; pjeset e kembimit per te cilat nuk ka rezultuar ndonje parregullsi. Gjithashtu, përparësi në punën e tij aposteriroi ka patur edhe verifikimin e dokumentacionit për qëllime të verifikimit të vertetësisë se origjines preferenciale te mallrave si dhe eshte kerkuar rishikim i profileve te rrishtit per banknotat, per veshjet e stafit te ambasadave; per duty free, per exportet nga magazinat doganore. Nje problematike tjeter e konstatuar nga ana e kontrollit te ushtruar nga aposteriori lidhur me subjektin e “AIR BP Albania” e cila si objekt te veprimtarise se saj ka furnizimin me karburant te avioneve, ka te beje me deklarimin e pasakte te peshes se karburantit si rrjedhoje e ngaterrimit te koeficientit te densitetit te lengut.

Në total jane hartuar 56 proces verbale me vlere totale te ardhurash 5,399,250 leke, taksa doganore 1,845,963 leke dhe 3,544,287 leke penalitete.

Analiza e Rrishtit:

Gjate vitit 2017 sistemi i analizes se rrishtit pjesen me te madhe te deklaratave doganore i ka kaluar per kontroll dokumentar reth 93 % te dav-ve. Ne kanal in Blu jane goditur 426 deklarata doganore te cilat kane qene objekt i kontrollit aposterior. Ne kanal in e kuq sistemi ka perzgjedhur reth 2146 deklarata doganore ose 7% te dav-ve. Nga kontrolli ne system i dav-ve ne kanal in Blu ka rezultuar se: Deri tani sistemi ka perzgjedhur shume deklarata te agjensise Doganore DHL International ku jane konstatuar probleme të ndryshme të parregullsisë në deklarim sic janë deklarimi i gabuar i monedhës, NIPT-it, deklarimit dy herë të të njëjtit mall, peshat etj. Ne sistem nga ana e agjensive doganore skanohen dokumentat tregtare pa firme e vule vetem ne format te bardhe dhe me keto dokumenta kryhen deklarimin/zhdoganimin e mallit.

Jane propozuar për implementin nga DARM-ja (Drejtoria e Analizës së Rrishtit dhe Monitorimit)

Rishikim profile Risku per niptet shetitese gjithesej 4 raste/Rishikim profil risku per palet e lidhura nje rast/Rishikim profil risku per shitblerjet triangolare nje rast/Rishikim profil risku per mallrat me vlere te vogla nje rast/Rishikim profil risku per pajisjet dentare/Rishikim profil risku per lulet natyrale qe vijne nga vende me rrisht te larte/Rishikim profil risku per mallrat e punonjesve te ambasades qe transferojne vend banimin/Rishikim profil risku per bangnotat e deklaruar nga bankat/Rishikim profil risku per mallrat e deklaruar per magazinën doganore duty free.

Për sa më sipër mbajtur dhe trajtuar nga ana e audituesit është mbajtur Akt-Konstatimi nr . 2 datë 02.03.2018 dhe nga subjekti i audituar nuk ka komente dhe shpjegime :

Gjetje dhe Rekomandime

Drejtimi nr. 2 “Auditimi i realizimit të të ardhurave doganore”



KONTROLLI I LARTE I SHTESTIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

Titulli i Gjetjes 1 Mosrealizim i të ardhurave doganore dhe masa të rekomanduara për përmirësimin e të ardhurave doganore

Situata: Nga auditimi i ushtruar mbi programimin dhe realizimin e të ardhurave doganore gjatë periudhës së audituar të viteve 2016 dhe 2017u konstatua se nga Dega e Doganës Rinas nuk janë realizuar të ardhurat doganore në krahasim me programimin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, duke krijuar një diferencë të përgjithshme në vlerën **239,029 mijë lekë** të rezultuar gjatë viteve 2016-2017 në përmbushje të misionit që i janë ngarkuar sipas ligjit nr. 8449, datë 20.01.1999 “Kodi Doganor në RSH”,

Kriteri : Ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

Ndikimi/Efekti Konstatohet mosrealizim i të ardhurave doganore në shumën **në vlerën 239,029 mijë lekë** për periudhën 2016 deri 2017 në të ardhurat e Buxhetit të Shtetit midis planit të programuar dhe realizimit faktik

Rëndësia E lartë

Rekomandimi Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinastë marrë masa të plota ligjore e administrative me plane konkrete për të analizuar në mënyrë të përditësuar zbatimin e masave që janë marrë dhe që do të merren për realizimin e të ardhurave doganore sipas të gjithë zërave respektive në përputhje të plotë me programimin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për përmbushjen e misionit që i është ngarkuar sipas ligjit nr. 8449, datë 20.01.1999 “Kodi Doganor në RSH” i ndryshuar dhe ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi i Ri Doganor në RSH” i ndryshuar, duke nxjerrë dhe përgjegjësitë përkatëse të stafit të doganor në përputhje me funksionet që ata kryejnë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Drejtimi nr. 3 i Auditimit “Auditimi i sistemit të vlerësimit doganor dhe klasifikimit tarifor të mallrave gjatë procedurave të zhdoganimit për periudhën nën auditim”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me Drejtimin e 3 të auditimit “Auditimi i sistemit të vlerësimit doganor dhe klasifikimit tarifor të mallrave gjatë procedurave të zhdoganimit për periudhën nën auditim”, në lidhje me procedurat e kryera nga personeli përpunues doganor gjatë procesit të vlerësimit të sistemit të vlerësimit doganor, klasifikimit tarifor të mallrave dhe kushteve të përfitimit të trajtimit tarifor preferencial favorizues të kryera nga Autoriteti Doganor Rinas për periudhën 01 Janar 2016 deri më 01.12 2017 u audituan me përzgjedhje procedurat dhe dokumentacioni ligjor respektiv. Në zbatim të pikës nr. 3 të Programit të Auditimit “nr. 1347/1 prot, datë 19.01.2018”, u konsiderua si e nevojshme mbajtja, në ambientet e Degës Doganore Rinas, i një akt konstatimi nga audituesit e KLSH-së z Altin Dinaj, znj. Elida Kocani.

1. Dokumentacioni tregtar me përzgjedhje i praktikave doganore të importit për periudhën nën auditim të administruara nga Dega Doganore Rinas
2. Të dhënat elektronike të zhdoganimeve të kryera të siguruara nga sistemi elektronik.



KONTROLLI I LARTE I SHETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

Nga auditimi me përzgjedhje i dokumentacionit të paraqitur në lidhje me procedurat e kryera nga personeli përpunues doganor gjatë procesit të vlerësimit të sistemit të vlerësimit doganor, klasifikimit tarifor të mallrave të kryera nga Autoriteti Doganor Rinas për periudhën 01 Janar 2016 deri më 31 dhjetor 2017 rezultuan **konstatimet si më poshtë:**

♦. Në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave të natyrës veshje të deklaruara në kapitullin 61 dhe 62 të Nomenklaturës së Mallrave në RSH konstatohet se nga personeli përpunues doganor nuk është marrë në konsideratë shkresa nr. 779 prot DPD datë 16.01.2013 “**Mbi rishikimin e disa Indikatorëve shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE**”, përcaktohet se niveli i vlerësimit doganor për mallrat e klasifikuara në kreun *61* dhe *62* nuk duhet të jetë më i ulët se 1350 lekë/kg. Për mallrat të deklaruar në kreun 61 dhe 62 nuk është ndërhyrë nga personeli përpunues doganor për të vjelë detyrimet doganore bazuar në vlerën e mallit prej 1350 lek/kg sipas kushtit CIF si dhe nuk është marrë në konsideratë fakti se “**nëse gjatë deklarimit të këtyre mallrave në doganë konstatohen raporte me te ulëta se sa indikatorët e kontrollit shtesë sipas tabelës së mësipërme, strukturat e degës doganore të kryejnë të gjitha ndërhyrjet e nevojshme, përfshi edhe kontrollin e detajuar fizik me qëllim që të shmangen anomalitë e mundshme në vlerësimin doganor të mallrave dhe sidomos të vlerës se mallrave me peshën e tyre**”. Gjithashtu dokumentacioni tregëtar bashkangjitur praktikave doganore të mëposhtme nuk përmbush edhe kushtet për trajtim vlerësimi sipas metodës së transaksionit sipas nenit 34 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “**Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë**”, i ndryshuar; dhe nenit 65 deri 70 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë.

Shkresa nr. 779 prot DPD datë 16.01.2013 “Mbi rishikimin e disa Indikatorëve shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE”

Sa më poshtë tabela e rasteve ku nuk është marrë në konsideratë përcaktimi ligjor i shkresës nr.779.

Viti	DAV	Subjekt	Nipt	HS4	Kodi	Përshkrimi	Pesha	Detyrimi
2016	46	Ad Distribution	K21308001C	6105	61051000	Veshje	38	2207
2016	10413	Amerikan Style	K31609019T	6110	61109090	Veshje	62	2450
2016	10413	Amerikan Style	K31609019T	6110	61109090	Veshje	62	2450
2016	21419	Marxh	K51510008I	6204	62044990	Veshje	40	2579
2016	25188	Fatmira Pali	K31427125P	6110	61109090	Veshje	61	4816
2016	14851	Alitalia	L44817202A	6104	61041990	Veshje	95	7522
2016	23971	Merita Merja	K92116018Q	6204	62044400	Veshje	180	20444
2017	16700	Plus Fashion	L02324001O	6108	61083100	Veshje	17	2132
2017	20022	Conf-Im	L12412502T	6217	62179000	Veshje	50	3252
Totali							624	50,162

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe nënligjore të bëra në: Udhëzimit nr. 25 datë 16.05.2006 të DPD, “Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore”, Shkresa nr. 779 prot DPD datë 16.01.2013 “**Mbi rishikimin e disa Indikatorëve shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE**”

Vlera prej 50,162 lekë, e cila përfaqëson detyrim doganor të munguar do të konsiderohet e ardhur doganore e munguar në Buxhetin e Shtetit.

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 3, datë 02.03.2018 dhe për këtë çështje subjekti i audituar, ka bërë *komente dhe shpjegime* me shkresën nr. 1347/7 Prot KLSH datë 25.04.2018 dhe shkresën nr. 1597 prot DDRinas datë 24.04.2018.

*Me shkresën nr. 1597 prot DDRinas datë 24.04.2018 dhe trajtime që u bënë gjatë fazës ballafaqese në KLSH më datë 30/04.2018 ku u pranua konstatimi i kryer nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe u deklarua nga përfaqësuesit e Degës Doganore Rinas marrja e menjëhershme e masave për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve doganore në shumën 50,162 lekë nga ngarkim të subjekteve të mësipërm për mallin e deklaruar “**veshje**” duke ritrajtuar edhe veprimet e kryera nga personeli përpunues doganor*



KONTROLLI I LARTE I SHETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

◆. Në lidhje me deklarimin doganor të kryer gjatë procedurave deklaruese nr R 2677 datë 07.02.2017 të subjektit “**BOSEP**” shpk me NIPT K81325505R janë deklaruar artikuj të natyrës “Monitorë LCD” të tipit SAMSUNG 15 copë të madhësisë 55” të deklaruar në faturën e mallit nr UD20161222A datë 14.01.2016 lëshuar nga kompania “**Shenzen Usenda Digital Tecnology Limited Company**” të deklaruar në kodin tarifor 85312000. Nga subjekti “BOSEP” shpk me nipt K81325505R ky mall është deklaruar në kreun *8531* ku klasifikohen **Aparaturat elektrike të sinjalizimit me tingull ose vizuale (psh, zilet, sirenat, panelet e treguesve, alarmet që paralajmërojnë vjedhjet ose zjarrin), të ndryshme nga ato të kreut 8512 ose 8530** dhe konkretisht në kodin 85312095 me tarifë doganore 0%.

Ky artikull referuar përskrimeve dhe shpjegimeve të Nomenklaturës së Mallrave në RSH të publikuar për vitin 2017 klasifikohet në kreun 8528 “**Monitorët dhe projektorët pa aparat marrës për televizion të trupëzuar; aparatet marrëse për televizione, dhe të trupëzuara me radiotransmetuese apo aparate regjistrimi apo riprodhimi video apo të tingullit:– Monitorë me tuba me rreze katodike**” dhe konkretisht në kodin tarifor 85285900” me tarifë bazë 2%.

Neni 261 i Kodit Doganor

“Pa rënë ndesh me dispozitat mbi kontrabandën, përbën kundërvajtje administrative doganore deklarimi i një cilësie, sasi, vlere ose origjine të ndryshme nga ajo që konstatohet autoritetet doganore, në çastin kur deklaruesi paraqet deklaratën për vendosjen e mallrave në qarkullim të lirë. 2. Në rastet kur pas rishikimit të deklaratës rezultojnë detyrimet doganore që duhen paguar janë më të larta se ato të llogaritura në bazë të deklaratës dhe diferenca e këtyre është më e madhe sesa 5 për qind, në vend të gjobës së mësipërme, zbatohet një gjobë e barabartë me trefishin e diferencës së detyrimeve doganore të papaguara

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Dega Doganore Rinas të rishikojë deklarimin doganor të kryer në praktikën doganore nr. 2677 datë 07.02.2017 të subjektit “**BOSEP**” shpk me NIPT K81325505R duke marrë në konsideratë amendimin e deklaratës doganore referuar shpjegimeve të mësipërme me qëllim pagesën e detyrimit doganor në shumën totale **274,220 lekë** nga të cilat shuma prej 68,555 lekë dhe kontabilizimin dhe arkëtimin e gjobës doganore në shumën sa 3-fishi i detyrimit doganor në shumën 205,665 lekë të padeklaruar gjatë procedurave deklaruese doganore në kundërshtim me shpjegimet e pikës 2 të nenit 261 të Kodit Doganor.

Vlera prej 274,220 lekë, e cila përfaqëson detyrim doganor dhe penalitet do të konsiderohet të ardhura të munguara shkaktuar Buxhetit të Shtetit.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në: ligjin nr. 8449 datë. 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. z. Flora Gjini me detyrë ish/doganiere pranë në D.D.Rinas

◆. Në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave të natyrës plastike të deklaruar në kapitullin ***39* të Nomenklaturës së Mallrave në RSH** konstatohet se rezultojnë deklarime të këtyre mallrave më tarifë bazë 0% për mallra me origjinë jashtë kushtit preferencial MSABE. Këto janë mallra që sipas funksioneve që janë deklaruar dhe përshkrimit të tyre duhet të ishin deklaruar në krerët respektivë të kapitullit 39 me tarifë bazë 6% dhe specifikisht në kreun ***3924* dhe *3925*** për mallin këmbë plastike për stenda dhe ***392350*** me përshkrimin ***Tapat, kapakë, kupa dhe mbyllës të tjerë*** dhe më tej kodi ***39235090*** “**Te tjera**”

Rregulli nr. 3 i Nomenklaturës së Mallrave të publikuar për vitin 2017 përcakton se “**Kur nga zbatimi i rregullit 2 (b) ose për ndonjë arsye tjetër, mallrat janë, në pamje të parë, të klasifikueshme në dy apo me shumë krerë, klasifikimi do të ndikohet nga kriteret e mëposhtme: (a) kreu i cili jep përshkrimin me specifik do të preferohet nga krerët që japin një përshkrim më të përgjithshëm. Megjithatë, kur dy apo me shumë krerë secili i referohet vetëm pjesës së materialeve apo substancave që bëjnë pjesë në mallrat e përbëra apo të përziera, apo vetëm pjesës së artikujve në një grup të vendosur për shitjen me pakicë, këta**



KONTROLLI I LARTE I SHTESTIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

krerë do të vlerësohen njëlloj të specifikuar në lidhje me këto mallra, edhe nëse njëri prej tyre jep një përshkrim më të saktë apo më të plotë të mallrave”

Neni 261 i Kodit Doganor përcakton se:

“Pa rënë ndesh me dispozitat mbi kontrabandën, përbën kundërvajtje administrative doganore deklarimi i një cilësie, sasi, vlere ose origjine të ndryshme nga ajo që konstatojnë autoritetet doganore, në çastin kur deklaruesi paraqet deklaratën për vendosjen e mallrave në qarkullim të lirë. 2. Në rastet kur pas rishikimit të deklaratës rezulton që detyrimet doganore që duhen paguar janë më të larta se ato të llogaritura në bazë të deklaratës dhe diferenca e këtyre është më e madhe sesa 5 për qind, në vend të gjobës së mësipërme, zbatohet një gjobë e barabartë me trefishin e diferencës së detyrimeve doganore të paguara

Sa më poshtë tabela e rasteve ku janë konstatuar klasifikime të gabuara tariforë

VITI	DAV	SUBJEKTI	NIPT	KODI /DEKL	PERSHKRIMI	TARIF %	VL . STAT	DETYRIMI	EFEKTI FINANC
2017	11149	ElsiKumaraku	L71621014V	39269097	Kapak celularesh	0,2	37139	2600	10399
2017	721	EduartToska	K31604126G	39269097	Kapak celularesh	0,2	37247	2607	10429
2017	14496	Albtelekom	J61824053N	39239000	Kembe plastike	0,2	46161	3231	12925
2017	8778	TaulantFejzo	L12413012B	39269097	Kapak celularesh	0,2	82161	5751	23005
2017	5675	HasanShametaj	K32829409G	39269097	Kapak celularesh	0,2	84749	5932	23730
2017	865	Doruntina Pero	L61510022A	39269097	Kapak celularesh	0,2	92800	6496	25984
2017	11150	ElsiKumaraku	L71621014V	39269097	Kapak celularesh	0,2	102877	7201	28806
2017	3538	DoruntinaPero	L61510022A	39269097	Kapak celularesh	0,2	185305	12971	51885
2017	5314	DoruntinaPero	L61510022A	39269097	Kapak celularesh	0,2	215774	15104	60417
2017	4331	Entila Kryemadhi	L21401501O	39269097	Kapak celulare	0,2	66246	4637	13911
TOTALI								65,893	260,580

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Dega Doganore Rinas të rishikojë deklarinimin doganor të kryer në praktikën doganore të mësipërme duke marrë në konsideratë amendimin e deklaratave doganore referuar shpjegimeve të mësipërme me qëllim pagesën e detyrimit doganor në shumën totale **260,580 lekë** nga të cilat shuma prej **65,893 lekë** detyrim doganor dhe kontabilizimin dhe arkëtimin e gjobës doganore në shumën sa 3-fishi i detyrimit doganor në **shumën 193,687 lekë** të padeklaruar gjatë procedurave deklaruese doganore në kundërshtim me shpjegimet e pikës 2 të nenit 261 të Kodit Doganor.

Vlera prej 260,580 lekë, e cila përfaqëson detyrim doganor dhe penalitetet do të konsiderohet të ardhura të munguara shkaktuar Buxhetit të Shtetit.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në: ligjin nr. 8449 datë. 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Përsonei përpunues doganor i praktikave doganore të mësipërme: znj Flora Gjini me detyrë ish/doganier pranë në D.D Rinas aktualisht larguar, z. Përparim Tollia me detyrë ish/doganier pranë D.D.Rinas aktualisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave z.Luftar Hoxha me detyrë doganier pranë Degës Doganore Rinas, Albert Canaj me detyrë doganier pranë Degës Doganore Rinas.

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 3, datë 02.03.2018 dhe për këtë çështje subjekti i audituar, ka bërë komente dhe shpjegime me shkresën nr. 1347/7 Prot KLSH datë 25.04.2018 dhe shkresën nr. 1597 prot DDRinas datë 24.04.2018

Me shkresën nr. 1457 prot DDRinas datë 19.04.2018 i është kërkuar interpretim për qëllime të përcaktimit të klasifikimit tarifor për artikujt e konstatuar **”kapak plastik për celularë”** në konstatime deklarimesh të gabuara të klasifikimit tarifor për mallra të deklaruara dhe konstatuar sa më sipër gjatë procedurës audituese. Dega Doganore Rinas konkludon se në përfundim të veprimeve të Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës do të konkludojë për veprimet e mëtejshme në lidhje me kontabilizimin e detyrimeve doganore dhe penaliteteve për rastet e përmendur sa më sipër si dhe për përgjegjësinë e personelit doganor të përmendur sa më sipër gjatë kryerjes së detyrave funksionale në zbatim të legjislacionit doganor në fuqi.

♦. Në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave të natyrës ***Fibrat optike dhe tufat me fibra optike; kabllot me fibra optike te ndryshme nga ato te kreut 8544; flete dhe pllaka prej materiali polarizues; lentet (përfshi lentet me kontakt),prizmat, pasqyrat dhe elementet e**



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

tjerë optike, prej çdo materiali* të deklaruara në kapitullin 90 të Nomenklaturës së Mallrave në RSH konstatohet se rezultojnë deklarime të këtyre mallrave me nivel të ndryshëm vlere/njësi për mallra me origjinë jashtë kushtit preferencial MSABE. Gjithashtu konstatohet se nuk rezultojnë të dhëna të publikuara sit ë Dhëna të Disponueshme në RSH referime për artikullin **lentet (përfshi lentet me kontakt)**. Konstatohet se në praktika doganore specifike nga operatorë tregtarë deklarues pranë Degës Doganore Rinas janë deklaruar mallrat të natyrës **lentet (përfshi lentet me kontakt)** për të cilat është ndërhyrë nga personeli përpunues doganor me koeficient/ vlerësimi doganor dhe janë pranuar vlera të reja të transaktuara për artikujt *“lente optike, lente pamjesh, lente korrigjimi”*. Sa më poshtë rastet ekonstatuara ku është ndërhyrë nga personeli përpunues doganor për mallra *“lente optike, lente pamjesh, lente korrigjimi”*.

Transaksione të pranuar gjatë vitit 2016 dhe 2017

VITI	DAV	SUBJEKTI	NIPT	PERSHKRIMI	NJESI	VL/FOB/COP	KOEFIC.
2016	23106	Klinika Kristi	L04107001T	Lente optike	906	1,88	1,562
2016	20475	Ottica Bruna	J61828092H	Lente optike	430	1,71	1,772
2016	21238	Lab/Optik/Galeon	L22417007J	Lente/korrigji/shikim	643	2,70	2,056
2017	21010	Klinika Kristi	L04107001T	Lente pamjesh	107	2,47	3,551
2017	13936	Klinika Kristi	L04107001T	Lente optike	2859	1,72	1

Konstatohet se nga personeli përpunues doganor nuk është marrë në konsideratë shpjegimi i Udhëzimit nr. 25 datë 16.05.2006 të DPD „Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore”, si dhe shpjegimet e nenit 35 të ligjit nr. 8449, datë. 27.01.1999, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" nenit 54, titulli VI “Vlera Doganore” pika c, e VKM nr. 205 datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar, Neni 64 pika 1,b e VKM nr. 205 datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar, Pikës 4 e Sesionit I të Udhëzimit nr 25 datë 30.11.2007 “Për Procedurat e Shqyrtimit të Vlerës Doganore”.që trajtohen me legjislacionin e vjetër doganor dhe sipas nenit 70 pika 1 dhe 2 Ligji nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” që lidhet me “Metodën detyësore për vlerësimin doganor” gjatë procesit të vlerësimit doganor në nivelin më të ulët të pranuar nga Dega Doganore Rinas në **kuotën 1,71 euro/copa/fob**. Dega Doganore Rinas mbi bazën e transaksioneve alternative të pranuar për vitin 2016 dhe 2017 për artikullin *“lente optike, lente pamjesh, lente korrigjimi”* të nxjerrë dhe kontabilizojë detyrimet doganore të munguara të pasqyruara sa më poshtë duke marrë në konsideratë çmimin 1,71 euro/copa/fob. Baza ligjore që duhet të ishte marrë në konsideratë”:

Pika 4 e Sesionit I të Udhëzimit nr 25 datë 30.11.2007 “Për Procedurat e Shqyrtimit të Vlerës Doganore” përcakton se “Nëse nga analiza e indikatorëve të mësipërm, nuk justifikohet plotësisht vlera e transaksionit e deklaruar, pra është e dyshuar, njoftohet me shkrim deklaruesi (agjencia doganore ose përfaqësuesi) në rast se kërkohet nga subjekti deklarues. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Doganor, mund të përdoren metoda alternative të vlerësimit të mallrave (mallra identike/të ngjashme). Kjo e bazuar në të dhënat e transaksioneve të pranuar. Këto të dhëna janë të disponueshme edhe në formë elektronike, përmes moduleve të veçanta të ndërtuara për këtë qëllim në nivel qendror

Tabela e rasteve të konstatuara për rivlerësim malli për periudhën 2016 dhe 2017 për artikullin *“lente optike, lente pamjesh, lente korrigjimi”*

VITI	DAV	SUBJEKTI	NIPT	Artikull	Njesi	Dekl	Diferenc	Detyrim
2016	16945	Lab/Optik/Galeo	L22417007J	Lente optike	306	1,43	0,28	2514
2016	19038	Omega Optikal	K81901011V	Lente optike	224	1,23	0,48	3234
2016	6243	Griseilda Belshi	L11702020N	Lente optike	168	0,87	0,84	4203
2016	17981	Ottica Bruna	J61828092H	Lente optike	568	1,45	0,26	4419
2016	7862	Omega Optikal	K81901011V	Lente optike	646	1,24	0,47	8954
2016	2793	Ottica Bruna	J61828092H	Lente optike	713	1,21	0,50	10585
2016	22266	Ottica Bruna	J61828092H	Lente optike	873	1,29	0,42	10848
2016	5190	Lab/Optik/Galeo	L22417007J	Lente optike	538	1,00	0,71	11327
2016	16001	Fabian Kuqi	K81802502I	Lente optike	430	0,82	0,89	11430
2016	8592	Lab/Optik/Galeo	L22417007J	Lente optike	559	0,98	0,73	12126
2016	20530	Klinika Kristi	L04107001T	Lente optike	2823	1,56	0,15	12616
2016	4147	Optilux	L02401006L	Lente optike	7434	1,65	0,06	12704
2016	20803	Ottica Bruna	J61828092H	Lente optike	612	0,94	0,77	14096
2016	2421	Klinika Kristi	L04107001T	Lente optike	336	0,28	1,43	14286
2016	14683	Lab/Optik/Galeo	L22417007J	Lente optike	766	1,05	0,66	15119



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

2016	27813	Ottica Bruna	J61828092H	Lente optike	560	0,52	1,19	19921
2016	11572	InterOptik	L61314512N	Lente optike	6602	1,57	0,14	27621
2016	22456	Ottica Bruna	J61828092H	Lente optike	1328	0,33	1,38	54598
2016	676	Max-Optica	K91518506U	Lente optike	12228	1,50	0,21	76961
2016	24174	Ottica Bruna	J61828092H	Lente optike	2147	0,29	1,42	91019
2016	12111	Omega Optikal	K81901011V	Lente optike	3666	0,55	1,16	126576
2017	10365	Omega Optikal	K81901011V	Lente optike	112	1,24	0,47	1567
2017	25238	ZhanPina	K34129410Q	Lente optike	798	1,64	0,07	1639
2017	30369	ZhanPina	K34129410Q	Lente optike	1184	1,66	0,05	1855
2017	10252	Gen-Alb-Farm	K62220004U	Lente optike	80	0,27	1,44	3414
2017	25791	ZhanPina	K34129410Q	Lente optike	681	1,49	0,22	4395
2017	13677	Ottica Bruna	J61828092H	Lente optike	653	1,46	0,25	4900
2017	29159	Omega Optikal	K81901011V	Lente optike	523	1,39	0,32	5062
2017	27556	ZhanPina	K34129410Q	Lente optike	683	1,41	0,30	6003
2017	22127	Omega Optikal	K81901011V	Lente optike	450	1,25	0,46	6104
2017	24517	ZhanPina	K34129410Q	Lente optike	554	1,25	0,46	7672
2017	17849	Klinika Kristi	L04107001T	Lente optike	712	1,30	0,41	8657
2017	29769	InterOptik	L61314512N	Lente optike	7048	1,66	0,05	9921
2017	29061	Fabian Kuqi	K81802502I	Lente optike	249	0,17	1,54	11441
2017	18638	Fabian Kuqi	K81802502I	Lente optike	576	1,04	0,67	11446
2017	13084	Optilux	L02401006L	Lente optike	6653	1,63	0,08	16319
2017	5098	Visionaire	L62310011D	Lente optike	768	0,93	0,78	17834
2017	909	Omega Optikal	K81901011V	Lente optike	922	0,96	0,75	20497
2017	28693	Klinika Kristi	L04107001T	Lente optike	555	0,42	1,29	21352
2017	29258	Klinika Kristi	L04107001T	Lente optike	2090	1,28	0,43	27066
2017	5797	Klinika Kristi	L04107001T	Lente optike	2325	0,89	0,82	56714
2017	24980	Klinika Kristi	L04107001T	Lente optike	5700	1,06	0,65	110037
Totali								911,855

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që :

Në vijim të përcaktimeve ligjore të Udhëzimit nr. 25 datë 16.05.2006 të DPD „Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore”, të pikës 4 dhe ku përcaktohet se “Në zbatim të nenit 35 të Kodit Doganor, mund të përdoren metoda alternative të vlerësimit të mallrave (mallra identike/të ngjashme). Kjo e bazuar në të dhënat e transaksioneve të pranuar. Këto të dhëna janë të disponueshme edhe në formë elektronike, përmes moduleve të veçanta të ndërtuara për këtë qëllim në nivel”

qëndror 5.2 “Në rastet, kur për mallin e deklaruar nuk është e mundur të gjendet e dhënë referuese në “Dosjen e Të Dhënave të Disponueshme” atëherë në degën doganore ngrihet grup pune për përcaktimin e vlerës së mallit dhe vihet në dijeni zyrtarisht me shkrim Drejtori i Departamentit Teknik”

Dega Doganore Rinastë standardizojë procesin e vlerësimit doganor për artikullin “*lente optike, lente pamjesh, lente korrigjimi*” në kuotën **1,71 euro/copa/fob** në bashkëpunim me Drejtorin e Vlerës ne Drejtorine e Përgjithshme të Doganave.

Bazuar në transaksionet e pranuar Dega Doganore Rinas, të miratojë me proces-verbal vlerësimi doganor rezultatin e pranuar si dhe të informohet zyrtarisht **me shkrim Drejtori i Departamentit Teknik**.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe nënligjore të bëra në:

1. Ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
2. VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar
3. Udhëzimit nr. 25 datë 16.05.2006 të DPD „Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore”,
4. Ligji nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”

Vlera prej 911,855 lekë, e cila përfaqëson detyrim doganor të munguar do të konsiderohet e ardhur doganore e munguar në Buxhetin e Shtetit

♦. Në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave të natyrës ***Pajisje Alarmi*** të deklaruar në kapitullin ***8531* Aparaturat elektrike te sinjalizimit me tingull ose vizuale (p.sh, zilet, sirenat, panelet e treguesve, alarmet qe paralajmërojnë vjedhjet ose zjarrin), te ndryshme nga ato te kreut 8512 ose 8530:8531 10–Pajisje alarmi që paralajmërojnë vjedhjen ose zjarrin dhe aparatura te ngjashme** konstatohet se gjatë periudhës audituese 2016 dhe 2017 janë deklaruar pranë Degës Doganore Rinas mallra të kësaj natyre me tarifë 0% për mallrat e



KONTROLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

deklaruar të natyrës “Pjesë për sisteme alarmi” të deklaruar në kodet *85318070* “Te tjera” me tarifë doganore 0% dhe në kodin *85319000* ku deklarohen *Pjesët* me tarifë doganore bazë 0% si dhe mallra me tarifë 10% të deklaruar në kodet 6 shifrorë përkatësisht kodi *853110* dhe *853180*.

Konstatohet që artikulli “Pajisje alarmi dhe aparatura sinjalizuese, zile dhe të ngjashme e tyre” deklarohet me 10% tarifë bazë ndërsa artikulli “Pjesë për pajisje alarmi” deklarohet me tarifë bazë 0%. Gjithashtu konstatohet se për rastet e deklarimit të mallrave “Pjesë për sisteme alarmi” gjatë vitit 2016 dhe vitit 2017 nuk janë kryer veprime të mëtejshme verifikuese gjatë procedurës deklaruese si dhe kontrole pas zhdoganimit në ambientet e operatorit deklarues më qëllim përcaktimin e saktë të natyrës së mallrave “pjesë alarmi”. Gjithashtu konstatohet se kodet tarifore *85318070* dhe *85319000* ku deklarohen *Pjesët e pajisjeve të alarmit* me tarifë doganore bazë 0% nuk janë të përhirë si kode me **Profil Risku** për verifikim dhe kontrole të mëtejshme nga Drejtoria e Analizës së Riskut pranë Drejtorisë së Përgjithshme e Doganave.

Gjithashtu konstatohet se artikulli *sensorë alarmi* dhe *pajisje alarmi* janë deklaruar në kreun *85318070* me tarifë doganore 0%, në kundërshtim me shpjegimet e notave shpjeguese të Nomenklaturës së Mallrave ku artikulli “sensorë” klasifikohet në kodin tarifor *85311095* me tarifë bazë 10% *Pajisje alarmi qe paralajmërojnë vjedhjen ose zjarrin dhe aparatura te ngjashme:

85311095-Te tjera 10%*

Neni 261 i Kodit Doganor përcakton se:

“Pa rënë ndesh me dispozitat mbi kontrabandën, përbën kundërvajtje administrative doganore deklarimi i një cilësie, sasi, vlere ose origjine të ndryshme nga ajo që konstatojnë autoritetet doganore, në çastin kur deklaruesi paraqet deklaratën për vendosjen e mallrave në qarkullim të lirë.

Sa më poshtë edhe tabela e rasteve të konstatuara për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2017

IMP	DAV	SUBJEKT	NIPT	KODI	ARTIKULL	NJESI	VL STAT	EF/FINANC
4	28417	Global NET	L02205042V	85318070	Sensore Alarmi	46	211384	50732
4	29262	Global NET	L02205042V	85318070	Sensore Alarmi	24	81114	19468
4	28418	Global NET	L02205042V	85318070	Sensore Alarmi	83	276988	66478
4	24372	Global NET	L02205042V	85318070	Sensore Alarmi	12	43426	10422
4	29607	Global NET	L02205042V	85318070	Sensore Alarmi	83	440027	105606
4	11295	Global NET	L02205042V	85318070	Sensore Alarmi	131	471499	113160
4	28710	Teknogroup	J61926006P		Pajisje Alarmi	10	137648	33034
Totali								398,900

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Dega Doganore Rinas të rishikojë deklarimin doganor të kryer në praktikën doganore të mësipërme duke marrë në konsideratë amendimin e deklaratave doganore referuar shpjegimeve të mësipërme me qëllim pagesën e detyrimit doganor në shumën totale **398,350 lekë** nga të cilat shuma prej **199,175 lekë** detyrim doganor dhe kontabilizimin dhe arkëtimin e gjobës doganore në shumën sa 3-fishi i detyrimit doganor në **shumën 199.175 lekë** të deklaruar në kundërshtim me shpjegimet dhe përcaktimet e Nomenklaturës së Mallrave në RSH gjatë procedurave deklaruese doganore në kundërshtim me shpjegimet e pikës 2 të nenit 261 të Kodit Doganor.

Vlera prej 398,350 lekë, e cila përfaqëson detyrim doganor në shumën 199,175 lekë dhe shuma prej 199,175 lekë penalitet e cila do të konsiderohet të ardhura të munguara shkaktuar Buxhetit të Shtetit.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në: ligjin nr. 8449 datë. 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Personat që kanë kryer dhe përpunuar deklaratat doganore të mësipërme znj **Flora Gjini** me detyrë ish/doganier pranë në **D.D.Rinas** dhe z. **Luftar Hoxha** me detyrë doganier pranë **Degës Doganore Rinas**.



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 3, datë 02.03.2018 dhe për këtë çështje subjekti i audituar, ka bërë *komente dhe shpjegime* me shkresën nr. 1347/7 Prot KLSH datë 25.04.2018 dhe shkresën nr. 1597 prot DDRinas datë 24.04.2018

Me shkresën nr. 1269 prot DDRinas datë 04.04.2017 i është kërkuar interpretim për qëllime të përcaktimit të klasifikimit tarifor për artikujt e konstatuar “sendore alarmi” në deklarime të gabuara të klasifikimit tarifor për mallra të deklaruara dhe konstatuar sa më sipër gjatë procedurës audituese. Dega Doganore Rinas konkludon se në përfundim të veprimeve të Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës do të konkludojë për veprimet e mëtejshme në lidhje me kontabilizimin e detyrimeve doganore dhe penaliteteve për rastet e përmendur sa më sipër si dhe për përgjegjësinë e personelit doganor të përmendur sa më sipër gjatë kryerjes së detyrave funksionale në zbatim të legjislacionit doganor në fuqi.

Gjithashtu në vijim të konstatimeve të mësipërme ku për mallrat e deklaruara në kodet tarifore *85318070* dhe *85319000* ku deklarohen *Pjesët e pajisjeve të alarmit* me tarifë doganore doganore bazë 0% të cilat nuk janë të përfshirë si kode me Profil Risku nga Drejtoria e Analizës së Riskut pranë DPD si dhe nuk janë kryer kontrole të mëtejshme nga specialist i Kontrollit Pas Zhdoganimit në D.D.Rinas ose Drejtoria e Kontrollit Pas Zhdoganimit në DPD në bazë të nenit 102 të Kodit Doganor sipas ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe neni 47,48 dhe 49 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”. Neni 49 i Kodit Doganor në RSH sipas ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” përcakton se :

Autoritetet doganore, pas çlirimit të mallrave, mund të verifikojnë saktësinë dhe plotshmërinë e informacionit të dhënë në deklaratën doganore, deklaratën e magazinimit të përkohshëm, deklaratën përmbledhëse të hyrjes, deklaratën përmbledhëse të daljes, deklaratën e rieksporit ose në njoftimin rieksporit, si dhe ekzistencën, vërtetësinë, saktësinë dhe vlefshmërinë e çdo dokumenti shoqëruar’’

si dhe paragrafi nr. 2

Ato mund të verifikojnë kontabilitetin e deklaruesit dhe regjistrime të tjera që lidhen me veprimet që janë kryer mbi mallrat në fjalë ose për veprimet tregtare paraprake ose veprimet në vijim që përfshijnë këto mallra. Autoritetet doganore gjithashtu mund të verifikojnë këto mallra dhe/ose të marrin mostra, nëse ekziston akoma një mundësi e tillë”.

Sa më poshtë edhe tabela e rasteve për verifikim të mëtejshëm doganor.

VITI	DAV	SUBJEKT	NIPT	KREU	ARTIKULLI	PESHA	TARIFA	VL STAT
2017	25481	A E S S	J61814007G	8531	Pjese për sistem alarmi	22	0,2	571726
2016	2758	AD/TeKno	K78827210E	8531	Pjese për sistem alarmi	18	0,2	345086
2017	3357	Elektrosek	L12122013A	8531	Pjese për sistem alarmi	45	0,2	469754
2016	24344	Elektrosek	L12122013A	8531	Pjese për sistem alarmi	60	0,2	509322
2016	16533	Elektrosek	L12122013A	8531	Pjese për sistem alarmi	55	0,2	512200
2017	25053	Elektrosek	L12122013A	8531	Pjese për sistem alarmi	150	0,2	692833
2017	6493	Elektrosek	L12122013A	8531	Pjese për sistem alarmi	54	0,2	872616
2016	10696	Elektrosek	L12122013A	8531	Pjese për sistem alarmi	300	0,2	887145
2017	9703	Elektrosek	L12122013A	8531	Pjese për sistem alarmi	55	0,2	896924
2017	116	Elektrosek	L12122013A	8531	Pjese për sistem alarmi	46	0,2	995225
2016	12754	Elektrosek	L12122013A	8531	Pjese për sistem alarmi	47	0,2	1051696
2016	19241	Elektrosek	L12122013A	8531	Pjese për sistem alarmi	53	0,2	1054744
2017	4748	Elektrosek	L12122013A	8531	Pjese për sistem alarmi	48	0,2	1177036
2017	24745	Elektrosek	L12122013A	8531	Pjese për sistem alarmi	47	0,2	1181736
2017	7973	Elektrosek	L12122013A	8531	Pjese për sistem alarmi	56	0,2	1187723
2017	5948	Elektrosek	L12122013A	8531	Pjese për sistem alarmi	44	0,2	1241026
2016	13060	Elektrosek	L12122013A	8531	Pjese për sistem alarmi	41	0,2	1297506
2017	288	Elektrosek	L12122013A	8531	Pjese për sistem alarmi	70	0,2	1338399
2017	26410	Elektrosek	L12122013A	8531	Pjese për sistem alarmi	63	0,2	1402615
2017	14410	Elektrosek	L12122013A	8531	Pjese për sistem alarmi	68	0,2	1433745
2017	20073	Elektrosek	L12122013A	8531	Pjese për sistem alarmi	77	0,2	1527747
2017	11459	Elektrosek	L12122013A	8531	Pjese për sistem alarmi	77	0,2	1564788
2017	2634	Elektrosek	L12122013A	8531	Pjese për sistem alarmi	65	0,2	1630903
2017	19864	Elektrosek	L12122013A	8531	Pjese për sistem alarmi	98	0,2	1871932
2017	11037	Global Net	L02205042V	8531	Pjese për sistem alarmi	13	0,2	312744
2016	938	Global Net	L02205042V	8531	Pjese për sistem alarmi	19	0,2	369915
2017	25139	Global Net	L02205042V	8531	Pjese për sistem alarmi	11	0,2	776356
2017	13291	Global Net	L02205042V	8531	Pjese për sistem alarmi	22	0,2	1220181
2016	12921	Hellas Servis	J82313002T	8531	Pjese për sistem alarmi	31	0,2	715390



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

2016	5891	Rogat Secyrtity	K31526053M	8531	Pjese për sistem alarmi	70	0,2	718517
2016	4479	Rogat Secyrtity	K31526053M	8531	Pjese për sistem alarmi	56	0,2	1133568
2016	7567	Rogat Secyrtity	K31526053M	8531	Pjese për sistem alarmi	57	0,2	1190647
2016	9426	Telekom Albania	J61814094Ë	8531	Pjese për sistem alarmi	15	0,2	449166
2017	4540	Tenzor	K92226051S	8531	Pjese për sistem alarmi	65	0,2	331292
								32,932,203

Dega Doganore Rinas nëpërmjet personelit përpunues doganor dhe dokumentar dhe specialistit të Kontrollit Pas Zhdoganimit në D.D.Rinas **znj Angelina Kllapi** në bashkëpunim me **Drejtorinë e Kontrollit Pas Zhdoganimit** në DPD, në bazë të nenit 102 të Kodit Doganor sipas ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar për periudhën 01.01.2016-31.06.2017, dhe nenit 47,48 dhe 49 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*” për periudhën 01.07.2017-31.12.2017 të ndërtojë programe kontrolli specifike verifikuese për praktikatat doganore që janë përpunuar sipas tabelës së mësipërme dhe që do të deklarohen në vijim në kodet tarifore ***85318070*** dhe ***85319000*** ku deklarohen ***Pjesët e pajisjeve të alarmit*** me tarifë doganore doganore bazë 0% me qëllim **‘verifikimin e saktësisë dhe plotshmërinë e informacionit të dhënë në deklaratat doganore që do të deklarohen dhe deklaratave doganore të mësipërme duke përfshirë marrjen e mostrave dhe kontrollin fizik dhe kontabël pranë selive të operatorëve deklarues’** të këtyre deklarimeve pasi mund të jenë pajisje të plota alarmi të cilat klasifikohen **në kodin 8531 10 me tarifë doganore 10%**

◆ Në lidhje me deklaratimet e kryer nga subjekte të ndryshëm tregëtarë për **mallrat e ardhura “Dorazi”** nga linja të ndryshme të transportit ajror pranë sektorit të Terminalit në Degën Doganore Rinas konstatohet se dokumentacioni tregtar bashkangjitur praktikave doganore nuk përmbush kushtet dhe përcaktimet ligjore të Sesionit 1 “*Mbi Procedurat e Shqyrtimit të Vlerës Doganore*” pika 2 dhe nën pikat 2.13 deri në 2.14, 2.19 dhe 2.23 të Udhëzimit nr. 25 datë 30.11.2007 “*Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore*”.

Nga auditimi i rasteve specifike të praktikave doganore të kryera pranë këtij sektorit për vitin 2016 dhe 2017 konstatohet se dokumentacioni shoqërues i mallit për praktika subjektsh të vecantë kryesisht për mallrat të **“kapitullit 61, 62 dhe 64”** për mallra kryesisht me origjinë nga Turqia dhe Kina nuk përmbush kriteret dhe përcaktimet ligjore të

-nenit 122 pika a, b, c të nenit 142 të VKM-së nr. 205. datë 13.04.199 “*Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor*”,

-pikës 1 dhe 2 të Nenit 87 të Kodit Doganor “*Deklarata me shkrim*” ku përcaktohet se “*deklarata duhet të shoqërohet me të gjitha dokumentet e kërkuara për zbatimin e dispozitave që rregullojnë regjimin doganor, për të cilin mallrat janë deklaruar*”

-neni 149 , 150 dhe 155 “*Deklarata Doganore*” të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”

-neni 167, 272,307, 323 i VKM-së nr. 651 datë 10.11.2017 “*Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor*”

-nenit 143 të VKM-së nr. 205. datë 13.04.1999 “*Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor*” përcakton se “*për ta pasur të plotë informacionin e kërkuar në një deklaratë doganore, fatura e kërkuar sipas nenit 142(1)(a), nga Autoritetet Doganore duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme*”: a). *emrin dhe adresën e shitësit;* b). *emrin dhe adresën e blerësit;* c). *datën e lëshimit;* d). *numrin e kolive, natyrën e tyre dhe shenjat e numrat që ato mbajnë;* e). *peshën bruto;* f) *llojin e mallrave dhe sasinë e çmimit për çdo lloj malli;* g). *zbritje të mundshme dhe llojin e zbritjes, si dhe kushtet e lëvrimit.* /2). **në mungesë listë paketimi**

Dega Doganore Rinas dhe konkretisht sektori i terminalit pranë Degës Doganore Rinas për deklaratimet doganore të **‘Bagazheve të Dorës’** ka pranuar si dokumentacion shoqërues të mallit dokumentin “**Deklaratë**” të plotësuar më shkrim dore pa paraqitur të dhënat e kërkuara nga legjislacioni doganor në fuqi sipas përcaktimeve nga pika a) deri g) të nenit 143 të VKM-së nr. 205. datë 13.04.1999 “*Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor*”.



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

Në vijimësi Dega Doganore Rinas mori në konsideratë të lartë rekomandimet e lëna nga **Kontrolli i Lartë i Shtetit në ProjektRaportin e Auditimit** dhe vijim në zbatim të ligjit nr.102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” dhe Vkm-së nr. 651 datë 10.11.2017 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” për mallra kryesisht me origjinë nga Turqia dhe Kina të kërkojë gjatë deklarimeve doganore për të, faturën e kërkuar sipas nenit 142(1)(a), nga Autoritetet Doganore e cila duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme: a). emrin dhe adresën e shitësit;/b). emrin dhe adresën e blerësit;/c). datën e lëshimit;/d). numrin e kolive, natyrën e tyre dhe shenjat e numrat që ato mbajnë;/e). peshën bruto;/f) llojin e mallrave dhe sasinë e çmimin për çdo lloj malli;/g). zbritje të mundshme dhe llojin e zbritjes, si dhe kushtet e lëvrimit./2). në mungesë listë paketimi

♦. Në lidhje me vlerësimin doganor të **mallrave të natyrës plastike të deklaruar në kapitullin *39* të Nomenklaturës së Mallrave në RSH.**

1. Konstatohet se rezultojnë deklarime të këtyre mallrave më tarifë bazë 0% në kodin tarifor ***39269097*** për mallra me origjinë jashtë kushtit preferencial MSABE. Këto janë mallra sipas funksioneve dhe përshkrimit të tyre. duhet të ishin deklaruar në krerët respektivë të kapitullit 39 me tarifë bazë 6% dhe specifikisht në kreun ***3920*** dhe konkretisht në kodin ***39209990*** për mallin “etiketa shirit plastik” sipas kreut ***Pllaka, fleta, filma, krisafe dhe shirita te tjerë, prej plastike, jo celulare dhe jo të përforcuara, jo të laminuara të pambështetura apo të pakombinuara në mënyra të ngjashme me materiale të tjera***

Rregulli 3 i Nomenklaturës së Mallrave të publikuar për vitin 2017 përcakton se “**Kur nga zbatimi i rregullit 2 (b) ose për ndonjë arsye tjetër, mallrat janë, ne pamje të parë, të klasifikueshme në dy apo më shumë krerë, klasifikimi do të ndikohet nga kriteret e mëposhtme: (a) kreu i cili jep përshkrimin me specifik do të preferohet nga krerët që japin një përshkrim më të përgjithshëm. Megjithatë, kur dy apo më shumë krerë secili i referohet vetëm pjesës së materialeve apo substancave që bëjnë pjesë në mallrat e përbërë apo te përziera, apo vetëm pjesës së artikujve në një grup te vendosur për shitjen me pakicë, këta krerë do të vlerësohen njëllë të specifikuar në lidhje me këto mallra, edhe nëse njëri prej tyre jep një përshkrim më të saktë apo më të plotë të mallrave**”. Gjithashtu sipas rregullit nr. 3 të NM përcaktohet se : **Për ndonjë arsye tjetër, mallrat janë, në pamje te pare, të klasifikueshme në dy apo me shumë krerë, klasifikimi do të ndikohet nga kriteret e mëposhtme:**

3/c-Kur mallrat nuk mund të klasifikohen sipas rregullave 3(a) apo 3(b), ato do të klasifikohen në kreun i cili ndodhet i fundit në rendin numerik, midis atyre mallrave që meritojnë të njëjtin vlerësim.

Neni 256 i ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar përcakton se :

Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet doganore, të përcaktuara në nenin 251, duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm:

a) kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën sa **1-fish të detyrimit të munguar**

Sa më poshtë tabela e rasteve ku janë konstatuar klasifikime të gabuara tariforë

Periudha	Viti	DAV	SUBJEKT	NIPT	DEKLAR	Duhej	Pershkrimi	Duhet	Detyrimi	effina
Gjashte II	2017	15920	M.Albania	K71911501B	39269097	39201089	Etiketa shirit 16,400 m	6	13760	27521
Gjashte II	2017	19973	M.Albania	K71911501B	39269097	39201089	Etiketa shirit 24,600 m	6	18900	37800
Totali										66,643

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Dega Doganore Rinas të rishikojë deklarimin doganor të kryer në praktikën doganore të mësipërme duke marrë në konsideratë amendimin e deklaratave doganore referuar shpjegimeve të mësipërme bazuar në nenin 47,48,49, 250 pika 1/a, 251 pika 2a/b dhe nenit



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

256 pika a me qëllim pagesën e detyrimit doganor në shumën totale **66,643 lekë** nga të cilat shuma prej **33,321 lekë** si detyrim doganor dhe shuma sa 1-fishi i detyrimit doganor në shumën **33,321 lekë** për klasifikimin doganor të kryer në kushtet e kundërvajtjes doganore të kryer me përgjegjësi objektive të padeklaruar në kundërshtim me shpjegimet e nenit 251 dhe të pikës 2, të nenit 23 të nenit të Kodit Doganor sipas ligjit 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Vlera prej 66,643 lekë, e cila përfaqëson detyrim doganor dhe penalitet do të konsiderohet e ardhur e munguar shkaktuar Buxhetit të Shtetit.

2. Konstatohet se rezultojnë deklarime të mallrave plastikë më tarifë bazë 0% në kodin tarifor ***39269097*** për mallra me origjinë jashtë kushtit preferencial MSABE. Këto janë mallra që sipas funksioneve dhe përshkrimit të tyre duhet të ishin deklaruar në krerët respektivë të kapitullit 39 me tarifë bazë 6% dhe specifikisht në kreun ***3923*** dhe konkretisht në kodin ***39231090*** për mallin “**artikull mbajtës plastik**” sipas kreut *** Artikujt për mbajtjen apo paketimin e mallrave, prej plastike;dhe mbyllës të tjerë, prej plastike***. Rregulli 3 i Nomenklaturës së Mallrave të publikuar për vitin 2017 përcakton se “**Kur nga zbatimi i rregullit 2 (b) ose për ndonjë arsye tjetër, mallrat janë, në pamje të parë, të klasifikueshme në dy apo me shumë krerë, klasifikimi do të ndikohet nga kriteret e mëposhtme: (a) kreu i cili jep përshkrimin me specifik do të preferohet nga krerët që japin një përshkrim më të përgjithshëm. Megjithatë, kur dy apo me shumë krerë secili i referohet vetëm pjesës së materialeve apo substancave që bëjnë pjesë në mallrat e përbëre apo të përziera, apo vetëm pjesës së artikujve në një grup të vendosur për shitjen me pakicë, këta krerë do të vlerësohen njëjloj të specifikuar në lidhje me këto mallra, edhe nëse njëri prej tyre jep një përshkrim më të saktë apo më të plotë të mallrave**”.

Neni 256 i ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar përcakton se :

Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet doganore, të përcaktuara në nenin 251, duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm:

*a) kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën sa **1-fish të detyrimit të munguar***

Sa më poshtë tabela e rasteve ku janë konstatuar klasifikime të gabuara tariforë.

Viti	Viti	DAV	SUBJEKT	NIPT	Duhej	Pershkrimi	Duhet	Detyrimi	Eff/financ
Gjashte II	2017	18297	Biomedica	L52020002V	39231090	Artikull mbajtës plastik	6	4888	9776
Gjashte II	2017	26068	Biomedica	L52020002V	39231090	Artikull mbajtës plastik	6	7947	15894
Gjashte II	2017	23111	Biomedica	L52020002V	39231090	Artikull mbajtës plastik	6	8023	16046
Gjashte II	2017	20390	Biomedica	L52020002V	39231090	Artikull mbajtës plastik	6	8411	16821
Gjashte II	2017	14907	Biomedica	L52020002V	39231090	Artikull mbajtës plastik	6	8689	17378
Gjashte II	2017	28398	Biomedica	L52020002V	39231090	Artikull mbajtës plastik	6	18947	37893
Gjashte II	2017	23956	Start Co	L11614001S	39231090	Artikull plastik mbajtës	6	4769	9539
Gjashte II	2017	19006	Sëismed	K81323024G	39231090	Artikuj Mbaj/Reagente.	6	6931	13861
Gjashte II	2017	28163	Sëismed	K81323024G	39231090	Artikuj Mbaj/Reagente.	6	7880	15761
Gjashte II	2017	15535	M-DAS	L52423023B	39231090	Mbajtës plastik	6	7380	14760
Gjashte II	2017	15534	M-DAS	L52423023B	39231090	Mbajtës plastik	6	10374	20748
Gjashte II	2017	26368	Timagu	J91405502L	39231090	Mbajtëse plastike	6	1566	3132
<i>Totali</i>								95,805	191,609

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Dega Doganore Rinas të rishikojë deklarin doganor të kryer në praktikën doganore të mësipërme duke marrë në konsideratë amendimin e deklaratave doganore referuar shpjegimeve të mësipërme bazuar në nenin 47,48,49, 250 pika 1/a, 251 pika 2a/b dhe nenit 256 pika a me qëllim pagesën e detyrimit doganor në shumën totale **362,150 lekë** nga të cilat shuma prej **181,075 lekë** si detyrim doganor dhe shuma sa 1-fishi i detyrimit doganor në shumën **181,075 lekë** për klasifikimin doganor të kryer në kushtet e “**kundërvajtjes doganore të kryer me përgjegjësi objektive**” të deklaruar në kundërshtim me shpjegimet e



KONTROLLI I LARTE I SHETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

nenit 251 dhe të pikës 2, të nenit 23të nenit të Kodit Doganor sipas ligjit 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar

Vlera prej 362,150 lekë, e cila përfaqëson detyrim doganor dhe penalitet do të konsiderohet e ardhur e munguara shkaktuar Buxhetit të Shtetit.

3. Konstatohet se rezultojnë deklarime të mallrave plastikë me tarifë bazë 0% në kodin tarifor *39269097* për mallra me origjinë jashtë kushtit preferencial MSABE. Këto janë mallra që sipas funksioneve dhe përshkrimit të tyre duhet të ishin deklaruar në krerët respektivë të kapitullit 39 me tarifë bazë 6% dhe specifikisht në kreun *3923* dhe konkretisht në kodin *39231090* për mallin “artikull mbajtës plastik” sipas kreut * Artikujt për mbajtjen apo paketimin e mallrave, prej plastike;dhe mbyllës te tjerë, prej plastike*.Rregulli 3 i Nomenklaturës së Mallrave të publikuar për vitin 2017 përcakton se “Kur nga zbatimi i rregullit 2 (b) ose për ndonjë arsye tjetër, mallrat janë, ne pamje te pare, te klasifikueshme ne dy apo me shume krerë, klasifikimi do te ndikohet nga kriteret e mëposhtme: (a) kreu i cili jep përshkrimin me specifik do te preferohet nga krerët qe japin një përshkrim me te përgjithshëm. Megjithatë, kur dy apo me shume krerë secili i referohet vetëm pjesës se materialeve apo substancave qe bëjnë pjesë në mallrat e përbëre apo te përziera, apo vetëm pjesës se artikujve ne një grup te vendosur për shitjen me pakice,këta krerë do te vlerësohen njëllotj te specifikuar ne lidhje me këto mallra, edhe nëse njeri prej tyre jep një përshkrim me te sakte apo me te plote te mallrave”.

Neni 261 i Kodit Doganor përcakton se:

“Pa rënë ndesh me dispozitat mbi kontrabandën, përbën kundërvajtje administrative doganore deklarimi i një cilësie, sasi, vlere ose origjine të ndryshme nga ajo që konstatojnë autoritetet doganore, në çastin kur deklaruesi paraqet deklaratën për vendosjen e mallrave në qarkullim të lirë. Në rastet kur pas rishikimit të deklaratës rezulton që detyrimet doganore që duhen paguar janë më të larta se ato të llogaritura në bazë të deklaratës dhe diferenca e këtyre është më e madhe sesa 5 për qind, në vend të gjobës së mësipërme, zbatohet një gjobë e barabartë me trefishin e diferencës së detyrimeve doganore të papaguara

Sa më poshtë tabela e rasteve të evidentuara për gjashtëmujorin e parë të vitit 2017

Viti	Viti	DAV	SUBJEKT	NIPT	Duhej	Pershkrimi	Duhet	Detyrimi	Eff/financ
Gjashte I	2017	10017	A.Gjikondi	K31413067G	39231090	Artikuj mbajtes	6	3862	15448
Gjashte I	2017	813	Orbico	L01626012A	39231090	Artikull mbajtes plastik	6	10300	41199
Gjashte I	2017	12785	Biometric	J61827062E	39231090	Artikull mbajtes plastik	6	2525	10100
Gjashte I	2017	8868	Biometric	L52020002V	39231090	Artikull mbajtes plastik	6	2542	10169
Gjashte I	2017	5769	Biometric	J61827062E	39231090	Artikull mbajtes plastik	6	4717	18866
Gjashte I	2017	5020	Biomedica	L52020002V	39231090	Artikull mbajtes plastik	6	6274	25096
Gjashte I	2017	2727	Biomedica	L52020002V	39231090	Artikull mbajtes plastik	6	11375	45502
Gjashte I	2017	6943	Biomedica	L52020002V	39231090	Artikull mbajtes plastik	6	12859	51437
Gjashte I	2017	13007	Biomedica	L52020002V	39231090	Artikull mbajtes plastik	6	18973	75892
Gjashte I	2017	12410	Sëismed	K81323024G	39231090	Artikuj Mbaj/Reagente	6	7727	30908
Gjashte I	2017	1484	Sëismed	K81323024G	39231090	Artikuj Mbaj/Reagente.	6	15110	60439
Gjashte I	2017	5289	Sëismed	K81323024G	39231090	Artikuj Mbaj/Reagente.	6	44732	178928
Gjashte I	2017	8379	Sëismed	K81323024G	39231090	ArtikujMbaj/Reagentesh	6	85362	341448
Gjashte I	2017	7320	Interoptik	L61314512N	39231090	Mbajtes plastik	6	14887	59547
Gjashte I	2017	8222	Odeta Bregu	K41518016P	39231090	Mbajtes plastik	6	16136	64543
Totali								257,381	1,029,522

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Dega Doganore Rinas të rishikojë deklarimin doganor të kryer në praktikat doganore të mësipërme me qëllim rishikimin dhe amendimin e deklaratave doganore referuar shpjegimeve të mësipërme ligjore bazuar në nenin 102, 256 dhe 261 të ligjit nr. 8449 datë.27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar me qëllim pagesën e detyrimit doganor në shumën totale 1,187,702 lekë nga të cilat shuma prej 296,925 lekë si detyrim doganor dhe shuma prej 890,777 lekë si gjobë doganore për shkeljen doganore të konsumuar gjatë procedurave të deklaruese doganore në kundërshtim me shpjegimet e pikës 2 të nenit 261 të Kodit Doganor.

Vlera prej 1,187,702 lekë, e cila përfaqëson detyrim doganor dhe penalitet do të konsiderohet e ardhur doganore e munguar shkaktuar Buxhetit të Shtetit.



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

3. Konstatohet se rezultojnë deklarime të mallrave të natyrës “*Qese Plastike*” më tarifë bazë 0% në kodin tarifor *39269097* për mallra me origjinë jashtë kushtit preferencial MSABE. Këto janë mallra që sipas funksioneve dhe përshkrimit të tyre duhet të ishin deklaruar në kërret respektivë të kapitullit 39 me tarifë bazë 6% dhe specifikisht në kreun *3923* dhe konkretisht në kodin *39232990* për mallin “*Qese plastike*” sipas kreut * *Artikujt për mbajtjen apo paketimin e mallrave, prej plastike;dhe mbyllës te tjerë, prej plastike* *. Rregulli 3 i Nomenklaturës së Mallrave të publikuar për vitin 2017 përcakton se “*Kur nga zbatimi i rregullit 2 (b) ose për ndonjë arsye tjetër, mallrat janë, ne pamje te pare, te klasifikueshme ne dy apo me shume krerë, klasifikimi do te ndikohet nga kriteret e mëposhtme: (a) kreu i cili jep përshkrimin me specifik do te preferohet nga krerët qe japin një përshkrim me te përgjithshëm. Megjithatë, kur dy apo me shume krerë secili i referohet vetëm pjesës se materialeve apo substancave qe bëjnë pjesë në mallrat e përbëre apo te përziera, apo vetëm pjesës se artikujve ne një grup te vendosur për shitjen me pakice, këta krerë do te vlerësohen njëllë te specifikuar ne lidhje me këto mallra, edhe nëse njeri prej tyre jep një përshkrim me te sakte apo me te plote te mallrave*”.

Neni 261 i Kodit Doganor përcakton se:

“Pa rënë ndesh me dispozitat mbi kontrabandën, përbën kundërvajtje administrative doganore deklarimi i një cilësie, sasi, vlere ose origjine të ndryshme nga ajo që konstaton autoritetet doganore, në çastin kur deklaruesi paraqet deklaratën për vendosjen e mallrave në qarkullim të lirë. Në rastet kur pas rishikimit të deklaratës rezulton që detyrimet doganore që duhen paguar janë më të larta se ato të llogaritura në bazë të deklaratës dhe diferenca e këtyre është më e madhe sesa 5 për qind, në vend të gjobës së mësipërme, zbatohet një gjobë e barabartë me trefishin e diferencës së detyrimeve doganore të papaguara

Tabela e rasteve të keqklasifikimeve tariforë të artikullit gese plastike

Viti	Viti	DAV	SUBJEKT	NIPT	Duhej	Përshkrimi	Duhet	Detyrimi	effinanc
Gjashte I	2017	692	DHL	J61820040I	39232990	Qese paketimi	6	8448	16895
Gjashte I	2017	10014	DHL	J61820040I	39232990	Qese paketimi	6	10647	21294
Gjashte I	2017	17390	DHL	J61820040I	39232990	Qese paketimi	6	4768	9536
Totali									47724

Tabela e rasteve të keqklasifikimeve tariforë të artikullit kapak plastikë

Viti	Viti	DAV	SUBJEKT	NIPT	Duhej	Përshkrimi	Duhet	Detyrimi	effinanc
Gjashte I	2017	2333	A.Dervishaj	K81309007P	39235090	Kapak plastik	6	2938	5876
Gjashte I	2017	12290	Telekom	J61814094E	39235090	Kapak plastik	6	4975	9950
Totali									15826

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Dega Doganore Rinas të rishikojë deklarinin doganor të kryer në praktikat doganore të mësipërme me qëllim rishikimin dhe amendimin e deklaratave doganore referuar shpjegimeve të mësipërme ligjore bazuar në nenin 102, 256 dhe 261 të ligjit nr. 8449 datë.27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar me qëllim pagesën e detyrimit doganor në shumën totale 63,550 lekë nga të cilat shuma prej 31,775 lekë si detyrim doganor dhe shuma prej 31,755 lekë si gjobë doganore për shkeljen doganor të konsumuar gjatë procedurave të deklaruesve doganore në kundërshtim me shpjegimet e pikës 2 të nenit 261 të Kodit Doganor.

Vlera prej 63,550 lekë, e cila përfaqëson detyrim doganor dhe penalitet do të konsiderohet e ardhura doganore e munguar në Buxhetit të Shtetit.

4. Konstatohet se rezultojnë deklarime të mallrave plastikë me tarifë bazë 0% në kodin tarifor *39269097* për mallra me origjinë jashtë kushtit preferencial MSABE. Këto janë mallra sipas funksioneve dhe përshkrimit të tyre duhet të ishin deklaruar në kërret respektivë të kapitullit *39* me **tarifë bazë 6%** dhe specifikisht në kreun *3923* dhe konkretisht në kodin *39231090* për mallin “*artikull mbajtës plastik*” sipas kreut * *Artikujt për mbajtjen apo paketimin e mallrave, prej plastike;dhe mbyllës te tjerë, prej plastike* *. Rregulli 3 i



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

Nomenklaturës së Mallrave të publikuar për vitin 2017 përcakton se **“Kur nga zbatimi i rregullit 2 (b) ose për ndonjë arsye tjetër, mallrat janë, ne pamje te pare, te klasifikueshme ne dy apo me shume krerë, klasifikimi do te ndikohet nga kriteret e mëposhtme: (a) kreu i cili jep përshkrimin me specifik do te preferohet nga krerët qe japin një përshkrim me te përgjithshëm. Megjithatë, kur dy apo me shume krerë secili i referohet vetëm pjesës se materialeve apo substancave qe bëjnë pjesë në mallrat e përbëre apo te përziera, apo vetëm pjesës se artikujve ne një grup te vendosur për shitjen me pakice, këta krerë do te vlerësohen njëllor te specifikuar ne lidhje me këto mallra, edhe nëse njeri prej tyre jep një përshkrim me te sakte apo me te plote te mallrave”.**

Neni 256 i ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, dhe 261 i ligjit nr.

VITI	VITI	DAV	SUBJEKT	NIPT	DUHEJ	PERSHKRIMI	DUHET	DETYRIMI	EF/FINANC
Gjashte I	2017	7648	Teknogroup	J61926006P	39259080	Artikuj ndertimi plastik	6	2306	4612
Gjashte I	2017	1703	Teknogroup	J61926006P	39259080	Artikuj ndertimi plastik	6	4121	8243
Gjashte I	2017	2512	Teknogroup	J61926006P	39259080	Artikuj ndertimi plastik	6	7004	14009
Gjashte I	2017	13998	Teknogroup	J61926006P	39259080	Artikuj ndertimi plastik	6	9541	19082
Gjashte I	2017	10849	Arseni	K67015001V	39259080	Artikull ndertimi plastik	6	8266	16531
Gjashte I	2017	3730	Mutivac	K71911501B	39259080	Artikull plastik per ndertim	6	2134	4267
Gjashte I	2017	2074	M.Trepçi	L37304001T	39259080	Artikull plastik per ndertim	6	2172	4343
Gjashte I	2017	5716	I T E. GRUP	K11323001H	39259080	Material plastik elektrike	6	6374	12749
Gjashte I	2017	12506	Ë/Atlas/Intern	J72510499O	39259080	Pajisje plastike ndertimi	6	3703	7406
Gjashte I	2017	1034	Vibitis	L02103503S	39259080	Pajisje plastike ndertimi	6	4990	9981
Gjashte I	2017	11648	Ë/Atlas/Intern	J72510499O	39259080	Pajisje plastike ndertimi	6	16162	32324
Gjashte II	2017	26380	Teknogroup	J61926006P	39259080	Artikuj ndertimi plastik	6	2322	4644
Gjashte II	2017	26275	Teknogroup	J61926006P	39259080	Artikuj ndertimi plastik	6	2730	5460
Gjashte II	2017	28075	Teknogroup	J61926006P	39259080	Artikuj ndertimi plastik	6	3165	6330
Gjashte II	2017	29183	Teknogroup	J61926006P	39259080	Artikuj ndertimi plastik	6	4721	9442
Gjashte II	2017	28733	Teknogroup	J61926006P	39259080	Artikuj ndertimi plastik	6	4917	9834
Gjashte II	2017	17591	Vibitis	L02103503S	39259080	Pajisje plastike ndertimi	6	5935	11871
Totali									181,126

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Dega Doganore Rinas të rishikojë deklarinimin doganor të kryer në praktikat doganore të mësipërme me qëllim rishikimin dhe amendimin e deklaratave doganore referuar shpjegimeve të mësipërme ligjore bazuar në nenin 102, 256 dhe 261 të ligjit nr. 8449 datë.27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe nenin 47,48,49, 250 pika 1/a, 251 pika 2a/b ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, me qëllim pagesën e detyrimit doganor në **shumën totale 181,126 lekë** nga të cilat shuma prej 90,563 lekë si detyrim doganor dhe shuma prej 45,281 lekë si gjobë doganore për shkeljen doganore të konsumuar gjatë procedurave të deklaruase doganore në kundërshtim me shpjegimet e nenit 261 të Kodit Doganor të ligjit nr. 8449 datë. 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, dhe nenit 256 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Vlera prej 181,126 lekë, e cila përfaqëson detyrim doganor dhe penalitetet do të konsiderohet e ardhur doganore e munguar në Buxhetin e Shtetit.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Ligjin nr. 8449 datë. 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar

Ligjit 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar

5. Në lidhje me subjektet “By.Best DFree” me nipt K01621002N dhe “Renard Goskova” me nipt K621210390 të cilët kane deklaruar mallra të natyrës ekspozitorë plastikë për mbajtje bizhuterish konstatohet se dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit auditues gjatë fazës pas ProjektRaportit të Auditimit dhe gjatë fazës ballafaqese në KLSH nga administrimi i observacioneve të paraqitura nga këta dy subjekte u arrit në konkluzionin që deklarimi doganor është kryer në kreun *39269000* dhe *3926909790* nisur edhe nga dokumentacioni i deklaratave doganore të eksportit dhe Notat e deklaruara në faturat e mallit kryesisht për markën “Sëarovski” dhe “Precioza”. Në vijim konkludohet që Dega Doganore



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

Rinas për subjektet të cilët kanë kryer transaksione nga vende të Komunitetit Evropian, në zbatim të pikës 3, 4 dhe 5 të shpjegimeve të Udhëzimit nr. 25 datë 16.05.2006 të MF, “Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore” të gjykojë dhe të rikërkojë ndjekjen e arkëtimit të detyrimeve doganore të dhe kryerjen e procedurave doganore verifikuese duke kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave **verifikimin e plotë dhe të garantuar** të klasifikimit tarifor të këtyre mallrave dhe vlerave të transaktuara sipas deklarimeve nga prodhuesi, eksportuesi ose lëvruesi i mallit për praktika doganore të konstatuara në Projektraportin e Auditimit me detyrime doganore të konstatuara në shumën 124,817 lekë dhe në total me efekt financiar **në shumën 328,714 lekë**. Gjithashtu Dega Doganore Rinas nëpërmjet sektorit të kontrollit pas zhdoganimit bazuar në nenin 47, 48 dhe 49 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, të kryejë veprime verifikuese doganore pranë selive të ushtrimit të aktivitetit të kompanive dhe pranë regjistrave të kontabilitetit financiar të kompanive të trajtuara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi bazuar në përcaktimet e pikës 1 neni 49, pika 1 dhe 2 ku përcaktohet se “Autoritetet doganore, pas çlirimit të mallrave, mund të verifikojnë saktësinë dhe plotshmërinë e informacionit të dhënë në deklaratën doganore.....si dhe ekzistencën, vërtetësinë, saktësinë dhe vlefshmërinë e çdo dokumenti, të verifikojnë kontabilitetin e deklaruesit dhe regjistrime të tjera që lidhen me veprimet që janë kryer mbi mallrat si dhe të verifikojnë këto mallra dhe/ose të marrin mostra, nëse ekziston akoma një mundësi e tillë” për saktësim të informacionit të dhënë në deklaratat doganore që lidhen me problemet e trajtuara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi trajtuar me raste sa më poshtë;

Sa më poshtë edhe tabela e rasteve të praktikave doganore që duhet të verifikojë Dega Doganore Rinas për subjektet “By.Best DFree” me nipt K01621002N dhe “Renard Goskova” me nipt K621210390

Sa më poshtë tabela e rasteve për riverifikim nga Dega Doganore Rinas

VITI	VITI	DAV	SUBJEKT	NIPT	Deklaruar	Per Verifikim/Kodi	PERSHKRIMI
Gjashte II	2017	15714	By.Best Dfree	K01621002N	39269000/9790	39231090	Ekspozitore plastike/te tjera
Gjashte II	2017	27359	By.Best Dfree	K01621002N	39269000/9790	39231090	Ekspozitore plastike/te tjera
Gjashte II	2017	15533	By.Best Dfree	K01621002N	39269000/9790	39231090	Ekspozitore plastike/te tjera
Gjashte II	2017	20635	By.Best Dfree	K01621002N	39269000/9790	39231090	Ekspozitore plastike/te tjera
Gjashte II	2017	17618	By.Best Dfree	K01621002N	39269000/9790	39231090	Ekspozitore plastike/te tjera
Gjashte II	2017	24152	By.Best Dfree	K01621002N	39269000/9790	39231090	Ekspozitore plastike/te tjera
Gjashte II	2017	15714	By.Best Dfree	K01621002N	39269000/9790	39231090	Ekspozitore plastike/te tjera
Gjashte II	2017	29740	By.Best Dfree	K01621002N	39269000/9790	39231090	Ekspozitore plastike/te tjera
Gjashte II	2017	25197	By.Best Dfree	K01621002N	39269000/9790	39231090	Ekspozitore plastike/te tjera
Gjashte I	2017	3076	Renard	K621210390	392690790	39231090	Ekspozitore plastike/te tjera
Gjashte I	2017	5966	By.Best Dfree	K01621002N	39269000/9790	39231090	Ekspozitore plastike/te tjera
Gjashte I	2017	3058	By.Best Dfree	K01621002N	39269000/9791	39231090	Ekspozitore plastike/te tjera
Gjashte I	2017	12914	By.Best Dfree	K01621002N	39269000/9792	39231090	Ekspozitore plastike/te tjera
Gjashte I	2017	9710	By.Best Dfree	K01621002N	39269000/9793	39231090	Ekspozitore plastike/te tjera
Gjashte I	2017	5966	By.Best Dfree	K01621002N	39269000/9794	39231090	Ekspozitore plastike/te tjera
Gjashte I	2017	970	By.Best Dfree	K01621002N	39269000/9795	39231090	Ekspozitore plastike/te tjera
Gjashte I	2017	7157	By.Best Dfree	K01621002N	39269000/9796	39231090	Ekspozitore plastike/te tjera

Dega Doganore Rinas të kryejë veprimet procedurale verifikuese të trajtuara sa më sipër duke marrë në konsideratë tratimin e hollësishëm që është bërë në Projektraportin e Auditimit dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të informojë Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi rezultatet e verifikimeve duke dokumentuar veprimet dhe kontrollet bazuar në legjislacionin doganor në fuqi për të gjitha rastet e praktikave doganore të sipërcituara për të cilat është kërkuar kontabilizmi i detyrimeve doganore në fazën Projekt Raportit të auditimit në **shumën totale 328,721 lekë nga dy subjektet “By.Best DFree” me nipt K01621002N dhe “Renard Goskova” me nipt K621210390**

6. Në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave të natyrës plastike të deklaruara në kapitullin ***39* të Nomenklaturës së Mallrave në RSH** konstatohet se rezultojnë deklarime të këtyre mallrave më tarifë bazë 0% në kodin tarifor ***39269097*** për mallra me origjinë jashtë kushtit preferencial MSABE të deklaruar si “**artikuj plastikë ornamental**“. Këto mallra sipas funksioneve dhe përshkrimit të tyre, duhet të ishin deklaruar në krerët respektivë të kapitullit



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

39 me tarifë bazë 6% dhe specifika në kreun *3926* dhe konkretisht në kodin *39264000* për mallin “*artikuj plastikë ornamentale*” sipas kreut **Artikuj të tjerë ornamentale plastikë**

VITI	VITI	DAV	SUBJEKT	NIPT	DUHEJ	PERSHKRIMI	DUHET	DETYRIMI	EF/FINANC
Gjashtë I	2017	10865	Tanja Herri	L6392920II	39264000	Artikuj Ornamentale	6	2109	4218
Gjashtë I	2017	13236	OKG	L2181103II	39264000	Rripa ore ornamentale 52.000	6	12002	24004
Gjashtë II	2017	19131	OKG	L2181103II	39264000	Rripa ore ornamentale 34.000	6	6845	13690
Totali									41,912

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Dega Doganore Rinas të rishikojë deklarinimin doganor të kryer në praktikat doganore të mësipërme me qëllim rishikimin dhe amendimin e deklaratave doganore referuar shpjegimeve të mësipërme ligjore bazuar në nenin 102, 256 dhe 261 të ligjit nr. 8449 datë. 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe nenin 47,48,49, 250 pika 1/a, 251 pika 2a/b ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, me qëllim pagesën e detyrimit doganor në **shumën totale 41,912 lekë** nga të cilat shuma prej 20,550 lekë si detyrim doganor dhe shuma prej prej 20,550 lekë si gjobë doganore për shkeljen doganore të konsumuar gjatë procedurave të deklaruese doganore në kundërshtim me shpjegimet e nenit 261 të Kodit Doganor të ligjit nr. 8449 datë. 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, dhe nenit 256 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Vlera prej 41,912 lekë, e cila përfaqëson detyrim doganor dhe penalitet do të konsiderohet e ardhur doganore e munguar në Buxhetit të Shtetit.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Ligjin nr. 8449 datë. 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar Ligjit 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar Personat që kanë kryer dhe përpunuar deklaratat doganore të mësipërme. znj Flora Gjini me detyrë ish/doganier pranë në D.D Rinas me status jo në mardhënie pune pranë DPD-së, Përparim Tollia me detyrë ish/doganier pranë D.D.Rinas aktualisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Luftar Hoxha me detyrë doganier pranë Degës Doganore Rinas, Muharrem Reka me detyrë doganier pranë Degës Doganore Rinas, Ilir Rustemi me detyrë doganier pranë Degës Doganore Rinas aktualisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 3, datë 02.03.2018 dhe për këtë çështje subjekti i audituar, ka bërë komente dhe shpjegime me shkresën nr. 1347/7 Prot KLSH datë 25.04.2018 dhe shkresën nr. 1597 prot DDRinas datë 24.04.2018

Me shkresën nr. 1453 prot DDRinas datë 17.04.2017 i është kërkuar interpretim për qëllime të përcaktimit të klasifikimit tarifor për artikujt e konstatuar në deklaratime të gabuara të klasifikimit tarifor për mallra të deklaruar dhe konstatuar sa më sipër gjatë procedurës audituese. Dega Doganore Rinas konkludon se në përfundim të veprimeve të Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës do të konkludojë për veprimet e mëtejshme në lidhje me kontabilizimin e detyrimeve doganore dhe penaliteteve për rastet e përmendur sa më sipër si dhe për përgjegjësinë e personelit doganor të përmendur sa më sipër gjatë kryerjes së detyrave funksionale në zbatim të legjislacionit doganor në fuqi.

♦. Në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave të natyrës ora dore të deklaruar në kapitullin *9102* të Nomenclaturës së Mallrave në RSH të deklaruar nga subjekti “**IDI MITA**” me nipt **K91801004N** konstatohet se janë importuar ora dore të markave “Armani”, “Michael Kors” dhe “Hugo Boss” nga kompania “**MAYA 2000 LTD FROGNAL VENUE HARROË GB**” me seli në Angli. Nga auditimi i praktikave doganore bashkangjitur u konstatua se dokumentacioni tregëtar bashkangjitur praktikave doganore nuk përmbush kushtet dhe përcaktimet ligjore të Udhëzimit nr. 25 të Ministrit të Financave. Konstatohet se orët e dorës të deklaruar janë të markave të njohura si “**Armani**”, “**Michael Kors**” dhe “**Hugo Boss**” dhe ngainvestigimi i informacionit të marrë nga sitet ëeb konstatohet se cmimet e produkteve të



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

deklaruara sipas kodeve respektivë tregëtarë të pasyruara në këto fatura malli është më i lartë se vlerat e deklaruara për njësi/copë/orë dore varion nga niveli **95 euro-135 euro/Copa** me kriter skontimi në sitet ëb “*E-Bay*”, “*Amazon*” etj. Nga investigimi në sitet ëb u konstatua se kompania lëvruese e mallrave nuk është **kompani prodhuese e autorizuar** për markat e mësipërme respektive dhe se bashkangjitur dokumentacionit tregëtar nuk administrohet “*Kontratë Malli me firmën shitëse*” sipas kriterit të indikatorit nr. 2.8 dhe 2.22 të pikës 2 të Udhëzimit nr. 25 të Ministrisë të Financave për “*Procedurat e Shqyrtimit të Vlerës Doganore*”.

Indikatorët e pakërkuar nga personeli përpunues doganor të cilat mund të shërbenin si indikatorë rrisht gjatë procesit të vlerësimit doganor

-2.8 Fatura nuk është lëshuar nga prodhuesi.

-2.14 Në faturë nuk jepet informacion i plotë, numri i regjistrimit fiskal

-2.22 Kontratë me firmën shitëse.

-2.23 Deklaratë eksporti nga vendi eksportues.

-2.24 Fatura të sigurimit të mallit.

Gjithashtu në zbatim të pikës 4 të Udhëzimit nr. 25 i cili përcakton se, “*mund të përdoren metoda alternative të vlerësimit të mallrave (mallra identike/të ngjashme). Kjo e bazuar në të dhënat e transaksioneve të pranuar. Këto të dhëna janë të disponueshme edhe në formë elektronike, përmes moduleve të veçanta të ndërtuara për këtë qëllim në nivel qendror*” nuk janë kryer veprime verifikuese dhe vlerësimi nga personeli përpunues doganor.

Sa më poshtë dhe disa raste të deklarimeve të subjektit “IDI MITA”

EKSPORTUESI	VITI	DAV	SUBJ	NIPT	ARTIKULL	COPE	VL/EU
MAYA 2000	2017	4457	IDI MITA	K91801004N	ORA DORE Armani/Michael Kors/HugoBos	15	472
MAYA 2000	2017	5615	IDI MITA	K91801004N	ORA DORE Armani/Michael Kors/HugoBos	13	384
MAYA 2000	2017	15602	IDI MITA	K91801004N	ORA DORE Armani/Michael Kors/HugoBos	15	441
MAYA 2000	2017	8918	IDI MITA	K91801004N	ORA DORE Armani/Michael Kors/HugoBos	16	459
MAYA 2000	2017	7518	IDI MITA	K91801004N	ORA DORE Armani/Michael Kors/HugoBos	25	738
							7235

Nga personeli përpunues doganor nuk janë kryer veprime verifikuese pranë selive të kompanisë eksportuese për verifikimin e transaksioneve të kryera si dhe nuk është kërkuar garantimi i menjëhershëm i borxhit doganor që mund të lindë deri në përfundim të plotë të hetimit dhe verifikimit të transaksioneve të kryera nga kompania lëvruese “**MAYA 2000 LTD FROGNAL VENUE HARROË GB**” me seli në Angli, për detyrime doganore që mund të rilindin në rast të ardhjes së përgjigjeve negative nga Autoritetet Doganore Angleze bazuar në përcaktimet e nenit 204 deri 214 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999, “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, sipas shpjegimeve të Pjesës VII kreu I “Garancia për të mbuluar një borxh doganor me detyrime të importit të pezulluara*” dhe 77 pika 1/a dhe nenit 84-90 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “*Kodi i Ri Doganor në RSH*” i ndryshuar, për deklarime doganore të evidentuara sa më sipër deri në përfundim të Hetimit që do të kryhet nga Administrata Doganore Shqiptare pranë selisë së kompanisë lëvruese.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Ligjin nr. 8449 datë. 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar

Ligjit 102/2014 datë 31.7.2014 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 3, datë 02.03.2018 dhe për këtë çështje subjekti i audituar, ka bërë komente dhe shpjegime me shkresën nr. 1347/7 Prot KLSH datë 25.04.2018 dhe shkresën nr. 1597 prot DDRinas datë 24.04.2018.

Me shkresën nr. 1453 prot DDRinas datë 17.04.2017 i është kërkuar interpretim verifikim doganor Departamentit Operativ-Hetimor për qëllime të vlerës doganore të transaktuar për artikujt e konstatuar për mallra të deklaruara dhe konstatuar sa më sipër gjatë procedurës audituese. Dega Doganore Rinas konkludon se në përfundim të verifikimeve që do të mbërrijnë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave do të konkludojë për veprimet e



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

mëtejshme në lidhje me kontabilizimin e detyrimeve doganore dhe penaliteteve për rastet e përmendur sa më sipër si dhe për përgjegjësinë e personelit doganor të përmendur sa më sipër gjatë kryerjes së detyrave funksionale në zbatim të legjislacionit doganor në fuqi.

♦. Në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave të deklaruar në kapitullin *9003* të natyrës skelete syze optiketë deklaruar nga subjektet “Lindita Hasanaj” dhe “Griselda Belshi” dhe “Kalama” konstatohet se rezultojnë deklarime të këtyre mallrave nën vlerën e të Dhënave të Disponueshme në RSH të publikuara në nivelin “15 euro/origjinë EU” dhe “13usd/origjinë NEU”.

VEND	VITI	DAV	SUBJEKT	NIPT	ARTIKULL	NJESI	VL/COP
Franca	2016	22430	Gris/Belshi	L11702020N	Skelete syze optike	401	5,8
Gjerm	2017	13305	Kalama	J61811054C	Skelete syze optike	78	6,3
Italia	2016	21200	Lindita Hasanaj	K52401002G	Skelete syze optike	75	8,4
Italia	2017	17148	Lindita Hasanaj	K52401002G	Skelete syze optike	95	6,6
Italia	2016	11037	Lindita Hasanaj	K52401002G	Skelete syze optike	155	7,0
Italia	2017	3527	Lindita Hasanaj	K52401002G	Skelete syze optike	192	5,5
Italia	2016	2626	Lindita Hasanaj	K52401002G	Skelete syze optike	236	5,7
Italia	2016	11037	Lindita Hasanaj	K52401002G	Skelete syze optike	250	8,2
Italia	2017	17148	Lindita Hasanaj	K52401002G	Skelete syze optike	345	6,6
Italia	2016	1773	Lindita Hasanaj	K52401002G	Skelete syze optike	346	5,7
Italia	2016	16092	Lindita Hasanaj	K52401002G	Skelete syze optike	370	6,7
Italia	2016	21200	Lindita Hasanaj	K52401002G	Skelete syze optike	470	6,9

Në zbatim të shpjegimeve dhe përcaktimeve të Udhëzimit nr. 25 të Ministrit të Financave duhet të ishte kryer analiza e indikatorëve respektivisht sipas kriterëve të poshtëcituar:

1. Indikatorët mbi të cilat do të mbështetet kjo analizë janë.

2.1 vlerat e mallrave identike apo të ngjashme të pranuar me transaksionin në sistemin doganor brenda 3 muajve të fundit. (procedurë e pakryer nga personeli përpunues doganor)

2.2 vlera të konfirmuara nga verifikimi i faturave që kanë rezultuar me diferenca (procedurë e pakryer nga personeli përpunues doganor)

2.3 vlera e mallrave të dërguara zyrtarisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave si të dhëna të disponueshme etj.; (procedurë e pakryer nga personeli përpunues doganor)

2.22 kontratë me firmën shitëse (procedurë e pakërkuar dhe pakryer nga personeli përpunues doganor)

2.24 fatura të sigurimit të mallit (procedurë e pakërkuar dhe e pakryer nga personeli përpunues doganor si dhe nuk rezulton e deklaruar nga operatori ekonomik)

2. Nëse nga analiza e indikatorëve të mësipërm justifikohet plotësisht vlera e deklaruar pranohet vlera e transaksionit. Në rastet, kur vlera e deklaruar krahasuar me të “Dhënat e Disponueshme” të përmendura më sipër është dukshëm më e ulët praktika e plotë i dërgohet për verifikim Departamentit Operativ Hetimor Drejtorisë së Inteligjencies dhe një kopje njësisë së kontrolleve aposteriori, që janë përgjegjës për verifikimin e plotë brenda dhe jashtë vendit. (Procedurë e pakërkuar dhe e pakryer nga personeli përpunues doganor)

3. Nëse nga analiza e indikatorëve të mësipërm, nuk justifikohet plotësisht vlera e transaksionit e deklaruar, pra është e dyshuar, njoftohet me shkrim deklaruesi (agjencia doganore ose përfaqësuesi) në rast se kërkohet nga subjekti deklarues dhe në zbatim të nenit 35 të Kodit Doganor, mund të përdoren metoda alternative të vlerësimit të mallrave (mallra identike/të ngjashme). (Procedurë e pakërkuar dhe e pakryer nga personeli përpunues doganor)

4. Vetëm në rastet, kur nuk është e mundur që çmimi i mallit të përcaktohet sipas procedurave të përcaktuara më sipër bazuar në nenet 34, 35 të Kodit Doganor, si bazë vlerësimi mund të përdoret “Dosja e Të Dhënave të Disponueshme” (Procedurë e pakërkuar dhe e pakryer nga personeli përpunues doganor)

5. Përcaktimi i vlerës së mallit bazuar në pikat e mësipërme, gjithmonë duhet të shoqërohet nga një procesverbal sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi, ku duhet të plotësohen



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

indikatorët e kontrolluar me shenjë “X” (*Procedurë e pakërkuar dhe e pakryer nga personeli përpunues doganor*)

Konstatohet se nga Autoriteti Doganor Rinas nuk është kërkuar verifikim doganor pranë selive të kompanive lëvruese për mallra të natyrës “*skelete size optike*” të importuar nga shoqëria “*Lindita Hasanaj*” dhe “*Griselda Belshi*” të deklaruar jashtë kushtit preferencial MSABE në praktikën doganore nën juridiksionin auditimi (2015-2017) në përmbushje të përcaktimeve ligjore të Udhëzimit nr. 25 të Ministrisë të Financave.

<i>Eksportuesi</i>	<i>Subjekti</i>	<i>NIPT</i>
Opallyonfrance	Griseida Belshi	L11702020N
Thema Optical Srl domegge di Cadore italy	Lindita Hasanaj	K52401002G

Konstatohet se nga Dega Doganore Rinas është kërkuar verifikim doganor për tre praktika doganore të vitit 2016 dhe 2017 përkatësisht R 16092 datë 09.08.2016, R 6175 datë 01.04.2016 dhe R 3527 datë 17.02.2017 dhe nuk administrohet asnjë përgjigje nga Departamenti Operativ-Hetimor për këto praktika doganore.

Gjithashtu nga Dega Doganore Rinas është kërkuar nga Departamenti Teknik në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave rishikimi i të Dhënës së Disponueshme për artikullin “*skelete syze optike*” me shkresën nr. 1112 prot datë 05.04.2017 dhe nuk administrohet asnjë përgjigje nga DPD për këtë rast.

Në përfundim konstatohet se nuk është kërkuar verifikimi i saktë i transaksioneve të kryera **pranë selive të kompanive lëvruese ose eksportuese të këtyre mallrave** për praktikën doganore të përfshira dhe evidentuara sa më sipër si dhe garantimi në përputhje me legjislacionin doganor për pjesën e borxhit që mund të lindë nga rezultatet e verifikimit doganor në përputhje me garantimin e pjesës së detyrimit doganor të munguar dhe që mund të rilindë në rast të ardhjes së përgjigjeve negative nga Autoritetet Doganore Homologe Italisë bazuar në nenin 204, 205, 206, 207, 208, 209, 210, 211, 212, 213 dhe 214 të Kodit Doganor sipas shpjegimeve të Pjesës VII kreu I “*Garancia për të mbuluar një borxh doganor me detyrime të importit të pezulluara*” për praktikën doganore të cituara sa më sipër.

♦. Në lidhje me vlerësimin doganor të mallit të subjektit “*Aja Bakerry&Së ëtts*” me nipt L12227009A për mallin e deklaruar “*ambalazh paketimi*” në praktikën doganore nr. R 19005 datë 22.08.2017 të deklaruar në kodin tarifor 39231090 sipas kushtit “*ambalazh plastik në paleta*” në peshën totale 635 kg netto. Nga auditimi i praktikës konstatohet se mallrat e përfshira në faturën e mallit cilësohen si “*material paketues për kafeteri*”. Konstatohen veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 8 datë 30.12.2013 “*Për zbatimin praktik të taksës së ambalazhit*” i nxjerrë në zbatim të Ligjit nr. 9975 datë 28.07.2008 “*Për Taksat Kombëtare*” i ndryshuar. Artikulli “*material paketues për kafeteri*” duhet të klasifikohet në kodin e paketimit *74* (*ambalazh plastik bosh*) dhe jo në kodin *71* (*ambalazh plastik jo në paleta*)

Rezultojnë të papaguara detyrime doganore në **shumën 74,000 lekë** detyrim doganor si pagesë për taksën kombëtare të akcizës për produkte ambalazhi.

Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet doganore, të përcaktuara në nenin 251, duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm:

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Dega Doganore Rinas të rishikojë deklarin doganor të kryer në praktikën doganore të mësipërme duke marrë në konsideratë amendimin e deklaratave doganore referuar shpjegimeve të mësipërme bazuar në nenin 47,48,49, me qëllim pagesën e detyrimit doganor në shumën totale **prej 74,000 lekë** si detyrim doganor të deklaruar në kundërshtim me shpjegimet e të ligjit nr. 9975 datë 28.07.2008 “*Për Taksat Kombëtare*” i ndryshuar

Vlera prej 74,000 lekë, e cila përfaqëson detyrim doganor do të konsiderohet e ardhur e munguar shkaktuar Buxhetit të Shtetit.



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore

Ligjit nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” i ndryshuar

Sipas ligjit 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar:

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 3, datë 02.03.2018 dhe për këtë çështje subjekti i audituar, ka bërë komente dhe shpjegime me shkresën nr. 1347/7 Prot KLSH datë 25.04.2018 dhe shkresën nr. 1597 prot DDRinas datë 24.04.2018.

*Me shkresën nr. 1597 prot DDRinas datë 24.04.2018 dhe trajtime që u bënë gjatë fazës ballafaqese në KLSH më datë 30/04.2018 ku u pranua konstatimi i kryer nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe u deklarua nga përfaqësuesit e Degës Doganore Rinas marrja e menjëhershme e masave për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve doganore në shumën 74,000 lekë nga ngarkim të subjektit “Aja Bakery&Sëtts” me nipt L12227009A për mallin e deklaruar “**ambalazh paketimi duke ritrajtuar edhe veprimet e kryera nga personeli përpunues doganor***

◆. Nga ana e personelit përpunues doganor pranë Degës Doganore Rinas nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në legjislacionin doganor për sa i përket procedurave doganore të kryera në praktikat doganore të deklaruara sipas kushtit preferencial MSABE. Trajtimi tarifor sipas kushtit preferencial MSABE i deklaruar në praktika doganore të mëposhtme është jo i plotë dhe jo në përmbushje me shpjegimet e Udhërrëfyesit sipas Ligjit nr. 9590, datë 27.07.2006 për ratifikimin e MSABE, Udhëzimit nr. 5883 datë 16.05.2006 të DPD “*Dokumentacioni i detyrueshëm për vërtetimin e origjinës preferencialë*”, nenit 32 të Kodit Doganor pika 1. 2 dhe 3. Personeli përpunues doganor ka kryer veprime në kundërshtim me shpjegimet dhe përcaktimet të Udhëzimit nr. 2077 prot datë 06.08.2010 “*Mbi rregullat e Origjinës*”, dokumentit të Udhërrëfyesit sipas ligjit nr 9590 datë 27.07.2006, “*Për ratifikimin e marrëveshjes së stabilizim asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve Europiane dhe shteteve të tyre anëtare*”, pjesa V, Titulli “*Vërtetimi i Origjinës*”, neni 22 “*Kushtet për bërjen e një deklarate faturë*” dhe neni 33 “*Verifikimi i Dëshmimeve të Origjinës*”. Në vijim të Udhëzimit nr. 2077 prot datë 06.08.2010 “*Mbi rregullat e Origjinës*” dhe në vijim në zbatim dokumentit të Udhërrëfyesit pjesa V, Titulli “*Vërtetimi i Origjinës*”, neni 22 “*Kushtet për bërjen e një deklarate faturë*” pika 2, 3 4, 5 dhe 6 “*eksportuesi i mallit që lëshon një deklarate faturë duhet të përgatitet në çdo kohë me kërkesën e autoriteteve doganore të vendit eksportues të gjitha dokumentet e nevojshëm që provojnë statusin origjinues të produkteve në fjalë si dhe kërkesat e tjera të këtij protokollit*”. Neni 33 “*Verifikimi i Dëshmimeve të Origjinës*” ligjit nr 9590 datë 27.07.2006, “*Për ratifikimin e marrëveshjes së stabilizim asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare*”

“eksportuesi i mallit që lëshon një deklarate faturë duhet të përgatitet në çdo kohë me kërkesën e autoriteteve doganore të vendit eksportues të gjitha dokumentet e nevojshëm që provojnë statusin origjinues të produkteve në fjalë si dhe kërkesat e tjera të këtij protokollit”

Referuar nenit 32, pika 1, sipas ligjit nr 9590 datë 27.07.2006, “*Për ratifikimin e marrëveshjes së stabilizim asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve Europiane dhe shteteve të tyre anëtare*” përcaktohet qartë që:

Bazuar në pikën 2 të nenit 32 të Marrëveshjes Stabilizim Asocimit përcakton se “Bashkëpunimi i ndërsjellë” përcakton se me qëllim aplikimin e duhur të këtij protokollit, Komuniteti dhe Shqipëria duhet të ndihmojnë njëra tjetrën, në verifikimin nëpërmjet administratave doganore kompetente, në kontrollin e origjinalitetit të certifikatave EUR. I ose të deklaratave faturë”

”Dokumentacioni i detyrueshëm për vërtetimin e origjinës preferencialë

“Një deklarate faturë duhet të bëhet nga eksportuesi duke shtypur stampuar, ose printuar mbi faturën, notën ...në përputhje me dispozitat e ligjit vendas të vendit eksportues. Nëse deklarata është e shkruar me dorë, duhet të shkruhet me bojë në gërma kapitale. Deklaratat faturë duhet të kenë firmën origjinale të eksportuesit të shkruar me dorë”



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

Sa më poshtë tabela e rasteve të konstatuara.

VITI	DAV	SUBJEKT	NIPT	ARTIKULL	VL/MALL/EU	VENDI	DOKUMENTI	NR.DOC
2016	4996	Altin Kapidani	K31527594O	Artikuj Argjendi	7137	Turqi	Eur.1	N.01007185
2017	23383	Fredi Elektroniks	K91803020F	Kabell Koaksioal	2500	Itali	D.Fature	Nr.62
2016	12055	Euroelektra	L01808013Q	Kamera Net ëork	4799	Gjermani	D.Fature	R1...20979
2016	19072	Pegasus	K62717603C	Ushqim Bletësh	10159	Irlanda	EUR.1	Nr.A965674
2016	6985	Ottica Bruna	J61828092H	Skelete syze optike	5500	Luxemburg	D.Fature	FV160827

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Dega Doganore Rinas të rishikojë deklarinimin doganor të kryer në praktikat doganore të mësipërme me qëllim kryerjen e verifikimeve të dëshmuve të origjinës “**Deklarata Faturë**” dhe “**Dokument EUR.1**” pranë Drejtorisë së Origjinës në Departamentin për verifikim nga Autoritetet Doganore Homologe të vendit eksportues me qëllim provimin e vërtetësisë së origjinës së mallrave të lëvruara në praktikat doganore të poshtë cituara: Dega Doganore Rinas për detyrime doganore që mund të rilindin në rast të ardhjes së përgjigjeve negative nga Autoritetet Doganore Homologe bazuar në përcaktimet e nenit 204 deri 214 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, sipas shpjegimeve të Pjesës VII kreu I “**Garancia për të mbuluar një borxh doganor me detyrime të importit të pezulluara**” dhe 77 pika 1/a dhe nenit 84-90 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “**Kodi i Ri Doganor në RSH**” i ndryshuar, të kërkojë dhe garantim doganor borxhit doganor që mund të lindë për deklarime doganore të evidentuara sa më sipër deri në përfundim të Hetimit që do të kryhet nga Administrata Doganore Shqiptare pranë Autoriteteve Doganore Homologe.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore

Ligjin nr. 8449 datë. 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar Ligjit 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar Udhëzimit nr. 2077 prot datë 06.08.2010 “Mbi rregullat e Origjinës”.

Ligjit nr. 9590 datë 27.07.2006, “Për ratifikimin e marrëveshjes së stabilizim asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve Europiane dhe shteteve të tyre anëtare

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Flora Gjini me detyrë ish doganiere pranë Degës Doganore Rinas aktualisht jo në mardhënie pune

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 3, datë 02.03.2018 dhe për këtë çështje subjekti i audituar, ka bërë komente dhe shpjegime me shkresën nr. 1347/7 Prot KLSH datë 25.04.2018 dhe shkresën nr. 1597 prot DDRinas datë 24.04.2018.

Me shkresën nr. 1468 prot DDRinas datë 18.04.2018 dhe shkresën nr. 887 prot DDRinas datë 08.03.2018 i është kërkuar verifikim doganor për deklaratat doganore nr. R 4996 datë 16.03.2016 dhe nr. R 23383 datë 12.10.2017 të përpunuar nga personeli përpunues doganor znj Najada Pepa dhe znj Elvana Sakiqi pranë Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për qëllime të vërtetësisë së tarifës doganore të reduktuar të transaktuar për artikujt e konstatuar për mallra të deklaruara dhe konstatuar sa më sipër gjatë procedurës audituese. Dega Doganore Rinas konkludon se në përfundim të verifikimeve që do të mbërrijnë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave do të konkludojë për veprimet e mëtejshme në lidhje me kontabilizimin e detyrimeve doganore dhe penaliteteve për rastet e përmendur sa më sipër si dhe për përgjegjësinë e personelit doganor të përmendur sa më sipër gjatë kryerjes së detyrave funksionale në zbatim të legjislacionit doganor në fuqi.

♦. Në lidhje me vlerësimin doganor të mallit të subjektit “**ALBUM-1**” me NIPT L12823401C për deklarime doganore në praktikën nr. 18702 datë 13.09.2016 për artikullin “Pajisje Matëse 4 cp” në vlerën 88,460 Euro në peshën 350 kg të deklaruara sipas kushtit preferencial



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

MSABE. Konstatohet në praktikën doganore se dokumentacioni shoqërues përmbush vetëm mallrat e deklaruar në faturën e mallit nr. **F. 320380** sipas referimit nr. **R. 20160803/4** lëshuar më datë 06.09.2016 nga kompania “**Camplin Po ëer, Ferguson Drive Lisburn, Co Doën, BT 282EX**”, sipas kushtit CIP dhe trajtuar me kusht preferencial MSABE. Bashkangjitur praktikës doganore administrohen 3 pagesa bankare në **vlerën totale 115,590 Euro** nga të cilat, vlera 15,590 euro datë 01.09.2016, vlera 50,000 euro datë 01.09.2016 dhe vlera 50,000 euro datë 02.09.2016 të kryera pranë Bankës Intesa San Paolo. Konstatohen parregullsi të renda materiale të kryera nga veprimet e personelit doganor që ka kryer kontrollin dokumentar pasi ka mungesë të dokumentacionit ligjor që lidhet me faturat e mallit (**mungon fatura për vlerën e mallit prej 44,230 Euro**) dhe nuk dokumentohet diferenca e transfertave bankare në **shumën 27,130 Euro** krahasuar kjo me deklarinimin e bërë në praktikën doganore të mësipërme. Referuar nenit 93 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, personeli përpunues doganor nuk ka ndërmarrë veprime verifikuese që lidhen me plotësimin e “*Dokumentacionit që shoqëron Deklaratën Doganore*” sipas shpjegimeve të Seksionit 4 të Titullit 10 “*Deklarata Doganore*”. si dhe nuk është ushtruar e drejta e kontrollit.

Pika 2 neni 71 “*Kontrollit të Mallrave dhe Mjeteve*” i Kodit Doganor ku saktësohet se “*me qëllim që të kontrollohen mallrat dhe mjetet e transportit që i kanë sjellë këto mallra autoritetet doganore mund të kërkojnë në çdo kohë shkarkimin dhe shpaktimin e mallrave*”

Gjithashtu:

“*Për të kryer verifikimin e deklaratave të pranuar Autoritetet Doganore mund, të shqyrtojnë dokumentet në mbështetje të deklaratës dhe dokumentet shoqëruese. Autoritetet i kërkojnë deklaruuesit të paraqesë dokumente të tjera për të verifikuar saktësinë e të dhënave të deklaratës, si dhe të kontrollojnë mallrat*”

Referuar nenit 256, pika 1/a dhe 2 e Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar,

Çdo veprim ose mosveprim, që bie ndesh me dispozitat e parashikuara në këtë Kod, me aktet nënligjore të tij dhe me dispozita të tjera në fuqi, me përjashtim të rasteve të fuqisë madhore, quhet kundërvajtje administrative doganore dhe dënohet si e tille.

Referuar nenit 275, pika 1 e Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar.

Për shkeljet, të cilave u referohet neni 256 paragrafi 2 dhe të paparashikuara shprehimisht në këtë kre, zbatohet një gjobë që shkon nga 50 000 lekë deri në 200 000 lekë.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Dega Doganore Rinas të rishikojë deklarinimin doganor të kryer në praktikën doganore të mësipërme me qëllim kryerjen e verifikimit doganor të deklarimit të kryer në praktikën doganore nr. 18702 datë 13.09.2016 sipas “**Deklaratës Faturë nr.F. 320380** me referim nr. **R. 20160803/4** lëshuar më datë 06.09.2016 nga kompania “**Camplin Poëer, Ferguson Drive Lisburn, Co Do ën, BT 282EX**” si dhe transaksioneve të kryera nga kompania “**ALBUM-1**” për mallra të lëvruara në këtë praktikë doganore nga kompania eksportuese me seli në Britaninë e Madhe duke informuar Drejtorinë e Hetimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave mbi faktet e evidentuara sa më sipër që lidhen edhe me diferencën e në tepricë të pagesave bankare në **shumën 27,130 Euro** të kryera nga ky subjekt drejt kompanisë lëvruese të mallit. Në zbatim të shpjegimeve të nenit 256 dhe 275 të Kodit Doganor të penalizohet subjekti ‘**ALBUM-1**’ me nipt **L12823401** në shumën **200,000 lekë**

Vlera prej 200,000 lekë, e cila përfaqëson penaltet do të konsiderohet e ardhur e munguar shkaktuar Buxhetit të Shtetit.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore

Sipas ligjit 102/2014 datë 31.7.2014 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

1. z. Përparim Tollia me detyrë doganier pranë në D.D Rinas aktualisht në DDDurrës.

Gjetjet kryesore

Drejtimi nr. 3 “Auditimi i sistemit të vlerësimit doganor dhe klasifikimit tarifor të mallrave gjatë periudhës nën auditim”

Titulli i Gjetjes 1	Zbatimi i procedurave të sakta doganore në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave, dhe klasifikimin tarifor të mallrave.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se nga personeli përpunues doganor nuk janë rillogaritur të sakta elementët e vlerës doganore për efekt taksimi doganor që lidhen me vlerësimin doganor të disa mallrave për qëllime të vlerës doganore, janë deklaruar mallra të caktuar në mospërmbushje të shpjegimeve të Nomenklaturës së Mallrave në RSH, raste të mospagimit të taksës kombëtare të ambllazhit plastik duke krijuar të ardhura doganore të munguara të rillogaritura nga grupi auditues dhe të rekomanduara në shumën 3,744 mijë lekë në këtë Projektraport Auditimi për periudhën nën juridiksion auditimi nga data 01.01.2016 deri në datën 31.12.2017.
Kriteri :	Neni 34 deri 37 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neneve 65-70 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 25 datë 16.05.2006 të DPD ,”Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore”,shkresës nr. 779 prot DPD datë 16.01.2013 “Mbi rishikimin e disa Indikatorëve shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE”,
Ndikimi/Efekti	Konstatohet efekt financiar i munguar nga të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në formën e detyrimit doganor dhe gjobës doganore në shumën të ardhuradoganore të rillogaritura në shumën 3,744 mijë lekë për periudhën nën juridiksion auditimi nga data 01.01.2016 deri në datën 31.12.2017.
Rëndësia	i larte
Rekomandimi	Dega Doganore Rinastë ndjekë të gjitha rrugët ligjore me qëllim analizimin dhe nxjerrjen e vendimeve administrative për kontabilizimin dhe më pas arkëtimin e detyrimeve doganore në shumën 3,744 mijë lekë përperiudhën nën juridiksion auditimi nga data 01.01.2016 deri në datën 31.12.2017 që lidhen me rillogaritje pagesash detyrime doganore në import për të cilat nuk është vepruar në përputhje dhe mbështetje të shpjegimeve të nenit 34 deri 37 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neneve 65-70 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 25 datë 16.05.2006 të DPD ,”Për



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

Shqyrtimin e Vlerës Doganore”,shkresës nr. 779 prot DPD datë 16.01.2013 “*Mbi rishikimin e disa Indikatorëve shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE*”,

Titulli i Gjetjes 2	Zbatimi i procedurave të sakta doganore në lidhje e përfitimin e kushtit tëtrajtimit tarifor preferencial MSABE(reduktimit nga pagesa e tarifës doganore)
Situata:	Nga auditimi u konstatua se nga personeli përpunues doganor nuk janë marrë në konsideratë përcaktimet ligjore tëshpjegimeve të Udhërrëfyesit të MSABE “ <i>Mbi Rregullat e Origjinës Preferenciale të përdorura në tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe Vendeve të tjera sipas Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë</i> ” dalë sipas ligjit nr. 9590, datë 27.07.2006 për “ <i>Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim–Asocimit</i> ” duke mos dërguar për verifikim doganor Deklaratat Faturë dhe Dokumentet Eur 1 sipas praktikave të evidentuara në këtë Projektraport Auditimi
Kriteri :	Përcaktimet ligjore të Udhërrëfyesit të MSABE “ <i>Mbi Rregullat e Origjinës Preferenciale të përdorura në tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe Vendeve të tjera sipas Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë</i> ” dalë sipas ligjit nr. 9590, datë 27.07.2006 për “ <i>Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit</i> ”, Udhëzimit nr. 2077 prot datë 06.08.2010 “ <i>Mbi rregullat e Origjinës</i> ”, neni 22 “ <i>Kushtet për bërjen e një deklarate faturë</i> ” pika 2, 3 4, 5 dhe 6 dhe neni 33 “ <i>Verifikimi i Dëshmive të Origjinës</i> ”.të Udhërfyesit.
Ndikimi/Efekti	Konstatohenprocedura doganore të pakërkuara për verifikim doganor bazuar në dyshime të arsyeshmenë lidhje me dokumentet EUR 1 dhe Deklarate Fature sipas shpjegimeve dhe përcaktimeve Udhërrëfyesit të MSABE “ <i>Mbi Rregullat e Origjinës Preferenciale të përdorura në tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe Vendeve të tjera sipas Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë</i> ” dalë sipas ligjit nr. 9590, datë 27.07.2006 për “ <i>Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit</i> ”
Rëndësia	I larte
Rekomandimi	Dega Doganore Rinastë ndjekë të gjitha rrugët ligjore për analizimin e praktikave doganore të cituara në këtëProjektraport Auditimi me qëllim verifikimin e dokumentacionit tregëtar EUR.1 dhe Deklaratë Faturë të përdorur për përfitimin e kushtit të origjinës preferenciale MSABE dhe MTLTR pranë Autoriteteve Doganore Homologe sipas rasteve të përmendura në këtë Projektraport Auditimi për 5(pesë) pranë Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhebazuar në përcaktimet e neni 204 deri 214 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999,“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë,sipas shpjegimeve të Pjesës VII kreu I “ <i>Garancia për të mbuluar një borxh doganor me detyrime të importit të pezulluara</i> ” dhe 77 pika 1/a dhe neni 84-90 të



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “*Kodi i Ri Doganor në RSH*” i ndryshuar, të kërkojë dhe garantim të borxhit doganor që mund të lindë për deklarime doganore të evidentuara sa më sipër deri në përfundim të verifikimit që do të kryhet nga Administrata Doganore Shqiptare pranë Autoriteteve Doganore Homologe

✚ Drejtimi nr. 4 i Auditimit “*Auditimi i procedurave doganore të ndjekura nga sektori rregjime/përrjashtime gjatë mbikëqyrjes së rregjimeve ekonomike*”.

Në zbatim të pikës 4 të programit të auditimit nr. 1347/1, datë 19.01.2018, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Informacionet e paraqitura nga Zyra e Regjimeve pranë D.D.Rinas, lidhur me zbatimin e procedurave për mbikëqyrjen dhe administrimin e regjimeve ekonomike doganore, gjatë periudhës në auditim.
2. Lista analitike e regjimeve ekonomike të autorizuara nga DPDoganave dhe D.D.Rinas për administrimin e Regjimit të Përpunimit Aktiv, Regjimit të Lejimit të Përkohshëm dhe Regjimit të Magazinave Doganore, gjatë viteve 2016-2017.
3. Bilancet e viteve 2016, 2017, sipas subjekteve dhe regjimeve të autorizuara.
4. Kontrollat e ushtruara nga Zyra e Regjimeve dhe strukturat e specializuara të Kontrollit Pas Zhdoganimit, Kontrollit të Brendshëm të DPDoganave apo Ministrisë së Financave.
5. Akt-Rakordimet mujore të paraqitura nga administratorët e subjekteve të autorizuar për administrimin e regjimeve ekonomike të autorizuar, për vitet 2016, 2017.
6. Inventarët mujore dhe tremujore të kryera në ambientet e subjekteve të autorizuara nga DPDoganave dhe D.D.Rinas.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm u konstatua se:

Autoritetit doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas gjatë periudhës në auditim ka punuar për zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, dispozitat e përbashkëta të regjimeve nenet 108-113, të Magazinave Doganore nenet 121-136, të Regjimit të Përpunimit Aktiv nenet 135-144 të Regjimit të Lejimit të Përkohshëm nenet 157-164, kërkesat e vendimit të KM nr. 205, datë 13.04.1999 “Për miratimin e Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar, si dhe kërkesat e udhëzimit nr. 25 datë 30.11.2007 të Ministrisë së Financave “për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhënat e disponueshme, si dhe zhdoganimin e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit”.*

Për sa mësipër referuar neneve nr. 108,109 /a/b, 110/1/2, 121/1/a/b, 124/a/b/c, 128/1/2, 130, 131/1/2, 136/1/a/b, 137, 138/a/b/c, 139/1/2, 140/1/2, 141,142/1/2, 143/a/b/c/d, 144/1/2/a/b, 157, 158, 159, 160/1/2/3, 161, 162/1/2, 163/1234, dhe 164/1/2, të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar me ligjin nr. 102/2014 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar me ligjin nr. 32, datë 02.04. 2015, të VKM-së nr. 205, datë 13.04.1999, “*Për miratimin e Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor*” i ndryshuar, si dhe udhëzimit nr. 25 datë 30.11.2007 të Ministrisë së Financave “*për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhënat e disponueshme, si dhe zhdoganimin e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit*”.

janë trajtuar përmbajtjet e neneve të nxjerra nga legjislacioni doganor që lidhen me zbatimin e procedurave sipas llojeve të regjimeve pezulluese apo ekonomike.

Nga auditimi i ushtruar mbi dokumentet e paraqitura nga Zyra Mbikëqyrëse e Regjimeve pranë D.D Rinas për periudhën në auditim vitet 2016-2017, lidhur me zbatimin procedurave ligjore për administrimin e regjimeve doganore:



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

Në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 108-164, të kërkesave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 205, datë 13.04.1999 “Për miratimin e Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar, të udhëzimit nr. 25 datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhënat e disponueshme, si dhe zhdoganimin e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit”, si dhe të udhëzimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, nr. 6, datë 23.07.2013 dhe nr. 4, datë 07.04. 2016, “mbi zbatimin praktik të procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor dhe të akcizës” u konstatua se;

1. Magazinat Doganore;

a- Magazina doganore e Tipi -C, “Albania Duty Free Shop”, me NIPT J91914004L.

është pajisur nga Ministria e Financave me autorizimin nr. 6233/1, datë 26.08.2009, për ushtrimin e aktivitetit tregëtar në fushën e biznesit pranë ambientit të aeroportit Ndërkombëtar “Nënë Tereza” Rinas, nëpërmjet importit të mallrave në të gjithë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Aktiviteti i këtij subjekti është tregtimi i mallrave si; Pije të ndryshme, Cigare, Parfume dhe mallra të tjera të huaja apo shqiptare, në përputhje me dispozitat e Kodit Doganor dhe Dispozitat Zbatuese të këtij kodi.

Aktualisht ky subjekt e vazhdon aktivitetin e tij në zbatim të vendimit gjyqësorë nr. 994, datë 14.05.2015 deri në muajin maji të vitit 2019.

Numri i identifikimit i Magazinës Doganore “Albania Duty Free Shop” është “CDF001”, e cila për mallrat e importuara zbaton procedurën Imp. 7/1 dhe për mallrat me origjinë shqiptare zbaton procedurën Imp. 7/2 dhe EX1, EX3, në fillim të çdo muaji.

Nga auditimi i dosjes së operatorit ekonomik që administrohet nga Zyra e Regjimeve u konstatua se; në dosjen e subjektit gjenden dokumentacion i plotë ligjorë që nga miratimi i regjimit të magazinës doganore , Statusi operatorit, NIPT-i, Certifikata Tatimore, Planimetria vendndodhjes (Në Terminalin e Aeroportit) etj. Në bazë të Kodit të Ri Doganor të RSH, nr. 102/2014, i ndryshuar, nenet 213-222, si dhe Dispozitave Zbatuese të KD nr. 651, datë 10.11.2017, neni 634, ky subjekt vazhdon aktivitetin e magazinës doganore i çliruar nga taksat dhe me kohëzgjatje pa afat të qëndrimit të mallrave në regjimin e magazinës doganore Tipi C, “Albania Duty Free Shop” është “CDF001”.

Përsa u përket mallrave dhe materialeve promocionale, ekspozitor të ndryshëm, testerat e produkteve, mallrat që janë në shërbim u jepet destinacion doganor Imp.4.

Në fund të çdo muaji janë përgatitur librat (regjistrat) e inventarëve fizik të cilat janë kontrolluar dhe vulosur nga doganieri i mbikëqyrjes së regjimit doganor.

Në dosjen e subjektit gjenden akt-rakordimet mujore të përgatitura për çdo muaj sipas viteve të audituara 2016-2017, të cilat janë dërguar në Zyrën e Regjimeve brenda datës 5 të muajit pasardhës.

Në zbatim të ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i RSH”, i ndryshuar, si dhe Dispozitat Zbatuese të KDoganor u konstatua se; në ambientet e brendshme të magazinës doganore janë ushtruar kontrole periodike, bazuar në programet e kontrollit të miratuara nga Kryetari i Degës së Doganës Rinas.

Autoriteti doganore kompetent, Dega e Doganës Rinas gjatë vitit 2016 janë ushtruar 2 kontrole në ambientet e subjektit Duty Free Shop, për të cilat është zbatuar një detyrim doganor në vlerë 5,105 lekë dhe gjobë sa dyfishi I detyrimeve në vlerë 10,210 lekë në total 515,315 lekë të cilat janë arkëtuar. Ndërsa gjatë vitit 2017, grupi I punës ka ushtruar 4 (katër) kontrole në ambientet e këtij subjekti, nga të cilat nuk kanë rezultuar shkelje doganore.



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

b- Magazina doganore Tipi-C “Air BP-Albania” SHA me NIPT J92302002L, me numër identifikimi **C002**, është pajisur me autorizimin nr. 2626/10820, datë 12.09.2006 për zbatimin e regjimit doganor të miratuar në hyrje Imp.7, të karburanteve për furnizimin e avionëve, stokim (magazinim) dhe në dalje riekспорт.

Kapaciteti i autorizuar për stokim në Tankera shkon nga 600,000-1,100,000 litra karburantë, afati kohorë për dorëzimin e inventarit të karburantit është data 5 e muajt pasardhës. Me shkresën nr. 23472/1, datë 02.10.2015 të BKTregtare është konfirmuar garancia deri më 30.09.2016, në vlerë 31,451,043 lekë, ndërsa me shkresën nr. 40304 prot, datë 29.09.2017 Banka Kombëtare Tregtare ka konfirmuar garancinë e kërkuar nga subjekti “Air B.P.Albania” në vlerë 31,451,043 lekë protokolluar në DPD me nr. 22175 prot, datë 29.09.2017, të vlefshme deri më 30.09.2018.

Mallrat që pranohen të stokohen në këtë regjim është vetëm karburanti për furnizimin e avionëve.

Nga auditimi i dosjes së operatorit ekonomik “Air B.P Albania” SHA me NIPT J92302002L, i cili operon nën regjimin e Magazinës Doganore Tipi-C u konstatua se; në dosjen e administruar nga Zyra Mbikëqyrse e Regjimeve gjenden të gjitha akt-rakordimet mujore të përgatitura nga subjekti dhe të depozituara pranë autoritetit doganor kompetent, e konkretisht; **VITI 2016**

Pasqyra nr. 1: Gjendja në fillim të periudhës, hyrjet, daljet dhe gjendja në fund të çdo tremujori

Bilanci litra në 15 gradë	Trem. I		Trem. II		Trem. III		Trem. IV		Vjetori	
	Jet A-1	Avgas	Jet A-1	Avgas	Jet A-1	Avgas	Jet A-1	Avgas	Jet A-1	Avgas
Stoku në fillim të tremuj	469,978	13,073	525,676	11,596	405,015	2,795	403,783	11,097	469,978	13,073
Hyrje në Magazinë	1,968,615	0	2,559,201	0	4,990,518	32,000	3,413,681	0	12,932,015	32,000
Sasia shitur	1,912,734	1,564	2,679,591	8,744	4,988,977	23,580	3,376,892	7,346	12,958,194	41,234
Gjendja fund të tremuj	525,859	11,608	405,015	2,852	406,556	11,215	440,572	3,751	443,799	3,839
Gjendja në fillim tremuj	525,676	11,596	405,015	2,795	403,783	11,097	437,955	3,751	437,955	3751
Diferenca	-183	-12	-271	-57	-2773	-118	-2617	0	5,844	88

Nga analiza e të dhënave të paraqitura në pasqyrën nr. 1, u konstatua se operatorit ekonomik “Air B.P Albania” SHA me NIPT J92302002L, i cili operon në regjimin e Magazinës Doganore Tipi-C për furnizimin e avionëve me karburant rezulton se; në fillim të vitit 2016 gjendja ka qenë 469,978 litra Jet A-1 dhe 13,073 litra Avgas, ka bërë hyrje gjatë vitit 12,932,015 litra Jat A-1 dhe 32,000 litra Avgas, ka shitur gjatë vitit 12,958,194 litra Jet A-1 dhe 41,234 litra Avgas dhe në fund të vitit 2016 rezulton me gjendje kontabile 443,799 litra Jet A-1 dhe 3839 litra Avgas, ndërsa gjendja fizike ka qenë 437,955 litra Jet A-1 dhe 3751 litra Avgas nga ku rezulton një diferencë prej 5,844 litra Jet A-1 dhe 88 litra Avgas.

Diferenca prej 5844 litra Jet A-1, është trajtuar me DAV Imp.4, ndërsa për diferencat e rezultuara në karburantin Avgas janë paguar detyrimet përkatëse dhe penalitetet.

Autoriteti doganor kompetent gjatë vitit 2016 me grupe pune të posaçme kanë ushtruar në ambientet e këtij operatori 3(tre) kontrolle doganore, nga të cilat një kontroll është realizuar me pjesëmarrjen e survejorit.

VITI 2017

Pasqyra nr. 2, Gjendja në fillim të tremujorit, hyrjet, daljet dhe gjendja në fund të çdo tremujori

Bilanci litra në 15 gradë	Trem. I		Trem. II		Trem. III		Trem. IV		Vjetori	
	Jet A-1	Avgas	Jet A-1	Avgas	Jet A-1	Avgas	Jet A-1	Avgas	Jet A-1	Avgas
Stoku në fillim të tremujorit	437,955	3,751	518,442	3,381	482,270	7,423	460,782	9,961	437,955	3,751



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

Hyrje në Magazinë	2,546,916	0	3,353,375	4,693	6,237,433	14,400	3,367,052	0	15,504,776	19,093
Sasia shitur	2,462,416	370	3,383,095	651	6,249,199	11,862	3,401,272	242	15,495,982	13,125
Gjendja fund të tremujorit	522,455	3,381	488,722	7,423	470,504	9,961	426,562	9,720	446,749	9,719
Gjendja fillim tremujorit	518,442	3,381	482,270	7,413	460,782	9,961	424,615	9,720	424,615	9,719
Diferenca	-4013	0	-6,452	0	-9,722	0	-1,947	0	22,134	0

Nga analiza e të dhënave të paraqitura në pasqyrën nr. 2, u konstatua se operatorit ekonomik “Air B.P Albania” SHA me NIPT J92302002L, rezulton se vitin 2017 e ka filluar me gjendje 437,955 litra Jet A-1 dhe 3,751 litra Avgas, ka bërë hyrje gjatë vitit 15,504,776 litra Jet A-1 dhe 19,093 litra Avgas, ka shitur gjatë vitit 15,495,982 litra Jet A-1 dhe 13,125 litra Avgas, në fund të vitit 2017 rezulton me gjendje kontabile 446,749 litra Jet A-1 dhe 9,719 litra Avgas, ndërsa gjendja fizike ka qenë 424,615 litra Jet A-1 dhe 9,719 litra Avgas nga ku rezulton një diferencë prej 22,134 litra Jet A-1.

Gjatë vitit 2017 është krijuar një diferencë prej 22,134 litra karburant Jet A-1, e cila deri më 30.04.2017 në sasi 5320 litra për cilat janë llogaritur detyrimet doganore dhe penalitetet përkatëse, ndërsa sasia prej 16,814 litra karburant Jet A-1 është trajtuar me 8 deklarata doganore Imp. 9, cilat janë përgatitur në zbatim të VKM nr. 434, datë 20.05.2015, “Për përcaktimin e normativave për frot, humbjet, dëmtimet dhe skarcot gjatë prodhimit, transportimit, të njohura për qëllime fiskale”, bazuar në kërkesat nr. 5294 prot, datë 01.03.2017, nr. 6766 prot, datë 17.03.2017, si dhe në zbatim të ligjit nr. 8449 datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i RSH”, i ndryshuar nenet 121-123, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me shkresën 5294/1, datë 27.04.2017 ka miratuar ndryshimin e pikës 11 (shkalla e humbjes) në autorizimit nr. 2626/10820 të Magazinës Doganore me Kod C002 të administruar nga subjekti “Air B.P Albania” SHA.

Në zbatim të udhëzimit nr. 3, datë 09.02.2016 “Për zbatimin praktik të përfitimit dhe operimit më regjimin e magazinimit doganor”, pika 5, “Detyrimet e administratorit të regjimit të magazinimit doganor”, janë plotësuar kërkesat për krijimin dhe administrimin e regjistrit ku janë regjistruar hyrjet dhe daljet e karburanteve sipas tipeve Jet A-1 dhe Avgas, janë kryer çdo nuaj inventarët fizike, janë përgatitur akt-rakordimet përkatëse të cilat janë dërguar në D.D.Rinas brenda datës 5 muajt pasardhës.

Gjatë periudhës në auditim grupet e kontrollit të miratuar me urdhër të brendshëm të autoritetit doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas kanë ushtruar 4 (katër) kontroll në ambientet e operatorit ekonomik Air B.P.Albania, nga të cilat 3 (tre) kontrole janë kryer meurvejor, nga të cilët gjatë 4 muajve të 2017 diferencat e karburanteve janë trajtuar me DAV Imp.4, ndërsa gjatë periudhës maji-dhjetor diferencat janë trajtuar në bazë të firove ligjore.

Në bazë të programit të kontrollit nr. 103, datë 11.01.2017 të miratuar nga Kryetari i Degës së Doganës, është ushtruar kontroll nga grupi i punës në ambientet e subjektit “Air B.P.Albania” SHA. Në zbatim të Urdhërit është përgatitur Raport-Kontrolli, nr. 338 prot, date 27.01.2017, nëpërmjet të cilit është kërkuar që në zbatim të nenit 261/1 të Kodit Doganor ky subjekt detyrohet të paguaj 1, 225,800 lekë detyrime dhe penalitete, të cilat janë arkëtuar.

2. Regjimi i Përpunimit Aktiv;

Në Degën e Doganës Rinas ka operuar nën Regjimin e Përpunimit Aktiv (me pezullim) subjekti “SINA” Shpk me NIPT K41712002V, bazuar në autorizimin nr. 4687/1, datë 29.02.2016 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Gjatë periudhës në auditim, subjekti ka kryer 15 importe me DAV Imp.5, dhe 10 eksporte me DAV Exp. 3. Në ambientet e subjektit janë ushtruar në vazhdimësi kontrollet periodike 3 mujore, të cilat janë dokumentuar sipas rasteve, nga të cilat nuk janë konstatuar shkelje doganore.

Subjekti “SINA” me NIPT K41712002V e ka mbyllur regjimin e përpunimit aktiv, nëpërmjet formularit Model-3 nr. 4195 prot, datë 16.12.2016 nga ku rezulton se; nga autorizimi nr.



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

3783/1, datë 17.02.2015 është transferuar në autorizimin nr. 4687/1, datë 29.02.2016 gjendja e mbetur pezull nga autorizimi i mëparshëm në peshë 78,14 kg lëndë e parë në vlerë 5154,8 euro, është importuar 212,72 kg lëndë e parë në vlerë 23702,21 euro, janë rieksporuar 290,86 kg produkte të gatshme në vlerë 28857,01 euro.

Në auditimi u konstatua se ky subjekte e ka mbyllur regjimin përpunimit aktiv në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 136-144, pa diferenca në sasi dhe në vlerë.

Nga të dhënat e paraqitura nga Zyra e Mbikëqyrjes së Regjimeve për vitin 2017 u konstatua se; nën regjimin e Përpunimit Aktiv nuk ka operuar asnjë subjekt.

3. Regjimi i Lejimit të Përkohshëm;

Në zbatim të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar nenet 157-164 u konstatua se;

Në vitin 2016;

Janë përpunuar dhe depozituar në Degën e Doganës Rinas 44 DAV-e Imp.5, për mallrat e vendosura në regjimin e lejimit të përkohshëm, nga të cilat 24 praktika doganore janë autorizuar nga D.D.Rinas me përjashtim të plotë, 9 praktika doganore janë autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me përjashtim të pjesshëm dhe 11 praktika janë të shoqëruara me ATA CARNET.

Nga auditimi dhe verifikimi i procedurave doganore të zbatuara nga autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas u konstatua se nga 44 DAV-e të administruara gjatë vitit 2016, janë mbyllur me DAV-e export 3 kthim në origjinë dhe me DAV Imp. 4 hedhje në qarkullim të lirë 40 DAV-e, janë në proces 4 DAV-e, si rezultat i shtyrjeve të afateve të përdorimit të regjimit.

Nga kontrollet e ushtruara nga autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas kanë rezultuar me shkelje të afateve kohore të regjimit të lejimit të përkohshëm subjektet “Novomat”, “Reparti Ushtarak 3001” dhe “Reparti Ushtarak 6640” të cilët janë penalizuar respektivisht në vlerë 41,603 lekë, 340,511 lekë dhe 4,535,471 lekë, në total 5,216,493 lekë, të cilat janë arkëtuar.

Në vitin 2017;

Janë përpunuar dhe depozituar në Degën e Doganës Rinas 33 DAV-e Imp.5, për mallrat e vendosura në regjimin e lejimit të përkohshëm, nga të cilat 18 praktika doganore janë autorizuar nga D.D.Rinas me përjashtim të plotë, 2 praktika doganore janë autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me përjashtim të pjesshëm dhe 13 praktika janë të shoqëruara me ATA CARNET.

Nga auditimi dhe verifikimi i procedurave doganore të zbatuara nga autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas u konstatua se nga 33 DAV-e të administruara gjatë vitit 2017, janë mbyllur me DAV-e export 3 kthim në origjinë dhe me DAV Imp. 4 hedhje në qarkullim të lirë 29 DAV-e, janë në proces 4 DAV-e, si rezultat i shtyrjeve të afateve të përdorimit të regjimit. Nga kontrollet e ushtruara nga autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas nuk kanë rezultuar shkelje të afateve kohore të regjimit të lejimit të përkohshëm nga subjektet operatore.

Në përfundim:

Nga auditimi i ushtruar në Degën e Doganës Rinas mbi zbatimin e procedurave doganore gjatë mbikëqyrjes së regjimeve ekonomike u konstatua se; regjimet e magazinave doganore “*Duty Free Shop*”, “*Air B.B Albania*” SHA, të Përpunimit Aktiv dhe të Lejimit të Përkohshëm janë bërë në përputhje të plotë me kërkesat e legjislacionit doganor, por përgatitja dhe administrimi i dokumenteve bazë nuk është bërë në përputhje me formatet e



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në të shumtën rasteve ato nuk janë të inventarizuara në zbatim të lgjit “Për Arkivat në RSH”

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 4 datë 02.03.2018 dhe për këtë çështje subjekti i audituar nuk ka paraqitur pretendime.

5. Drejtimi nr. 5 i Auditimit “Auditimi i borxhit doganor, niveli i borxhit dhe analiza e tij dhe masat e marra për zbatimin e tij”

Mbi auditimin e ushtruar në Degën e Doganës Rinas në bazë të programit të auditimit nr. 1347/1, datë 19.01.2018, mbajtur në datën 02.03.2018.

Në zbatim të pikës 5 të programit të auditimit nr. 1347/1, datë 19.01.2018, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Informacionet e paraqitur nga Zyra e Borxhit doganor, lidhur me administrimin dhe masat e marra për rikuperimin e tij, gjendja në fund të periudhës së auditimit.
2. Listat analitike e subjekteve me borxh doganor gjendje më 31.12.2015, 2016 dhe 2017, sipas viteve të krijimit.
3. Lista analitike e subjekteve debitore gjendje më 31.12.2017, pajisur me Urdhëra Ekzekutimi nga Autoriteti Gjyqësorë kompetente.
4. Disa nga shkaqet e krijimit të borxhit doganor gjatë periudhës 2016-2017.
5. Masat e marra nga autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas, për zbatimin e procedurave ligjore-administrative për rikuperimin në kohë të borxhit doganor.
6. Subjektet që kanë përfituar nga ligji nr. 33/2017, datë 30.03.2017 “Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë si dhe procedure e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit, pas shuarjes së detyrimeve tatimore”, si dhe procedurat e përcaktuara në udhëzimin e MF, nr. 14, datë 05.03.2017.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm u konstatua se:

Autoritetit doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas gjatë periudhës në auditim nuk ka zbatuar plotësisht disa nga dispozitat e ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, nenet 237, 242, 243 dhe 245, kërkesat e vendimit të KM nr. 205, datë 13.04.1999 “Për miratimin e Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar, si dhe kërkesat e udhëzimeve nr. 6, datë 23.07.2013 dhe nr. 4, datë 07.04.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave “mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës.”

Nga auditimi i ushtruar mbi dokumentet e paraqitura nga Zyra e Jurist/Borxhit doganor dhe Zyra e Financës pranë D.D.Rinas për periudhën në auditim vitet 2016-2017, lidhur me zbatimin procedurave ligjore-administrative, si dhe masat e marra për rikuperimin e borxhit doganor u konstatua se:

Në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 216-255, të kërkesave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 205, datë 13.04.1999 “Për miratimin e Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar si dhe udhëzimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, nr. 6, datë 23.07.2013 dhe nr. 4, datë 07.04. 2016, “mbi zbatimin praktik të procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor dhe të akcizës” u konstatua se;

Gjendja e borxhit doganor gjatë periudhës në auditim, vitet 2016-2017, paraqitet si më poshtë:

VITI 2016:

Pasqyra nr. 1, gjendja në fillim, shtesat, pakësimet dhe gjendja në fund të vitit 2016

Gjendja më 01.01.2015	Shtuar	Pakësuar	Gjendja më 31.12.2016
-----------------------	--------	----------	-----------------------



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

Debitorë	Vlerë	Debitorë	Vlerë	Debitorë	Vlerë	Debitorë	Vlerë
13	1,794,883	89	23,792,386	79	23,279,930	23	2,307,339

në /lekë

Nga auditimi dhe analiza e të dhënave të paraqitura si më sipër rezulton se gjendja e borxhit doganorë në fillimin të periudhës së auditimit ka qenë 13 subjekte në vlerë **1,794,883 lekë**, është shtuar gjatë vitit me 89 subjekte në vlerë **23,792,386 lekë**, është pakësuar me 79 subjekte në vlerë **23,279,930 lekë**, gjendja në fund të periudhës së audituar mbetet 23 subjekte në vlerë **2,307,339 lekë**, me rritje në vlerë **512,456 lekë**, ose në masën **28 %**.

VITI 2017:

Pasqyra nr. 2, gjendja në fillim, shtesat, pakësimet dhe gjendja në fund të vitit 2017.
në /lekë

Gjendja më 01.01.2016		Shtuar		Pakësuar		Gjendja më 31.12.2017	
Debitorë	Vlerë	Debitorë	Vlerë	Debitorë	Vlerë	Debitorë	Vlerë
23	2,307,339	61	5,341,179	63	5,461,859	21	2,186,659

Nga auditimi dhe analiza e të dhënave të paraqitura si më sipër rezulton se gjendja e borxhit doganorë në fillimin të periudhës së auditimit ka qenë 23 subjekte në vlerë **2,307,339 lekë**, është shtuar gjatë vitit me 61 subjekte në vlerë **5,341,179 lekë**, është pakësuar me 63 subjekte në vlerë **5,461,859 lekë**, gjendja në fund të periudhës së audituar mbetet 21 subjekte në vlerë **2,186,659 lekë**, me ulje në vlerë **120,680**, ose në masën **5%**.

Në përfundim të auditimit të masave të marra për rikuperimin e borxhit doganor gjatë periudhës së audituar u konstatua se;

Pasqyra nr. 3 Gjendja dhe lëvizjet e borxhit doganor gjatë periudhës janar 2016-dhjetor 2017.

VITET	Gjendja në fillim		Shtuar		Pakësuar		Gjendja në fund	
	Debitorë	Vlerë	Debitorë	Vlerë	Debitorë	Vlerë	Debitorë	Vlerë
2016	13	1,794,883	89	23,792,386	79	23,279,930	23	2,307,339
2017	23	2,307,339	61	5,341,179	63	5,461,859	21	2,186,659
Totali	-	-	-	29,133,565	-	28,741,789	21	2,186,659

Nga auditimi dhe analiza e të dhënave të mësipërme konstatohet se borxhi doganor për të gjithë periudhën e audituar është shtuar në vlerë **29,133,565 lekë** dhe është pakësuar në vlerë **28,741,789 lekë**, me një ulje në vlerë **391,776 lekë**. Rritjen më të madhe gjatë viteve në auditim borxhi doganor e ka pësuar gjatë vitit 2016 në vlerë 23,792,386 lekë, po kështu është arritur dhe arkëtimi më i madh për të gjithë periudhën e audituar në vlerë 23,279,930 lekë.

Gjendja e borxhit doganor më 31.12.2017, mbas verifikimit dhe krahasimit të të dhënave me gjendjen e kontabilitetit që administron Zyra e Financës pranë Degës së Doganës Rinas, u konstatua se ato janë të përputhura dhe pa diferenca.

Lista e subjekteve që rezultojnë me barxhë doganorë të papaguar më 31.12..2017 në vlerë **2,186,659 lekë**, përbëhet nga **21 subjekte debitorë**, të cilat janë krijuar sipas viteve;

Pasqyra nr. 4

Gjendja e borxhit doganorë më 31.12.2017.

Vitet	Subjekte	Shuma (leke)
2014	2	1.184,938
2015	2	68,784
2016	6	566,243
2017	11	366,694
Totali	21	2,186,659

Nga analiza e të dhënave të paraqitura si më sipër rezulton se gjendja e borxhit doganor më 31.12.2017, përbëhet nga 21 subjekte të cilët e kanë fillimin e tyre në vitin 2014 e deri në vitin 2017, me një shtrirje prej 4 vitesh ku borxhi i krijuar është mbartur vit pas viti.

Nga të dhënat e paraqitura konstatohet se nga 21 subjekte të konstatuara me borxhë doganor, 2 subjekte në vlerë **1,184,938 lekë** i përkasin vitit 2014, ose sa 54 % e borxhit gjendje.



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

Nga auditimi dhe analiza e gjendjes së borxhit doganor të krijuar nga viti 2014 e deri më 31.12.2017, u konstatua se masat e marra nga autoriteti doganor kompetent, D.D.Rinas gjatë viteve nuk kanë qenë të plota sepse rikuperimi i borxhit doganorë nuk është mbështetur me programe pune vjetore dhe të përditësuara, por rikuperimi i tij është bërë vetëm nëpërmjet një pune të rutinë, të kryer nga Zyra e Borxhit Doganor.

Pasqyra nr. 5: Subjektet debitore me borxhin më të madh në strukture, gjendje më 31.12.2017.

Nr	Subjektet	Vendimi		Gjendja borxhit 30.09.17				Gjendje 31.12.2017
		Nr.	Datë	Detyrime	Gjoha	K.Vonse	Shuma paguar	
1	Alb Pipe	7	27.01.2015	322,844	645,688	173,061	-	1,141,593
2	Prosound	74	30.11.2016	657,538	657,538	24,195	920,553	418,718
3	TNT Ekspres	86	07.12.2016	43,831	43,831	5,274	-	92,936
4	DHL Internacional	58	30.11.2017	25,920	25,920	-	25,920	25,920
5	DHL Internacional	59	30.11.2017	-	57,000	-	-	57,000
6	Ildrag	68	14.12.2017	20,990	-	-	-	20,990
7	Rezart Deniri	72	18.12.2017	20,574	-	-	-	20,574
8	DHL Internacional	75	27.12.2017	-	35,000	-	-	35,000
9	DHL Internacional	77	29.12.2017	-	31,000	-	-	31,000
	Totali	-	-	1,091,697	1,495,977	202,530	946,473	1,843,731

Nga auditimi dhe analiza e borxhit doganorgjendje më 31.12.2017 në vlerë **2,186,659 lekë** u konstatua se; **5** subjekte përfaqësojnë një borxh doganor në vlerë **1,843,731 lekë**, ose në masën **84 %**.

II. Disa nga shkaqet më kryesore që kanë ndikuar në krijimin e borxhit doganor gjatë periudhës në auditim.

- mos zbatimi nga autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas i dispozitave të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1997, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”,
- mos përcaktimi i saktë i vlerës së mallrave për qëllime doganore,
- mos përcaktimi i saktë origjinës së mallrave dhe origjinës preferenciale,
- mos zbatimi i dispozitave të Kodit Doganor lidhur me regjimet ekonomike,
- mos zbatimi i Kodit Tarifor të Nomenklaturës së Kombinuar lidhur me Klasifikimin Tarifor të Mallrave,
- mos zbatimi i procedurave ligjore, gjatë aplikimit të Skemës së Shtyrjes së Pagesës së TVSH-së, etj.

III-Masat e marra për rikuperimin e borxhit doganor, gjatë periudhës në auditim.

Zyra e Borxhit; në vazhdimësi e në mënyrë sistematike ka informuar Kryetarin e Degës së Doganës Rinas, për shkaqet dhe arsyet e shtimit apo të mos arkëtimit të borxhit doganor nga subjekte të ndryshme e deri tek marrja e masave për nxjerrjen e vendimeve për rikuperimin me forcë të këtij borxhi duke zbatuar të gjitha hapat ligjore të përcaktuar nga legjislacioni doganor në fuqi.

Zyra e Borxhit Doganor, pranë D.D.Rinas, ka marrë masa të plota administrative-ligjore për rikuperimin e borxhit doganorë nëpërmjet zbatimit të dispozitave të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, nenet 216-255.

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas rikuperimin e borxhit doganor e ka kërkuar nëpërmjet vënies në ekzekutim të detyrueshëm të Urdhërave të Ekzekutimit të nxjerra nga Autoriteti Gjyqësorë kompetent në të gjitha rastet që ajo ka paraqitur kërkesë, për vitet 2015,2016 dhe 2017 janë nxjerr 8 urdhëra ekzekutimi, nga 21 subjekte debitorë.

Mbas mbështetjes së titujve ekzekutiv të nxjerra nga D.D.Rinas nga Autoriteti Gjyqësorë kompetent me Urdhëra Ekzekutimi, ajo ka kërkuar menjëherë bashkëpunim ndër institucional me të gjitha strukturat shtetërore që janë ngarkuar nga ligja për rikuperimin e borxhit.

Të gjitha subjektet me të cilët ka bashkëpunuar Zyra e Borxhit doganor nëpërmjet praktikave shpresore kanë reaguar në mënyrë ligjore dhe kanë treguar interes për bashkëpunimin e krijuar duke marrë pjesë aktive lidhur me rikuperimin e borxhit doganor.



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

Veprimet e kryera nga Zyra e Borxhit janë të dokumentuara me njoftime dhe lajmërimë marrje njoftimi nga subjektet debitorë.

IV. Gjendja e Borxhit Doganor,

Gjendja e regjistrit të borxhit doganor të administruar nga Dega e Doganës Rinas gjatë vitit 2017 përbëhet nga **21** subjekte në vlerë **2,784,112 lekë**, cila në strukturë përbëhet nga **1,152,181 lekë** detyrime doganore, **1,411,323 lekë** gjoba të zbatuara dhe **220,608 lekë** vonesa të llogaritura, nga të cilat janë arkëtuar **964,147 lekë** dhe gjendja në fund të vitit 2017 ka mbetur me **21 subjektet në vlerë 2,186,659 lekë**.

Nga auditimi dhe analiza mbi gjendjen në strukturë të borxhit doganor të disa subjekteve doganore të përzgjedhura në bazë të vlerës më të madhe, gjendje më 31.12.2017 u konstatua se; nisur nga detyrimi ligjor për auditimin e rikuperimit të borxhit doganor dhe të akcizës, mbështetur në ligjin nr. 8449, datë 27.11.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, V.K.M nr. 205, datë 13.04.1999 “Për miratimin e Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor”, si dhe në udhëzimin nr. 4, datë 07.04.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, si dhe në zbatim të Planit të Veprimit “Së bashku kundër informalitetit” të miratuar nga Ministria e Financave, Urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 40, datë 30.09.2017 “Për zbatimin e planit të veprimit kundër informalitetit”, autoriteti doganor kompetent Dega e Doganës Rinas ka marrë të plota ligjore e administrative për rikuperimin e borxhit doganor, ku mund të cilësojmë subjektet si më poshtë :

1-Subjekti “Alb-Pipe” me NIPT K62902802G rezulton me gjendje debitore në vlerë 1,141,593 lekë që nga vitit 2014, i cila përbëhet nga 322,844 lekë detyrime doganore, 645,688 lekë penalitete të zbatuara dhe 173,061 lekë kamat vonesa të llogaritura. Në totalin e borxhit gjendje ky subjekt zë **52, 2 % të borxhit**.

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas ka marrë të gjitha hapat ligjore-administrative duke bashkëpunuar ngushtësisht me të gjitha strukturat ligjzbatuese, por deri në këto moment subjekti nuk është përgjigjur mbasi në llogaritë e tija bankare, apo në formën e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme megjithë kontrollet e kryera deri në këto moment nuk janë konstatuar. Subjekti nuk kryen asnjë veprimtari ekonomike tregtare, në këto kushte ai mund të konsiderohet borxh i keq.

2-Subjekti “Prosound” me NIPT K623200120 rezulton me gjendje debitore në vlerë 1,339,271 lekë nga vitit 2016, e cila përbëhet nga 657,538 lekë detyrime doganore, 657,538 lekë penalitete të zbatuara dhe 24,195 lekë kamat vonesa të llogaritura. Janë arkëtuar gjatë vitit 920,553 lekë. Në totalin e borxhit gjendje ky subjekt zë **19 % të borxhit**.

3-Subjekti “TNT Ekspres” me NIPT K61704020E rezulton me gjendje debitore në vlerë 92,936 lekë, që nga viti 2016, e cila përbëhet nga 43,831 lekë detyrime doganore, 43,831 lekë penalitete të zbatuara dhe 5,274 lekë kamat vonesa të llogaritura. Në totalin e borxhit gjendje ky subjekt zë **4, 3 % të borxhit**.

4-Subjekti “DHLInternacional” me NIPT J61820040I rezulton me gjendje debitore në vlerë 174,840 lekë, krijuar gjatë vitit 2017, e cila përbëhet nga 25,920 lekë detyrime doganore dhe 148,920 lekë penalitete të zbatuara. Janë arkëtuar 25,920 lekë detyrime. Në totalin e borxhit gjendje ky subjekt zë **6, 8 % të borxhit**.

5-Subjekti “Air BP Albania” me NIPT J92302002L rezulton me gjendje debitore në vlerë 95,326 lekë, krijuar në vitin 2017, cila përbëhet nga 94,566 lekë penalitetetë zbatuara dhe 760 lekë kamat vonesa të llogaritura . Në totalin e borxhit gjendje ky subjekt zë **4, 4 % të borxhit**.

V. Mbi Zbatimin e ligjit të faljes nr. 33/2017.



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

Në zbatim të ligjit të faljes nr. 33/2017 “Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore”, autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas ka analizuar rast pas rasti subjektet debitorë që mund të përfitonin nga zbatimi i ligjit, nga ku ka rezultuar se;

Për sa i përket zbatimit të ligjit të faljeve, Dega e Doganës Rinas nga analiza dhe verifikimi i dokumentacionit të administruar ka konstatuar se vetëm një subjekt ka përfituar nga ky ligj, e konkretisht subjekti “Photo Play & Game” me NIPT L11613006H, i penalizuar me vendimin nr. 3177 datë 30.08.2012 me gjobë në vlerë 50,000 lekë.

Vendimi i faljes është me nr. 27 datë 19.05.2017 sipas të cilit është falur borxhi i këtij subjekti në vlerë 50,000 lekë në zbatim të udhëzimit nr. 14 datë 03.05.2017, i Ministrisë së Financave, pjesa X, pika 1, d dhe pika 1/2 e këtij udhëzimi.

Në përfundim.

Nga auditimi i ushtruar mbi të dhënat e paraqitura nga Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas u konstatua se Borxhit Doganor gjatë periudhës në auditim ka pësuar shtesa dhe pakësime të rëndësishme të cilat nuk kanë ndikuar rritjen e borxhit, i cili më datën 31.12.2017 ka arritur në vlerë 2,186,659 lekë.

Për sa më lart mbajtur akt-konstatimi nr. 6 datë 02.03.2017

Gjetje dhe Rekomandime

Pika 5 e Drejtimit të Auditimit “Auditimi i borxhit doganor, niveli i borxhit dhe analiza e tij dhe masat e marra për zbatimin e tij”

Titulli i Gjetjes 1 **Mbi gjetjet dhe rekomandimet që lidhen me veprimtarinë e Degës Doganore Rinas gjatë mbledhjes dhe arkëtimit të borxhit doganor.**

Situata: Nga auditimi dhe analiza e borxhit doganor gjëndje deri më datë 31.12.2017, i krijuar gjatë viteve deri në periudhën e fundvitit 2017 u konstatua se nga autoriteti doganor kompetent Dega e Doganës Rinas nuk janë arritur të zbatohen plotësisht afatet ligjore të përcaktuara për rikuperimin e borxhit doganor, duke reflektuar një gjëndje borxhi doganor në fund të periudhës së audituar në vlerën 2,186,659 mijë lekë

Kriteri : Ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 4, datë 07.04.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës

Ndikimi/Efekti Konstatohet një gjëndje borxhi doganor në fund të periudhës së audituar në vlerën 2,186,659 mijë lekë.

Rëndësia I lartë

Rekomandimi Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas të marrë masa të plota ligjore e administrative, për rikuperimin ose shuarjen e borxhit doganor të krijuar gjatë viteve 2009 deri në periudhën 31.12.2017 në vlerën 2,186,659 mijë lekë, si dhe të hartojë një program konkret me



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

persona përgjegjës me afate kohore konkrete rikuperimi duke bashkëpunuar intensivisht me të gjitha institucionet e ngarkuara sipas ligjit për rikuperimin e borxhit si mësipërm bazuar nëligjin nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 4, datë 07.04.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës

Menjëherë

6. Drejtimi nr. 6 i Auditimit “Auditimi i procedurave mbi vendimet administrative të nxjerra nga Autoriteti Doganor Kompetent”.

Objekt i këtij akt konstatimi është auditimi i procedurave administrative të ndjekura nga Autoriteti Doganor Rinas gjatë marrjes së vendimeve administrative **për periudhën 01.01.2016 deri në periudhën 30.06.2016.**

Në zbatim të pikës nr. 6 të Programit të Auditimit ***nr. 1347/1 prot, datë 19.01.2018***, u konsiderua si e nevojshme mbajtja e një akt konstatimi, në ambientet e Degës Doganore Rinas, nga audituesit e KLSH-së znj. Elida Koçani dhe z. Altin Dinaj, për të cilat u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Vendimet administrative të nxjerra nga Dega Doganore Rinas.
2. Procesverbal konstatimi i shkeljes doganore.

Nga verifikimi rezultoi që: Dega Doganore Rinas gjatë periudhës 01.01.2016 deri në periudhën 30.06.2016 **ka nxjerrë 30** vendime administrative për shkelje doganore me karakter të ndryshëm për shkelje të ligjit nr. 8449 datë. 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr. 61 datë 25.08.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr. 205 datë 13.04.1999 për “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar, VKM nr. 612 datë 05.09.2012 “Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit për Akcizat”, i ndryshuar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që :

♦. ***Dega Doganore Rinas me Vendimin Administrativ Nr. 4, protokolluar me nr. 324 prot, datë 29.01.2016*** ka vendosur ndëshkimi i subjektit “***Reparti Ushtarak me nr. 6640” me NIPT K51724025E*** me gjobë në shumën 103,673 lekë. Ky subjekt është pajisur nga DPD me autorizim nr. 30133/1 prot, datë 17.12.2014 “, për RLP me afat 12 muaj, për mallin “Pajisje telefonike” të dërguara nga NATO me vlerë 3 700 euro. Nga ana e subjektit, në bazë të autorizimit në fjalë, është bërë deklarata IM 5, nr. R-28020, dt 30.12.2014 pranë D.D.Rinas , me vlerë statistikore 518,370 leke dhe detyrim doganor 103,673 lekë. Nga ana e grupit të Sektorit të Cargo është konstatuar se nga subjekti është tejkualuar afati i parashikuar në autorizimin nr. 30133/1, dt 12.12.2014. Për këtë shkelje është mbajtur proces verbali datë 05.06.2016, në cilin është propozuar gjobë në shumën 103,673 lekë, bazuar në nenin 273/1/2 të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”

Nga autoriteti doganor nuk është kërkuar dhënia e destinacionit të ri doganor sipas përkufizimeve të Kodit Doganor si më poshtë për subjektin në shkelje të afateve autorizuese sipas rregjimit të lejimit të përkohshëm të përfutur pranë Degës Doganore Rinas.

Neni 157 KD i Kodit Doganor përcakton se:

“Regjimi i lejimit të përkohshëm bën të mundur përdorimin në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet e importit dhe pa iu nënshtruar masave të politikave tregtare, të mallrave jo shqiptare të destinuara për t'u riekportuar, pa pësuar ndryshime, përveç zhvlefësimit normal për shkak të përdorimit të tyre.”

Neni 160 Pika 1 i Kodit Doganor përcakton se:



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

“Autoritetet doganore përcaktojnë afatin brenda të cilit mallrat e importit duhet të rieksporthen ose t'u caktohet një destinacion i ri doganor dhe ky afat duhet të zgjasë për aq kohë sa të arrihet qëllimi për të cilin është lëshuar autorizimi”.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Dega Doganore Rinas të vlerësojë situatën doganore të konstatuar sa më sipër në funksion të afateve autorizuese të lejuara të dhëna në ngarkim të subjektit “Reparti Ushtarak nr. 6640” me NIPT K51724025E, me qëllim dhënien destinacionit përfundimtar doganor të mallit të autorizuar sa më sipër, me një detyrim doganor statistikor në shumën 103 673 lekë sipas të dhënave të deklaratës doganore IM 5 R-28020, dt 30.12.2014 **sipas nenit 160 të KD**. Gjithashtu të ndiqet nga nëpunësi doganor mbikëqyrës i autorizimit doganor të regjimit të lejimit të përkohshëm dhënia dhe ndjekja përfundimtare e destinacionit doganor të mallrave të përfshira në autorizimin e mësipërm me qëllim mbylljen ose shtyrjen e procedurës doganore të autorizimit në mbikëqyrje nga D.D.Rinas.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Ligjin nr. 8449 datë. 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Luan Hysa me detyrë ish kryetar në D.D Rinas

3. Kushtrim Elezaj me detyrë specialist/jurist në D.D Rinas.

2. Fatbardh Luzati me detyrë Doganier në sektorin Cargo/Rregjime në D.D Rinas.

♦ ***Dega Doganore Rinas me Vendimin Administrativ Nr. 8, protokolluar me nr. 586 prot, datë 22.02.2016*** ka vendosur ndëshkimi i subjektit ***“Reparti Ushtarak me nr. 6640” me NIPT K51724025E*** me gjobë në shumën 4,389,459 lekë. Ky subjekt është pajisur nga kjo drejtori me autorizim nr. 3098 prot, datë 07.08.2013, për RLP me afat 12 muaj, për mallin “Pajisje kompjuterike” të dërguara nga NATO me vlerë 136,675.18 pound/stërlina. Nga ana e subjektit, në bazë të autorizimin në fjalë, është bërë deklarata IM 5, nr. R-15424, dt 07.08.2013 pranë D.D.Rinas, me vlerë statistikore 21,947,300 leke dhe detyrim doganor 4,389,459 lekë. Nga ana e grupit të Sektorit të Cargo është konstatuar se nga subjekti është tejkaluar afati i parashikuar në autorizimin nr. 30133/1, dt 12.12.2014. Për këtë shkelje është mbajtur proces verbali datë 05.06.2016, në cilin është propozuar gjobë në shumën 4,389,459 lekë, bazuar në nenin 273/1/2 të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Për Kodin Doganor të RSH”.

Nga autoriteti doganor nuk është kërkuar dhënia e destinacionit të ri doganor sipas përkufizimeve të Kodit Doganor si më poshtë për subjektin në shkelje të afateve autorizuese sipas rregjimit të lejimit të përkohshëm të përfituar pranë Degës Doganore Rinas.

Neni 157 Kodit Doganor përcakton se:

“Regjimi i lejimit të përkohshëm bën të mundur përdorimin në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet e importit dhe pa iu nënshtruar masave të politikave tregtare, të mallrave jo shqiptare të destinuara për t'u rieksportuar, pa pësuar ndryshime, përveç zhvleftësimit normal për shkak të përdorimit të tyre”

Neni 160 Pika 1 Kodi Doganor përcakton se:

“Autoritetet doganore përcaktojnë afatin brenda të cilit mallrat e importit duhet të rieksporthen ose t'u caktohet një destinacion i ri doganor dhe ky afat duhet të zgjasë për aq kohë sa të arrihet qëllimi për të cilin është lëshuar autorizimi”.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Dega Doganore Rinas të vlerësojë situatën doganore të konstatuar sa më sipër në funksion të afateve autorizuese të lejuara të dhëna në ngarkim të subjektit “Reparti Ushtarak nr. 6640” me NIPT K51724025E, me qëllim dhënien destinacionit përfundimtar doganor të mallit të autorizuar sa më sipër, me një detyrim doganor statistikor në shumën 4,389,459 lekë sipas të dhënave të deklaratës doganore R-15424, dt 07.08.2013 pranë D.D.Rinas **sipas nenit 160 të**



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

KD. Gjithashtu të ndiqet nga nëpunësi doganor mbikëqyrës i autorizimit doganor të regjimit të lejimit të përkohshëm dhënia dhe ndjekja përfundimtare e destinacionit doganor të mallrave të përfshira në autorizimin e mësipërm me qëllim mbylljen ose shtyrjen e procedurës doganore të autorizimit në mbikëqyrje nga D.D.Rinas

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Ligjin nr. 8449 datë. 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Luan Hysa me detyrë ish kryetar në D.D Rinas

3. Kushtrim Elezaj me detyrë specialist/jurist në D.D Rinas.

2. Fatbardh Luzati me detyrë Doganier në sektorin Cargo/Rregjime në D.D Rinas.

♦ **Dega Doganore Rinas me Vendimin Administrativ Nr. 9, protokolluar me nr. 587 prot, datë 22.02.2016** ka vendosur ndëshkimi i subjektit **“Reparti Ushtarak me nr. 6640” me NIPT K51724025E**, me gjobë në shumën 42,339 lekë. Ky subjekt është pajisur nga kjo drejtori me autorizim nr. 3099 prot, datë 07.08.2013 për RLP me afat 12 muaj, për mallin “Pajisje telekomunikacioni” të dërguara nga NATO me vlerë 1,510 euro. Nga ana e subjektit, në bazë të autorizimin në fjalë, është bërë deklarata IM 5, nr. R-15423, dt 07.08.2013 pranë D.D.Rinas, me vlerë statistikore 211,702 leke dhe detyrim doganor në shumën 42,339 lekë. Nga ana e grupit të Sektorit të Cargo është konstatuar se nga subjekti është tejkaluar afati i parashikuar në autorizimin nr. 3099, dt 07.08.2013. Për këtë shkelje është mbajtur proces verbali datë 04.02.2016, në cilin është propozuar gjobë në shumën 42,339 lekë, bazuar në nenin 273/1/2 të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 **“Për Kodin Doganor të RSH”**.

Nga autoriteti doganor nuk është kërkuar dhënia e destinacionit të ri doganor sipas përkufizimeve të Kodit Doganor si më poshtë për subjektin në shkelje të afateve autorizuese sipas rregjimit të lejimit të përkohshëm të përfituar pranë Degës Doganore Rinas.

Neni 157 Kodit Doganor përcakton se:

“Regjimi i lejimit të përkohshëm bën të mundur përdorimin në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet e importit dhe pa iu nënshtruar masave të politikave tregtare, të mallrave jo shqiptare të destinuara për t'u rieksportuar, pa pësuar ndryshime, përveç zhvleftësimit normal për shkak të përdorimit të tyre.”

Neni 160 Pika 1 Kodi Doganor përcakton se:

“Autoritetet doganore përcaktojnë afatin brenda të cilit mallrat e importit duhet të rieksporthen ose t'u caktohet një destinacion i ri doganor dhe ky afat duhet të zgjasë për aq kohë sa të arrihet qëllimi për të cilin është lëshuar autorizimi”.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Dega Doganore Rinas të vlerësojë situatën doganore të konstatuar sa më sipër në funksion të afateve autorizuese të lejuara të dhëna në ngarkim të subjektit **“Reparti Ushtarak nr. 6640”** me NIPT K51724025E, me qëllim dhënien destinacionit përfundimtar doganor të mallit të autorizuar sa më sipër, me një detyrim doganor statistikor në shumën 42,339 lekë sipas të dhënave të deklaratës doganore R-15424, dt 07.08.2013 pranë D.D.Rinas **sipas nenit 160 të KD.** Gjithashtu të ndiqet nga nëpunësi doganor mbikëqyrës i autorizimit doganor të regjimit të lejimit të përkohshëm dhënia dhe ndjekja përfundimtare e destinacionit doganor të mallrave të përfshira në autorizimin e mësipërm me qëllim mbylljen ose shtyrjen e procedurës doganore të autorizimit në mbikëqyrje nga D.D.Rinas

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Ligjin nr. 8449 datë. 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Luan Hysa me detyrë ish kryetar në D.D Rinas.

3. Kushtrim Elezaj me detyrë specialist/jurist në D.D Rinas.

2. Fatbardh Luzati me detyrë Doganier në sektorin Cargo/Rregjime në D.D Rinas.



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

◆ *Dega Doganore Rinas me Vendimin Administrativ Nr. 26, protokolluar me nr. 1624 prot, datë 24.05.2016* ka vendosur ndëshkimin e subjektit “*Reparti Ushtarak me nr. 3001*” me NIPT K51723037A, me gjobë në shumën **336,647 lekë**. Ky subjekt është pajisur nga DPD me autorizim nr. 9594/1 prot, datë 18.04.2014 për RLP me afat 12 muaj,afat i shtyre edhe për 12 muaj nga DPD me shkresën e saj nr. 11294/1, dt 03.06.2015 për mallin “Pajisje kompjuterike” të dërguara nga NATO me vlerë 12,000 euro. Nga ana e subjektit, në bazë të autorizimin në fjalë, është bërë deklarata IM 5, nr. R-8144, dt 22.04.2014 pranë D.D.Rinas , me vlerë statistikore 1,683,240 leke dhe detyrim doganor ne shumën 336,647 lekë. Nga ana e grupit të Sektorit të Cargo është konstatuar se nga subjekti është tejkaluar afati i parashikuar në autorizimin nr. 9594/1, dt 14.08.2014 shtyre me shkresën nr. 11294/1, dt 03.06.2015 Për këtë shkelje është mbajtur proces verbali datë 10.05.2016, në cilin është propozuar gjobë në shumën 252,485 lekë,bazuar ne nenin 273/1/2 të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Për Kodin Doganor të RSH ”.

Nga autoriteti doganor nuk është kërkuar dhënia e destinacionit të ri doganor sipas përkufizimeve të Kodit Doganor si më poshtë për subjektin në shkelje të afateve autorizuese sipas rregjimit të lejimit të përkohshëm të përfituar pranë Degës Doganore Rinas.

Neni 157 Kodit Doganor përcakton se:

“Regjimi i lejimit te përkohshëm bën të mundur përdorimin në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet e importit dhe pa iu nënshtruar masave të politikave tregtare, të mallrave jo shqiptare të destinuara për t'u rieksportuar, pa pësuar ndryshime, përveç zhvleftësimit normal për shkak te përdorimit te tyre.”

Neni 160 Pika 1 Kodi Doganor përcakton se:

“Autoritetet doganore përcaktojnë afatin brenda të cilit mallrat e importit duhet të rieksporthen ose t'u caktohet një destinacion i ri doganor dhe ky afat duhet të zgjasë për aq kohë sa të arrihet qëllimi për të cilin është lëshuar autorizimi”.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Dega Doganore Rinas të vlerësojë situatën doganore të konstatuar sa më sipër në funksion të afateve autorizuese të lejuara të dhëna në ngarkim të subjektit “*Reparti Ushtarak me nr. 3001*” me NIPT K51723037A,me qëllim dhënien destinacionit përfundimtar doganor të mallit të autorizuar sa më sipër, me një detyrim doganor statistikor ne shumën 336,647 lekë sipas të dhënave të deklaratës doganore R-15424, dt 07.08.2013 pranë D.D.Rinas **sipas nenit 160 të KD**. Gjithashtu të ndiqet nga nëpunësi doganor mbikëqyrës i autorizimit doganor të regjimit të lejimit të përkohshëm dhënia dhe ndjekja përfundimtare e destinacionit doganor të mallrave të përfshira në autorizimin e mësipërm me qëllim mbylljen ose shtyrjen e procedurës doganore të autorizimit në mbikëqyrje nga D.D.Rinas

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në: Ligjin nr. 8449 datë. 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Luan Hysa me detyrë ish kryetar në D.D Rinas

3. Kushtrim Elezaj me detyrë specialist/jurist në D.D Rinas.

2. Fatbardh Luzati me detyrë Doganier në sektorin Cargo/Rregjime në D.D Rinas.

Auditimi i procedurave administrative të ndjekura nga Autoriteti Doganor Rinas gjatë marrjes së Vendimeve Administrative për periudhën 01.07.2016 deri në periudhën 31.12.2017.

Nga verifikimi rezultoi që: Dega Doganore Rinas gjatë periudhës 01.07.2016 deri në periudhën 31.12.2017 ka nxjerrë vendime administrative për shkelje doganore me karakter të ndryshëm për shkelje të ligjit nr. 8449 datë. 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr. 61 datë 25.08.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr. 205 datë 13.04.1999 për “Dispozitat Zbatuese të Kodit



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

Doganor” i ndryshuar, VKM nr. 612 datë 05.09.2012 “Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit për Akcizat” i ndryshuar. Gjatë auditimitu shqyrtua dokumentacioni ligjor i dosjeve të Vendimeve Administrative i shoqëruar me praktikat doganore bashkangjitur këtyre akteve.

Nga auditimi u konstatua se :

◆.Nga ana e Degës Doganore Rinas është nxjerrë vendimi administrativ nr. 31 sipas shkresës nr. 2129 prot datë 08.07.2016 në ngarkim të subjektit “**AIR BP ALBANIA**” SHA i pajisur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me Autorizim për administrimin e një magazine doganore të Tipit C me Nr. 2626/10280 datë 21.09.2006 dhe me ndryshime autorizimi sipas shkresës nr. 1674 prot datë 27.05.2016 me aktivitet “*Import, magazinim dhe rieksport për karburant avionesh Jet-1 dhe Avgaz*”. Bazuar në proces-verbalet nr. 1990 dhe nr. 1990/1 prot datë 28.06.2016 ka rezultuar një diferencë karburanti Jet-1 **në sasinë 1310 litra**. Konstatohet se ky subjekt ka kryer shkelje doganore të përsëritura shprehur (**Vendimin nr. 6 datë 15.12.2016 me këtë natyrë shkeljeje**) dhe bazuar në nenet 256/2/4 dhe 265 të Kodit Doganor është penalizuar nga Dega Doganore Rinas me njëfishin e detyrimit doganor të papaguar. Konstatohet se shkelja doganore e dokumentuar në proces-verbalin nr. nr. 1990 dhe nr. 1990/1 prot datë 28.06.2016 është shkelje doganore **e përsëritur**.

Neni 265 i Kodit Doganor.

“Pa rënë ndesh me dispozitat mbi kontrabandën, përbën kundërvajtje administrative doganore, deklarimi dhe/ose regjistrimi i një cilësie ose sasi mallrash të magazinuara në një magazinë doganore, të ndryshme nga ajo që konstatojnë autoritetet doganore” dhe sipas pikës 2 të nenit 265 të Kodit Doganor “Administruesi i magazinës ose depozituesi, kur magazinimi është nën përgjegjësinë e këtij të fundit, ndëshkohet me një gjobë nga një deri në trefishin e shumës që duhen paguar për mallrat me cilësi ose sasi të ndryshme”

Neni 287 i Kodit Doganor.

“Kur në bazë të dispozitave të këtij Kodi, zbatimi i gjobës parashikon një minimum dhe një maksimum për të përcaktuar shumën e saj, duhet të merren parasysh faktorët e mëposhtëm.....numrin e të akuzuarve etj”

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Dega Doganore Rinas të vlerësojë situatën doganore të konstatuar sa më sipër në funksion të afateve autorizuese të lejuara të dhëna në ngarkim të subjektit “**AIR BP ALBANIA**” SHA me NIPT J9223002L me qëllim riklasifikimin e shkeljes doganore të shkeljes doganore administrative në referim të nenit 256, 265 dhe 287 të ligjit nr. 8449 datë. 27.01.1999 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit doganor në formën e gjobës doganore në **shumën 119,986 lekë** (logaritur më parë shuma prej 59,593 lekë).

Në përmbushje të nenit 216 pika 1 dhe 2 të Kodit Doganor, “*Lindja e Borxhit Doganor*”, pika 122.a.ç “*Deklarata Doganore me shkrim*”, sipas VKM nr. 205 datë 13.04.1999, “*Mbi Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor*” i ndryshuar, deklaruesi i mallit ose përfaqësuesi i tij i drejtpërdrejtë janë persona debitorë për shkeljen doganore të konstatuar sa më sipër.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në: ligjin nr. 8449 datë. 27.01.1999 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Luan Hysa me detyrë ish kryetar në D.D.Rinas aktualisht në cilësinë e Kryetarit të DD Fier.

2. Kushtrim Elezaj me detyrë specialist/jurist pranë DD Rinas.

◆.Nga ana e Degës Doganore Rinas është nxjerrë vendimi administrativ nr. 63 sipas shkresës nr. 4024 prot datë 07.012.2016 në ngarkim të subjektit “**TTA ALBA-LAM**” me NIPT J62110001L. Konstatohet se subjekti “**TTA ALBA-LAM**” për mallrat e deklaruar “**llamba dhe pjesë**” me kod tarifar 85049900 me vlerë 4956 Euro. Nga grupi i sektorit Cargo/Rregjime



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

është mbajtur procesverbali nr. 2304 prot datë 28.07.2016 sipas të cilit është propozuar vjelja e detyrimit doganor në shumën 79,952 lekë dhe një gjobë administrative në shumën 50,000 lekë. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka ardhur përgjigja nga Autoritetet Doganore Belge ku bëhet me dije se: Mallrat e mbuluara nga kjo deklaratë faturë nr. 150403 datë 25.11.2014 nuk i plotësojnë kushtet preferenciale sepse eksportuesi nuk paraqiti prova justifikuese dhe këto mallra nuk kualifikohen për trajtim tarifor preferencial. Konstatohet se nga ana e operatorit ekonomik “**TTA-ALBA-LAM**” me NIPT J62110001L është kryer kundërvajtje administrative bazuar në nenin 256 dhe 261 të Kodit Doganor.

Neni 261 i Kodit Doganor.

“Pa rënë ndesh me dispozitat mbi kontrabandën, përbën kundërvajtje administrative doganore deklarimi i një cilësie, sasi, vlere ose origjine të ndryshme nga ajo që konstatojnë autoritetet doganore, në çastin kur deklaruesi paraqet deklaratën për vendosjen e mallrave në qarkullim të lirë. Ne rastet e diferencave në sasi, përveç gjobës behet edhe konfiskimi i mallrave të padeklaruara dhe të gjetura në tepricë. 2. Në rastet kur pas rishikimit të deklaratës rezulton që detyrimet doganore që duhen paguar janë më të larta se ato të llogaritura në bazë të deklaratës dhe diferenca e këtyre është më e madhe sesa 5 për qind, në vend të gjobës së mësipërme, zbatohet një gjobë e barabartë me trefishin e diferencës së detyrimeve doganore të papaguara

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Dega Doganore Rinas të vlerësojë situatën doganore të konstatuar sa më sipër në funksion të afateve autorizuese të lejuara të dhëna në ngarkim të subjektit “**TTA ALBA-LAM**” me NIPT J62110001L me qëllim riklasifikimin e shkeljes doganore të shkeljes doganore administrative në referim të nenit 256, 265 dhe 287 të ligjit nr. 8449 datë. 27.01.1999 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit doganor në formën e gjobës doganore në **shumën 159,904 lekë** (llogaritur më parë shuma prej 79,952 lekë).

Në përmbushje të nenit 216 pika 1 dhe 2 të Kodit Doganor, “*Lindja e Borxhit Doganor*”, pika 122.a.ç “*Deklarata Doganore me shkrim*”, sipas VKM nr. 205 datë 13.04.1999, “*Mbi Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor*” i ndryshuar, deklaruesi i mallit ose përfaqësuesi i tij i drejtpërdrejtë janë persona debitorë për shkeljen doganore të konstatuar sa më sipër.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në: ligjin nr. 8449 datë. 27.01.1999 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. *Luan Hysa me detyrë ish kryetar në D.D Rinas aktualisht në cilësinë e Kryetarit të DD Fier.*

2. *Kushtrim Elezaj me detyrë specialist/jurist pranë DD Rinas.*

◆.Nga ana e Degës Doganore Rinas është nxjerrë vendimi administrativ nr. 64 sipas shkresës nr. 3497 prot datë 04.11.2016 në ngarkim të subjektit “**ASA AUTO STAR ALBANIA**” me nipt J62023007G. Konstatohet se subjekti “**ASA AUTO STAR ALBANIA**” me nipt J62023007G. për mallrat e deklaruar “**aparati diagnostikimi për automjete**” me kod tarifor me vlerë 4956 Euro ka tejkalluar afatet autorizuese sipas autorizimit nr. 25680/1 prot datë 23.10.2015 dhe nga sektori Cargo pranë Degës Doganore Rinas është propozuar ndëshkimi i subjektit “**Asa Auto Star Albania**” në masën 73.000 lekë bazuar në nenin 256, dhe 273 të Kodit Doganor por nuk është marrë në konsideratë shpjegimi i nenit 273 të kodit doganor.

Neni 287 i Kodit Doganor.

“Kur në bazë të dispozitave të këtij Kodi, zbatimi i gjobës parashikon një minimum dhe një maksimum për të përcaktuar shumën e saj, duhet të merren parasysh faktorët e mëposhtëm.....numrin e të akuzuarve etj”

Neni 273 i Kodit Doganor



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

"Kur në bazë të dispozitave të këtij Kodi, zbatimi i gjobës parashikon një minimum dhe një maksimum për të përcaktuar shumën e saj, duhet të merren parasysh faktorët e mëposhtëm.....numrin e të akuzuarve etj"

Neni 256 i Kodit Doganor

1. Për shkeljet, të cilave u referohet neni 256 paragrafi 2 dhe të paparashikuara shprehimisht në këtë kre, zbatohet një gjobë që shkon nga 50 000 lekë deri në 200 000 lekë.

2. Kur i njëjti shkelës ka kryer disa kundërvajtje administrative në të njëjtën kohë, të përshkruara në këtë Kod, çdo shkelje ndëshkohet në veçanti.

Neni 273

**Veprime jo në përputhje me nenin 157-164 dhe 273 të Kodit Doganor ku përcaktohet se "në mosrespektim të afateve kohore, brenda të cilave mallrat e vendosura nën regjimin e lejimit të përkohshëm, sipas neneve 157 dhe 164, duhet të ishin rieksportuar ose duhet t'ju ishte dhënë një regjim tjetër doganor, kryen kundërvajtje administrative", dhe në pikën 2 ku përcaktohet se "të përdorë mallrat e vendosura nën regjimin e lejimit të përkohshëm dhe t'i nënshtrohet një gjobe, që shkon nga gjysma deri në gjithë shumën e detyrimeve doganore, që duhen paguar për mallrat në fjalë".*

Neni 157 i Kodit doganor përcakton se *“Regjimi i lejimit të përkohshëm bën të mundur përdorimin në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet e importit dhe pa iu nënshtuar masave të politikave tregtare, të mallrave joshqiptare të destinuara për t'u rieksportuar, pa pësuar ndryshime, përveç zhvleftësisimit normal për shkak të përdorimit të tyre”*. Pika 1 e nenit 160 të Kodit Doganor përcakton se *“Autoritetet doganore përcaktojnë afatin brenda të cilit mallrat e importit duhet të rieksportohen ose t'u caktohet një destinacion i ri doganor dhe ky afat duhet të zgjasë për aq kohë sa të arrihet qëllimi për të cilin është lëshuar autorizimi”*. Konstatohet se nuk është përmbushur afati i dhënë në këto autorizime doganore specifike dhe nuk **është përmbushur qëllimi i lëshimit të autorizimit** nga operatorët tregtarë zotërues të këtyre autorizimeve.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Dega Doganore Rinas të rimarrë në rishqyrtim vendimin administrativ nr. 64 në ngarkim të subjektit **“ASA AUTO STAR ALBANIA”** me nipt J62023007G me qëllim riklasifikimin e shkeljes doganore të shkeljes doganore administrative në referim të nenit 256, 273 dhe 287 të ligjit nr. 8449 datë. 27.01.1999 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"* i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit doganor në formën e gjobës doganore **sa 100% e detyrimeve** doganore në **shumën 73,000 lekë** (llogaritur më parë shuma prej 73,000 lekë). Në përmbushje të nenit 72 pika 1 dhe 2 të Kodit Doganor, *"Lindja e Borxhit Doganor"*, deklaruesi i mallit ose përfaqësuesi i tij i drejtpërdrejtë janë persona debitorë për shkeljen doganore të konstatuar sa më sipër.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Ligjin nr. 8449 datë 27.01.1999 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"* i ndryshuar

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Luan Hysa me detyrë ish kryetar në D.D.Rinas aktualisht në cilësinë e Kryetarit të DD Fier.

2. Kushtrim Elezaj me detyrë specialist/jurist pranë DD Rinas

◆Nga ana e Degës Doganore Rinas është nxjerrë vendimi administrativ nr. 65 sipas shkresës nr. 3498 prot datë 04.11.2016 në ngarkim të subjektit **“ASA AUTO STAR ALBANIA”** me nipt J62023007G. Konstatohet se subjekti **“ASA AUTO STAR ALBANIA”** me nipt J62023007G. për mallrat e deklaruar **“aparati diagnostikimi për automjete”** me kod tarifor me vlerë 4956 Euro ka tejkalar afatet autorizuese sipas autorizimit nr. 25679/1 prot datë 27.10.2015 dhe nga sektori Cargo pranë Degës Doganore Rinas është propozuar ndëshkimi i



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

subjektit “Asa Auto Star Albania” në masën 74.000 lekë bazuar në nenin 256, dhe 273 të Kodit Doganor por nuk është marrë në konsideratë shpjegimi i nenit 273 të kodit doganor. Neni 287 i Kodit Doganor. Konstatohet se subjekti “Asa Auto Star Albania” me NIPT rezulton subjekt shkelës përsëritës **për shkelje doganore të konsumuara më parë dhe të shprehura në vendimin nr. 63 datë 21.11.2016.**

“Kur në bazë të dispozitave të këtij Kodi, zbatimi i gjobës parashikon një minimum dhe një maksimum për të përcaktuar shumën e saj, duhet të merren parasysh faktorët e mëposhtëm.....numrin e të akuzuarve etj”

Neni 273 i Kodit Doganor

“Kur në bazë të dispozitave të këtij Kodi, zbatimi i gjobës parashikon një minimum dhe një maksimum për të përcaktuar shumën e saj, duhet të merren parasysh faktorët e mëposhtëm.....numrin e të akuzuarve etj”

Neni 256 i Kodit Doganor

“Kur i njëjti shkelës ka kryer disa kundërvajtje administrative në të njëjtën kohë, të përshkruara në këtë Kod, çdo shkelje ndëshkohet në veçanti.

Neni 273

**Veprime jo në përputhje me nenin 157-164 dhe 273 të Kodit Doganor ku përcaktohet se “në mosrespektim të afateve kohore, brenda të cilave mallrat e vendosura nën regjimin e lejimit të përkohshëm, sipas neneve 157 dhe 164, duhet të ishin rieksportuar ose duhet t’ju ishte dhënë një regjim tjetër doganor, kryen kundërvajtje administrative”, dhe në pikën 2 ku përcaktohet se “të përdorë mallrat e vendosura nën regjimin e lejimit të përkohshëm dhe t’i nënshtrohet një gjobe, që shkon nga gjysma deri në gjithë shumën e detyrimeve doganore, që duhen paguar për mallrat në fjalë”.*

Neni 157 i Kodit doganor përcakton se “Regjimi i lejimit të përkohshëm bën të mundur përdorimin në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet e importit dhe pa iu nënshtrohet masave të politikave tregtare, të mallrave joshqiptare të destinuara për t’u rieksportuar, pa pësuar ndryshime, përveç zhvlefësimit normal për shkak të përdorimit të tyre”. Pika 1 e nenit 160 të Kodit Doganor përcakton se “Autoritetet doganore përcaktojnë afatin brenda të cilit mallrat e importit duhet të rieksportohen ose t’u caktohet një destinacion i ri doganor dhe ky afat duhet të zgjasë për aq kohë sa të arrihet qëllimi për të cilin është lëshuar autorizimi”. Konstatohet se nuk është përmbushur afati i dhënë në këto autorizime doganore specifike dhe nuk është përmbushur qëllimi i lëshimit të autorizimit nga operatorët tregtarë zotërues të këtyre autorizimeve.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Dega Doganore Rinas të rimarrë në rishqyrtim vendimin administrativ nr. 65 në ngarkim të subjektit “ASA AUTO STAR ALBANIA” me nipt J62023007G me qëllim riklasifikimin e shkeljes doganore të shkeljes doganore administrative në referim të nenit 256, 273 dhe 287 të ligjit nr. 8449 datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit doganor në formën e gjobës doganore **sa 100% e detyrimeve** doganore në **shumën 74,000 lekë** (llogaritur më parë shuma prej 73,000 lekë). Në përmbushje të nenit 72 pika 1 dhe 2 të Kodit Doganor, “Lindja e Borxhit Doganor”, deklaruesi i mallit ose përfaqësuesi i tij i drejtpërdrejtë janë persona debitorë për shkeljen doganore të konstatuar sa më sipër.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Ligjin nr. 8449 datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Luan Hysa me detyrë ish kryetar në D.D Rinas aktualisht në cilësinë e Kryetarit të DD Fier.

2. Kushtrim Elezaj me detyrë specialist/jurist pranë DD Rinas



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

◆.Nga ana e Degës Doganore Rinas është nxjerrë vendimi administrativ nr. 66 sipas shkresës nr. 3499 prot datë 04.11.2016 në ngarkim të subjektit “**ASA AUTO STAR ALBANIA**” me nipt J62023007G. Konstatohet se subjekti “**ASA AUTO STAR ALBANIA**” me nipt J62023007G. për mallrat e deklaruar “**aparati diagnostikimi për automjete**” me kod tarifor me vlerë 4956 Euro ka tejkaluar afatet autorizuese sipas autorizimit nr. 25682/1 prot datë 27.10.2015 dhe nga sektori Cargo pranë Degës Doganore Rinas është propozuar ndëshkimi i subjektit “**Asa Auto Star Albania**” në masën 75.000 lekë bazuar në nenin 256, dhe 273 të Kodit Doganor por nuk është marrë në konsideratë shpjegimi i nenit 273 të kodit doganor.

Neni 287 i Kodit Doganor.

"Kur në bazë të dispozitave të këtij Kodi, zbatimi i gjobës parashikon një minimum dhe një maksimum për të përcaktuar shumën e saj, duhet të merren parasysh faktorët e mëposhtëm.....numrin e të akuzuarve etj"

Neni 273 i Kodit Doganor

"Kur në bazë të dispozitave të këtij Kodi, zbatimi i gjobës parashikon një minimum dhe një maksimum për të përcaktuar shumën e saj, duhet të merren parasysh faktorët e mëposhtëm.....numrin e të akuzuarve etj"

Neni 256 i Kodit Doganor

"Kur i njëjti shkelës ka kryer disa kundërvajtje administrative në të njëjtën kohë, të përshkruara në këtë Kod, çdo shkelje ndëshkohet në veçanti.

Neni 273

**Veprime jo në përputhje me nenin 157-164 dhe 273 të Kodit Doganor ku përcaktohet se "në mosrespektim të afateve kohore, brenda të cilave mallrat e vendosura nën regjimin e lejimit të përkohshëm, sipas neneve 157 dhe 164, duhet të ishin riekportuar ose duhet t'ju ishte dhënë një regjim tjetër doganor, kryen kundërvajtje administrative", dhe në pikën 2 ku përcaktohet se "të përdorë mallrat e vendosura nën regjimin e lejimit të përkohshëm dhe t'i nënshtrohet një gjobe, që shkon nga gjysma deri në gjithë shumën e detyrimeve doganore, që duhen paguar për mallrat në fjalë".*

Neni 157 i Kodit doganor përcakton se “*Regjimi i lejimit të përkohshëm bën të mundur përdorimin në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet e importit dhe pa iu nënshtrohet masave të politikave tregtare, të mallrave joshqiptare të destinuara për t’u riekportuar, pa pësuar ndryshime, përveç zhvleftësimit normal për shkak të përdorimit të tyre*”. Pika 1 e nenit 160 të Kodit Doganor përcakton se “*Autoritetet doganore përcaktojnë afatin brenda të cilit mallrat e importit duhet të riekportohen ose t’u caktohet një destinacion i ri doganor dhe ky afat duhet të zgjasë për aq kohë sa të arrihet qëllimi për të cilin është lëshuar autorizimi*”. Konstatohet se nuk është përmbushur afati i dhënë në këto autorizime doganore specifike dhe nuk **është përmbushur qëllimi i lëshimit të autorizimit** nga operatorët tregtarë zotërues të këtyre autorizimeve.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Dega Doganore Rinas të rimarrë në rishqyrtim vendimin administrativ nr. 66 në ngarkim të subjektit “**ASA AUTO STAR ALBANIA**” me nipt J62023007G me qëllim riklasifikimin e shkeljes doganore të shkeljes doganore administrative në referim të nenit 256, 273 dhe 287 të ligjit nr. 8449 datë 27.01.1999 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit doganor në formën e gjobës doganore **sa 100% e detyrimeve doganore në shumën 75,000 lekë**(llogaritur më parë shuma prej 73,000 lekë). Në përmbushje të nenit 72 pika 1 dhe 2 të Kodit Doganor, “*Lindja e Borxhit Doganor*”, deklaruesi i mallit ose përfaqësuesi i tij i drejtpërdrejtë janë persona debitorë për shkeljen doganore të konstatuar sa më sipër.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Ligjin nr. 8449 datë 27.01.1999 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Luan Hysa me detyrë ish-kryetar në D.D.Rinas aktualisht në cilësinë e Kryetarit të DD Fier.

2. Kushtrim Elezaj me detyrë specialist/jurist pranë DD Rinas

◆.Nga ana e Degës Doganore Rinas është nxjerrë **vendimi administrativ nr. 91** sipas shkresës nr. 4044 prot datë 09.12.2016 të Sektorit të Kontrollit Pas Zhdoganimit dhe **vendimi administrativ nr. 8** datë 07.03.2017 sipas proces-verbalit nr. 651 prot datë 22.02.2017 dhe shkresës nr. 30035/1 Prot datë 02.02.2017 të ardhur nga Drejtoria e Laboratorit Kimik Doganor mbi rezultatet e ardhura mbi mostrimin e kryer për artikullin lëkurë Minjon mbi praktien doganore të subjektit “Arantos” shpk me nipt **J6182412** A. Gjatë kontrollit fizik të mallit të ushtruar në praktikën doganore nr. R 23356 datë 02.12.2016 ka rezultuar një sasi malli prej 216 metër linear e padeklaruar nga subjekti në fjalë. Në përfundim nga Dega Doganore Rinas është nxjerrë vendimi administrativ nr. 8 datë 07.03.2017 ku është vendosë një sanksion administrativ në shumën **48,061 lekë** për llogari të subjektit “Arantos” me nipt J61824012A për shkeljen doganore të konsumuar. Nga shqyrtimi i vendimit administrativ nr. 91 datë 16.12.2016 konstatohet se në përfundim është vendosë pagimi i detyrimit doganor bashkë dhe kryerja e detyrueshme e praktikës doganore **IMP 4 për sasinë prej 216 mlinear lëkurë** me penalitetet përkatëse por nuk është kërkuar konfiskimi i vlerës doganore të mallit të padeklaruar në sasinë 216 mlinear në **‘vlerën doganore të mallit më nivelin 433 Euro ose 58,888 lekë’**si sasi malli e gjetur në tepricë dhe e verifikuar nga autoritetet doganore. Nga shqyrtimi i shkeljes doganore konstatohet se subjekti Arantos me NIPT J61824012A ka kryer kundërvajtje administrative doganore gjatë procedurave deklaruese të sasisë prej 845 mlinear lëkurë. *Neni 267 i Kodit Doganor.*

Pa rënë ndesh me dispozitat mbi kontrabandën, përbën kundërvajtje administrative doganore plotësimi i deklaratës për lejim të përkohshëm të mallrave ose për regjimin e përpunimit aktiv, duke deklaruar një cilësi ose sasi të ndryshme nga ajo e konstatuar nga autoritetet doganore.

2. Deklaruesi që kryen këtë shkelje ndëshkohet me sanksionet që vijojnë:

a) në rastin e diferencës në cilësi, pagesa e një gjobe që shkon nga një deri në trefishin e shumës së detyrimeve doganore që duhen paguar për mallrat e konstatuara;

Neni 287 i Kodit Doganor.

"Kur në bazë të dispozitave të këtij Kodi, zbatimi i gjobës parashikon një minimum dhe një maksimum për të përcaktuar shumën e saj, duhet të merren parasysh faktorët e mëposhtëm.....numrin e të akuzuarve etj"

Neni 256 i Kodit Doganor

"Kur i njëjti shkelës ka kryer disa kundërvajtje administrative në të njëjtën kohë, të përshkruara në këtë Kod, çdo shkelje ndëshkohet në veçanti.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Dega Doganore Rinas të rimarrë në rishqyrtim vendimin administrativ nr. 91 të vitit 2016 dhe nr. 8 të vitit 2017 në ngarkim të subjektit “Arantos” shpk me NIPT **J6182412** Ame qëllim riklasifikimin e shkeljes doganore administrative në referim të nenit 256, 261, 267 pika 2/a dhe 287 të ligjit nr. 8449 datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit doganor në formën e gjobës doganore në **shumën 48,061 lekë**dhe kërkimin e vlerës së mallit që duhej konfiskuar në sasinë prej 216 mlinear në **shumën 58,888 lekë**. Në përmbushje të nenit 216 pika 3 të Kodit Doganor, "Lindja e Borxhit Doganor", deklaruesi i mallit ose përfaqësuesi i tij i drejtpërdrejtë janë persona debitorë për shkeljen doganore të konstatuar sa më sipër.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Ligjin nr. 8449 datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

1. Luan Hysa me detyrë ish kryetar në D.D.Rinas aktualisht në cilësinë e Kryetarit të DD Fier.

2. Kushtrim Elezaj me detyrë specialist/jurist pranë DD Rinas

Konkretisht viti 2017

◆.Nga ana e Degës Doganore Rinas është nxjerrë vendimi administrativ nr. 52 sipas shkresës nr. 3695 prot datë 10.11.2017 në ngarkim të subjektit “AIR BP ALBANIA” SHA i pajisur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me Autorizim për administrimin e një magazine doganore të Tipit C me Nr. 2626/10280 datë 21.09.2006 dhe me ndryshime autorizimi sipas shkresës nr. 1674 prot datë 27.05.2016 me aktivitetet “Import, magazinim dhe riekспорт për karburant avionesh Jet-1 dhe Avgaz”.

Bazuar në proces-verbalet nr. 3692 prot datë 10.11.2017 ka rezultuar një diferencë karburanti Jet-1 në sasinë 1801 litra dhe vlerë 160,375 lekë. Konstatohet se ky subjekt ka kryer shkelje doganore të përsëritura (Vendimi nr. 6 dhe nr 31 viti 2016 me këtë natyrë shkeljeje) dhe bazuar në nenet 256/2/4 dhe 265 të Kodit Doganor është penalizuar nga Dega Doganore Rinas me njëfishin e detyrimit doganor të papaguar. Konstatohet se shkelja doganore e dokumentuar në proces-verbalin nr. 3692 prot datë 09.11.2017 është shkelje doganore e përsëritur.

Neni 257 i Kodit Doganor “Sanksionet për kundërvajtjet e kryera në neglizhencë”

“Kur kundërvajtja k të bëjë me mallra (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen zbatuar për mallrat, zbatohet një sanksion në masën sa 2-fish i detyrimit të munguar.

Neni 252 pika e) i Kodit Doganor.

“Mosrespektimi nga operatori ekonomik i detyrimit për të paraqitur nq zyrën doganore të daljes mallrat që do të dalin nga territori doganor i RSH, në përputhje me pikën 2 të nenit 39”

Neni 252 pika g) i Kodit Doganor

“Mosrespektimi nga operatori ekonomik i mbajtësit të autorizimeve të detyrimeve që rrjedhin nga magazinimi i mallrave që mbulohen nga regjimi i magazinimit doganor, në përputhje me shkronjat a”, dhe b të pikës 1 të nenit 215

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Dega Doganore Rinas të marrë në rishqyrtim vendimin administrativ nr. 52 sipas shkresës nr. 3695 prot datë 10.11.2017 në ngarkim të subjektit “AIR BP ALBANIA” SHA me NIPT J9223002L me qëllim riklasifikimin e shkeljes doganore të shkeljes doganore administrative në referim të nenit 250, 252 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i RSH” i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit doganor në formën e gjobës doganore sa 2(dy) fishi i detyrimeve doganore në shumën 94,566 lekë (llogaritur më parë shuma prej 94,566 lekë). Në përmbushje të nenit 72 pika 1 dhe 2 të Kodit Doganor, “Lindja e Borxhit Doganor”, deklaruesi i mallit ose përfaqësuesi i tij i drejtpërdrejtë janë persona debitorë për shkeljen doganore të konstatuar sa më sipër.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i RSH” i ndryshuar

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Vladimir Vladi me detyrë kryetar në D.D Rinas

2. Kushtrim Elezaj me detyrë specialist/jurist pranë DD Rinas

Për sa më sipër mbajtur akt-konstatimi nr. 6 dhe nr. 7 datë 02.03.2018

Gjetje nga auditimi.

Drejtimi nr. 6 “Auditimi i procedurave doganore të ndjekura gjatë marrjes së vendimeve administrative”.



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

Titulli i Gjetjes 1	Zbatimin e legjislacionit doganor në përputhje me Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, dhe pikave 234-239, 272-325 dhe 463-472 të VKM nr. 205 datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”
Situata:	<i>Situata</i> Nga auditimi i dokumentacionit për vendimet administrative të marra për shkeljet në fushën doganore për periudhën nën auditim rezultuan vendimeve administrative të nxjerra jo në përputhje me përcaktimet e nenit 107-112, 136-149, 256, 261, 273, 275 dhe 281/1 të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, dhe pikave 234-239, 272-325 dhe 463-472 të VKM nr. 205 datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar, në shumën totale 703 mijë lekë për raste vendimesh administrativë të nxjerra gjatë vitit ushtrimor 2016 dhe 2017.
Kriteri :	Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, dhe pikave 234-239, 272-325 dhe 463-472 të VKM nr. 205 datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”
Ndikimi/Efekti	Konstatohen vendime administrative të nxjerra jo në përputhje me legjislacionin doganor në shumën 703 mijë lekë për raste vendimesh administrativë të nxjerra gjatë vitit ushtrimor 2016 dhe 2017.
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	Dega Doganore Rinastë kërkojë ndryshimin ose revokimin në rrugë ligjore për vendime administrative në shumën totale 703mijë lekë për raste vendimesh administrative të vitit 2016 dhe 2017 duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit me qëllim nxjerrjen dhe arkëtimin e detyrimeve doganore dhe gjobave doganore bazuar në ligjin nr. 8449, datë 20.01.1999 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe VKM nr. 205 datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar.

Menjëherë

7. Drejtimi nr. 7 e Auditimit “Të tjera gjatë Auditimit”.

Për auditimin e ligjshmërisë gjatë procedurave të marrjes së vendimeve administrative për shkatërrimin me procedure të përshpejtuar të mallrave të falsifikuara. Mbi auditimin e ushtruar në Degën Doganore Rinas në bazë të programit të auditimit nr. 1347/1 , datë 19.01.2018 mbajtur në datë 02.03.2018. Objekti i këtij akt konstatimi është auditimi i procedurave administrative të ndjekura nga Autoriteti Doganor Rinas gjatë marrjes së vendimeve administrative për periudhën 2016-2017. Në zbatim të pikës nr. 7 të Programit të Auditimit nr. 1347/1 prot, datë 19.01.2018, u konsiderua si e nevojshme mbajtja e një akt konstatimi, në ambientet e Degës Doganore Rinas, nga audituesit e KLSH-së znj. Elida Kocani dhe z Altin Dinaj, për të cilat u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Vendimet administrative të nxjerra nga Dega Doganore Rinas.

-Procesverbal konstatimi i shkeljes doganore.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që nga ana e DDRinas nuk janë zbatuar:



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

*-Përcaktimet ligjore në ligjin 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i RSH”, 82 pika 4.
-Përcaktimet ligjore të bëra në VKM Nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Miratimin e Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor”, ndryshuar me VKM nr. 1090, datë 28.12.2015 , Titulli IX “Për mallrat e falsifikuara dhe mallrat pirate”
Referuar Nenit 11 pika 5; Neni 82 pika 4; Neni 285 pika 3,4,5 Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor” .*

Neni 11 pika 5.

Ne pikat e kalimit të kufirit tokësor, ujor e në aeroporte, si edhe në dalje nga doganat e brendshme, organizohet kontrolli i mallrave dhe i mjeteve të transportit që dalin nga zonat doganore, për të verifikuar nëse cilësia dhe sasia e mallrave të transportuara janë në përputhje me dokumentet doganore shoqëruese. Nëse nuk rezultojnë mospërputhje, punonjësit e doganës që kryejnë këtë shërbim vendosin mbi dokumentet doganore vulën që tregojnë se janë në rregull. Në rast të kundërt, ata përpilojnë proces-verbalin përkatës, të cilin ia kalojnë Kryetarit të zyrës doganore për të kryer formalitetet e mëtejshme.

Neni 82, pika 4

Autoritetet doganore me kërkesë të zotëruesit të një marke fabrikimi ose licence prodhimi, ose edhe të drejtave të tjera të specifikuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi, mund të ndalojnë vënien në qarkullim të lire, eksportimin, riekportimin dhe vendosjen në një regjim të caktuar pezullues mallrat e njohura si të falsifikuara ose pirate, sipas procedurave të parashikuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

Neni 285 pika 3,4,5

*3. Për të gjitha shkeljet e dispozitave të këtij Kodi dhe akteve të tij nënligjore mbahet një procesverbal me shkrim.
4. Procesverbali duhet të paraqitet dhe regjistrohet në librat e autoriteteve doganore kompetente dhe duhet të nënshkruhet prej të paktën 2 punonjësve të doganës.
5. E njëjta procedurë ndiqet për shkeljet e dispozitave të tjera ligjore zbatimi i të cilave i është besuar pjesërisht ose tërësisht autoriteteve doganore.*

Referuar Nenit 118; Neni 119.1 të Vendimit Nr. 1090, datë 28.12.2015 për disa ndryshime në Vendimin Nr. 205, Datë 13.4.1999, Të Këshillit Të Ministrave, “Për Miratimin e Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor”, të Ndryshuar”

Neni 118.

Në zbatim të nenit 82 (4) të Kodit Doganor, ky kre përcakton:

1) Procedurën për ndërmarrjen e veprimeve nga autoritetet doganore, kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme dyshimi se cenohet një e drejtë e pronësisë intelektuale, nga mallra, të cilat:

i) janë vendosur në qarkullim të lirë, janë eksportuar ose riekportuar, në përputhje me legjislacionin doganor;

ii) janë zbuluar gjatë kontrollit të mallrave, që hyjnë ose dalin nga zonat doganore të Republikës së Shqipërisë, dhe që janë vendosur nën regjimin e transitit, të magazinimit doganor, importit, përpunimit nën kontroll doganor, importit të përkohshëm ose që janë vendosur në një zonë të lirë a magazinë të lirë, në përputhje me legjislacionin doganor.

Neni 119.1

Kur autoritetet doganore, në rastet e përmendura në pikën 118, paragrafi 1, dhe përpara paraqitjes së një kërkesë nga mbajtësi i së drejtës ose përpara miratimit të saj nga autoritetet doganore, kanë shkaqe të arsyeshme dyshimi, që mallrat cenojnë një të drejtë të pronësisë intelektuale, mund të pezullojnë çlirimin e tyre dhe t'i sekuestrojnë ato.

Referuar Nenit 120 ; Neni 120/3 të Vendimit Nr. 1090, datë 28.12.2015 për disa ndryshime në Vendimin Nr. 205, Datë 13.4.1999, Të Këshillit Të Ministrave, “Për Miratimin e Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor”, të ndryshuar”



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

120/1 Pezullimi i çlirimit apo ndalimi i mallrave përpara miratimit të aplikimit

Kur autoritetet doganore identifikojnë mallra që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë intelektuale, por që nuk përfshihen në vendimin me të cilin është miratuar aplikimi, ato mund, përveç se në rastet e mallrave që prishen shpejt, të pezullojnë çlirimin e këtyre mallrave apo t'i ndalojnë ato.

Neni 120/3 Kushtet e magazinimit

Kushtet e magazinimit të mallrave gjatë periudhës së pezullimit të çlirimit apo ndalimit të tyre përcaktohen nga autoritetet doganore.

Referuar Nenit 120/6 “Shkatërrimi i mallrave, fillimi i procedurave dhe çlirimi i hershëm i mallrave” të Vendimit Nr. 1090, datë 28.12.2015 për disa ndryshime në Vendimin Nr. 205, Datë 13.4.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për Miratimin e Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor”, të ndryshuar”

Neni 120/6 Shkatërrimi i mallrave dhe fillimi i procedurave

Mallrat që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë intelektuale mund të shkatërrohen nën mbikëqyrje doganore, pa qenë e nevojshme të vërtetohet nëse është shkelur një e drejtë e pronësisë intelektuale, kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

Mbajtësi i vendimit u konfirmon me shkrim autoriteteve doganore, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune ose 3 (tri) ditëve pune në rastet e mallrave që prishen shpejt, nga data e njoftimit për pezullimin e çlirimit ose ndalimin e mallrave se, sipas bindjes së tij, është shkelur një e drejtë e pronësisë intelektuale;

Mbajtësi i vendimit u jep me shkrim autoriteteve doganore, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, ose 3 (tri) ditëve pune në rastet e mallrave që prishen shpejt, nga data e njoftimit për pezullimin e çlirimit ose ndalimin e mallrave, pëlqimin e tij për shkatërrimin e mallrave;

Deklaruesi apo mbajtësi i mallrave u jep me shkrim autoriteteve doganore, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune ose 3 (tri) ditëve pune në rastet e mallrave që prishen shpejt, nga data e njoftimit për pezullimin e çlirimit ose ndalimin e mallrave, pëlqimin e tij për shkatërrimin e mallrave. Kur deklaruesi apo mbajtësi i mallrave nuk ka dhënë pëlqimin e tij për shkatërrimin e mallrave dhe as nuk ka njoftuar kundërshtimin e tij pranë autoriteteve doganore brenda këtyre afateve, autoritetet doganore mund të vlerësojnë se deklaruesi apo mbajtësi i mallrave ka dhënë pëlqimin për shkatërrimin e mallrave.

Shkatërrimi i mallrave kryhet nën kontrollin doganor dhe nën përgjegjësinë e mbajtësit të vendimit. Autoritetet doganore mund të marrin mostra përpara shkatërrimit të mallrave. Mostrat që merren mund të përdoren për qëllime edukative.

Kur deklaruesi apo mbajtësi i mallrave nuk ka dhënë me shkrim pëlqimin e tij për shkatërrimin e mallrave dhe kur nuk vlerësohet se ai ka dhënë pëlqimin e tij për shkatërrimin, brenda afatit të përcaktuar në shkronjën “c”, të paragrafit të parë, të pikës 1, autoritetet doganore njoftojnë për këtë menjëherë mbajtësin e vendimit. Mbajtësi i vendimit, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune ose 3 (tri) ditëve pune në rastin e mallrave që prishen shpejt, nga njoftimi i pezullimit të çlirimit apo ndalimit të mallrave, duhet të fillojë procedimin gjyqësor, nëpërmjet paraqitjes së një kopjeje të aktpadisë, të paraqitur pranë gjykatës kompetente për të vendosur nëse është shkelur një e drejtë e pronësisë intelektuale.

Përveçse në rastin e mallrave që prishen shpejt, autoritetet doganore, në raste të përshtatshme, mund të zgjatin afatin e përcaktuar në pikën 3, deri në 10 (dhjetë) ditë pune, me kërkesë të justifikuar nga mbajtësi i vendimit. Autoritetet doganore çlirojnë mallrat apo përfundojnë ndalimin e tyre, menjëherë pas përfundimit të të gjitha formaliteteve doganore, nëse, brenda afateve të përcaktuara në pikat 3 dhe 4, nuk janë informuar ligjërisht, në përputhje me pikën 3, për fillimin e procedimit gjyqësor, nëpërmjet paraqitjes së një kopjeje të aktpadisë, të paraqitur pranë gjykatës kompetente për të vendosur nëse është shkelur një e drejtë e pronësisë intelektuale.

♦. **Në lidhje me Vendimin Administrativ Nr. 17, protokolluar me nr. 1015 prot, datë 25.03.2016 për subjektin “Fatmir Ibrahim” me NIPT K57205202T**, është vendosë :

-Shkatërrimin me procedurë të përshtatshme të artikujve “ora” të markës “Rado” sipas evidencës së kontrollit fizik nr. 0004886; 0004887; 0004888 dhe 0004889 datë 17.01.2016

-Subjekti “Fatmir Ibrahim” person fizik të përpilojë deklaratën doganore IM 9 për agjësimin e mallit dhe mbetjet e tyre



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

-Ngarkohet specialisti i kontrollit paszhdoganimit pranë kësaj dege doganore të bëjë korigjimin/ rregullimin e situatës.

-Shpenzimet e asgjësimit do të të përballohen nga mbajtësi i të drejtës së markës tregtare

-Palët pjesëmarrëse në procesin e asgjësimit: Përfaqësues të DPD, përfaqësues të D.D.Rinas, Përfaqësues të mbajtësit të së drejtës së markës tregtare “Rado”, të cilët duhet të dokumentojnë çdo veprim të kryer për asgjësimin e mallrave të mësipërme.

-Për të proceduar më tej ngarkohen juristi, aposteriori, financierja, Drejtoria për mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale pranë DOH në DPD në zbatim të proceduarve përkatëse të normuara nga aktet në fuqi.

-Kundër këtij vendimi bazuar në K. Pr. Administrative lejohet ankimi brenda 10 ditëve pranë DPD nga marrja e këtij vendimi.

Nga praktika dokumentare dhe të dhënat e sistemit asicuda rezulton se:

Në datën 17.01.2016 janë bllokuar nga grupi antikontabandë në DPD Mallrat “ora dore” të markave të ndryshme gjithsej në sasinë 1139 copë, më peshë 193.9 kg. Këto mallra me natyrë tregtare kanë mbërritur në transportierin e aeroportit të futura në tetë çanta pa stikerin e udhëtarit. Mallrat janë marrë nga grupi i antikontabandës dhe janë futur në zyrën e doganës ku janë numëruar dhe është mbajtur shënim për çdo çantë. Pas numërimit çantat u plumbosën me plumbçet me numër 000176;000174; 000174; 000173; 000172; 000171; 000170; 000169. Subjekti më datë 20.01.2016 është paraqitur në DPD dhe ka deklaruar mallin e bllokuar për zhdoganim me deklaratat doganore IM 4 nr. R-1082, dt 20.01.2016 për sasinë 1078 copë dhe nr. R-1093, dt 20.01.2016 për sasinë 61 copë. Nga D.D.Rinas në bashkëpunim me Drejtorinë për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale është vendosur pezullimi i çlirimit të mallit që i përket deklartës doganore IM 4 R-1093, dt 20.01.2016, pasi artikulli “ora dore” i deklaruar me këtë deklaratë është i markës “Rado”, e cila është markë e mbrojtur. Personi fizik **“Fatmir Ibrahim”** nuk ka paraqitur pranë autoriteteve doganore kundërshtimin me shkrim referuar K.Pr.Administrative, për shkatërrimin e mallrave të pezulluara. *Nga auditimi u konstatuan këto të meta dhe mangësi:*

-Procesverbali datë 17.01.2016 dhe Akt Bllokimi i Grupit të Antikontabandës të DPD , nuk janë protokolluar në D.R.Rinas, veprime në kundërshtim me Nenin 285, pika 3,4,5 të VKM 1090/2015.

-Mallrat e bllokuara nuk janë magazinuar gjatë periudhës së pezullimit të çlirimit apo ndalimit të, sipas rregullave që duhet përcaktohen nga autoritetet doganore, në kundërshtim me VKM 1090 , dt 28.12.2015, Nenin 120/3.

-Procesverbal për shkatërrimin me procedurë të përshpejtuar të artikujve “ora” të markës “Rado”, nuk ka datë dhe ka qenë i pa protokolluar (protokolluar me nr. 761 prot, datë 27.02.2018), në kundërshtim me kërkesat VKM 1090, dt 28.12.2015, nenit 285 pika 3,4,5.

-Procesverbali nuk është firmosur nga 2 punonjës të D.D.Rinas, por nga një punonjëse, në kundërshtim me kërkesat VKM 1090, dt 28.12.2015 nenin 285 pika 3 .

-Proces Verbali nuk është firmosur nga përfaqësues të DPD kundërshtim me KD dhe Vendimin Administrativ Nr. 17, protokolluar me nr. 1015 prot, datë 25.03.2016

◆Në lidhje me Vendimin Administrativ Nr. 21, protokolluar me nr. 1317 prot, datë 22.04.2016 për subjektin “Ibir Bushi” me NIPT L01311014B, ka vendosur:

-Shkatërrimin me procedure të përshpejtuar të artikujve “atlete inkeliti” 352 palë të markës “Addidas”, 26 copë çanta dore të markës “Louis Vuitton” dhe 8 copë rripa mesi inkeliti të markës “Louis Vuitton” sipas deklaratës doganore IM 4 R-5469, dt 21.03.2016 me shpenzimet dhe nën përgjegjësinë e kompanisë “Addidas” dhe “Louis Vuitton” të përfaqësuar nga znj. Sonila Elezi.



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

-Subjekti “Ilir Bushi”, person fizik të përpilojë deklaratën doganore IM 9 për asgjësimin e mallit dhe mbetjet e tyre;

-Ngarkohet specialisti i kontrollit paszhdoganimit pranë kësaj dege doganore të bëjë korrigjimin/ rregullimin e situatës;

-Shpenzimet e asgjësimit do të përballohen nga mbajtësi i së drejtës së markës tregtare.

-Palët pjesëmarrëse në procesin e asgjësimit: Përfaqësues të DPD, përfaqësues të D.D.Rinas, Përfaqësues të mbajtësit të së drejtës së markës tregtare “Addidas” dhe “Loui Vouiton”, të cilët duhet të dokumentojnë çdo veprim të kryer për asgjësimin e mallrave të mësipërme.

-Për të proceduar më tej ngarkohen juristi, aposteriori, financierja, Drejtoria për mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale pranë DOH në DPD në zbatim të proceduarve përkatëse të normuara nga aktet në fuqi.

-Kundër këtij vendimi bazuar në K. Pr. Administrative lejohet ankimi brenda 10 ditëve pranë DPD nga marrja e këtij vendimi.

Nga praktika dokumentare dhe të dhënat e sistemit asicuda rezulton se:

Nga subjekti “Ilir Bushi” është deklaruar me deklaratën doganore IM 4 R-5469, datë 21.03.2016 import nga Turqia për “atlete inkeliti” 352 palë të markës “Addidas”, 26 copë çanta dore të markës “Louis Vuitton” dhe 8 copë rripa mesi inkeliti të markës “Louis Vuitton” dhe R-5470, datë 21.03.2016 import për 24 kuleta marka “Fendi”, të cilin është mbajtur Akt Konstatimi dhe Evidenca e kontrollit fizik nr serial 0006854, nga doganierët e zyrës operacionale D.D.Rinas. Me shkresën nr. 975, datë 24.03.2016 është njoftuar subjekti për pezullimin e çlirimit të mallrave të IM4 me R- 5469, dt 21.03.2016, për të cilat janë miratuar vendimet nr. AL/100/235/06/2015, datë 29.06.2015; AL/100/232/06/2015, dt 29.06.2015; AL/100/232/06/2015 nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Por për këtë rast për këtë shtetas, me shkresën nr. 11405/1, dt 10.05.2016 Drejtoria e Hetimit pranë DPD bën me dije se është bërë referim në Prokurorinë e Shkallës së Parë të Rrethit Tiranë dhe për mallrat e bllokuara nuk mund të kryhet asnjë procedurë e mëtejshme pasi mallrat konsiderohen provë materiale të cilat i janë lënë në ruajtje në DD Rinas. Pas hetimit të çështjes, me Vendimin nr. 3496, dt 30.06.2016 në Prokuroria e Shkallës së Parë të Rrethit Tiranë ka vendosur pushimin e çështjes dhe për sendet e sekuestruara në cilësinë e provës materiale me proces verbal sekuestro datë 16.03.2016 ti kthehen personit që i takon. Nga Drejtoria Juridike në DPD është kundërshtuar Vendimi i Prokurorisë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor dhe më tej në Gjykatën e Apelit me kërkesë ankimore nr. 26791/2 prot, datë 23.11.2016. D.D.Rinas me shkresën nr. 1804, datë 01.06.2017 pretendon se pavarësisht çështjes penale, mallrat e pezulluara është provuar fakti se këto mallra janë të falsifikuara dhe më vendim administrativ nr. 21, datë 22.04.2016 është vendosur shkatërrimi i tyre

Nga dokumentacioni në dosje rezulton se personi fizik “Ilir Bushi” nuk ka paraqitur pranë autoriteteve doganore kundërshtimin me shkrim referuar K.Pr.Administrative, për kundërshtimin e vendimit.

Nga auditimi u konstatuan këto të meta dhe mangësi:

Akt Konstatimi dhe Evidenca e kontrollit fizik nr. serial 0006854, nga doganierët e zyrës operacionale D.D.Rinas., nuk janë protokolluar në DRRinas, veprime në kundërshtim me Nenin 285, pika 3,4,5 të VKM 1090/2015. Mallrat e bllokuara nuk janë magazinuar gjatë periudhës së pezullimit të çlirimit apo ndalimit të, sipas rregullave që duhet përcaktohen nga autoritetet doganore, veprime në kundërshtim me VKM 1090 , dt 28.12.2015, Neni 120/3. Personi fizik “Ilir Bushi” nuk ka bërë deklaratën doganore IM 9 për shkatërrim të mallrave markë e mbrojtur. Nuk është përfunduar procedura për shkatërrimin e mallit të artikujve të bllokuar, sipas deklaratës doganore IM 4 R-5469, dt 21.03.2016, e cila sipas shkresave të juristit të D.D.Rinas është në Gjykatën e Apelit Tiranë, për shkak të kundërshtimit nga Drejtoria



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

Juridike në DPD sipas kërkesës ankimore nr. 26791/2 prot, datë 23.11.2016 të Vendimit të Prokurorisë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor për pushimin e çështjes penale,

◆. Në lidhje me Vendimin Administrativ Nr. 34, protokolluar me nr. 2201 prot, datë 19.07.2016 për subjektin “Entila Kryemadhi” me NIPT L21401052OB, ka vendosur:

-Shkatërrimin me procedure të përshpejtuar të artikullit “bateri” të markës tregtare “Samsung” me shpenzimet dhe nën përgjegjësinë e kompanisë “Samsung” e përfaqësuara nga znj. Sonila Elezi.

-Subjekti “Entila Kryemadhi”, person fizik të përpilojë deklaratën doganore IM 9 për asgjësimin e mallit dhe mbetjet e tyre;

-Ngarkohet specialisti i kontrollit paszhdoganimit pranë kësaj dege doganore të bëjë korrigjimin/ rregullimin e situatës.

-Shpenzimet e asgjësimit do të përballohen nga mbajtësi i së drejtës së markës tregtare.

-Palët pjesëmarrëse në procesin e asgjësimit: Përfaqësues të DPD, përfaqësues të D.D.Rinas, Përfaqësues të mbajtësit të së drejtës së markës tregtare “Samsung”, të cilët duhet të dokumentojnë çdo veprim të kryer për asgjësimin e mallrave të mësipërme.

-Për të proceduar më tej ngarkohen juristi, aposteriori, financierja, Drejtoria për mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale pranë DOH në DPD në zbatim të proceduarve përkatëse të normuara nga aktet në fuqi.

-Kundër këtij vendimi bazuar në K. Pr. Administrative lejohet ankimi brenda 10 ditëve pranë DPD nga marrja e këtij vendimi.

Nga praktika dokumentare dhe të dhënat e sistemit asicuda rezulton se:

Subjekti ka deklaruar për zhdoganim me deklaratën IM 4 R-5836, dt 26.03.2016 artikullin bateri 200 copë, të markës tregtare “Samsung”. Nga kontrolli fizik i ushtruar pranë D.D.Rinas për dërgesën me AWB 020-58709291, dalë nga profili i riskut, u konstatuan mallra për të cilat ka dyshime të arsyeshme që janë çenuese të të drejtave të pronësisë intelektuale. Për këtë konstatim nuk u paraqit procesverbal apo akt konstatim dhe evidencë e kontrollit fizik për bllokimin/ pezullimin e mallrave nga doganierët e kontrollit fizik të D.D.Rinas. Me shkresën nr. 1027, datë 30.03.2016 është njoftuar për pezullim dhe/ose ndalim të çlirimit të mallrave personi fizik “Entila Kryemadhi”, Drejtoria për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale dhe agjencia doganore “Mirlin” bazuar në VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Për dispozitat zbatuese të kodit doganor”. Për këtë është mbajtur proces verbali “Lënie në ruajtje të sendeve” datë 31.03.2016 (ne tre kopje), në magazinën e DDRinas, firmosur nga magazinierja e DDR dhe oficerët e policisë gjyqësore të DH në DPD. Nga dokumentacioni në dosje rezulton se personi fizik “Entila Kryemadhi” nuk ka kundërshtuar vendimin pranë autoriteteve doganore.

Nga auditimi u konstatuan këto të meta dhe mangësi:

a) Nuk u paraqit procesverbal apo akt konstatim dhe evidencë e kontrollit fizik për bllokimin/ pezullimin e mallrave për mallrat e bllokuara nga doganierët e kontrollit fizik të D.D.Rinas, veprime në kundërshtim me Nenin 285, pika 3,4,5 të VKM 1090/2015.

b) Mallrat e bllokuara nuk janë magazinuar gjatë periudhës së pezullimit të çlirimit apo ndalimit të, sipas rregullave që duhet përcaktohen nga autoritetet doganore, veprime në kundërshtim me VKM 1090, dt 28.12.2015, Neni 120/3.

c) Nuk u paraqit procesverbal për shkatërrimin me procedurë të përshpejtuar të artikullit “bateri” të markës tregtare “Samsung”.

d) Personi fizik “Entila Kryemadhi” nuk është bërë deklarata doganore IM 9 për shkatërrim mallrave markë e mbrojtur, në kundërshtim me kërkesat e KD dhe Vendimit Administrativ Nr. 34, protokolluar, datë 19.07.2016



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

e) Nga kjo dege doganore nuk është bërë korrigjimin/ rregullimin e situatës nga specialisti i kontrollit paszhdoganimit, në kundërshtim me kërkesat e KD dhe Vendimit Administrativ Nr. 34, protokolluar, datë 19.07.2016

◆ Në lidhje me Vendimin Administrativ Nr. 51, protokolluar me nr. 3689 prot, datë 10.11.2017 për subjektin “Mustaf Halilaj” me NIPT L37914201H, ka vendosur:

-Konfiskimin e mallrave të konfirmuara si fallco “karrikues” 330 copë dhe “data kabëll” 612 copë referuar shkresës së DMPI nr. 18909/4 , dt 25.10.2017.

-Shkatërrimin/ asgjësimin e këtyre mallrave të cilat janë çenuese të të drejtave të pronësisë industriale të markës “Samsung Electronics LTD”

-Ngarkohet që të ndjekin procedurat ligjore në zbatim të këtij vendimi , referuar neneve respektive mbi procedurën e asgjësimit, specialisti i kontrollit paszhdoganimit pranë kësaj dege doganore.

-Kundër këtij vendimi bazuar në K. Pr. Administrative, mund ti paraqisni Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, një ankese të arsyetuar brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të këtij vendimi

-Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nga praktika dokumentare dhe të dhënat e sistemit asicuda rezulton se:

Nga agjencia doganore “Mirlin”, me nr. J009 është deklaruar për zhdoganim me deklaratë doganore IM4 R-18369, datë 11.08.2017, për llogari të subjektit “Mustaf Halilaj” me NIPT L37914201H, malli “aksesore për celularë”, me vlerë fature 4635.1 USD.D.D.Rinas bazuar në dyshimin e arsyeshëm mbi falsitetin e mallrave të importuara ka bërë pezullimin e çlirimit të mallrave për kryerjen e procedurës së verifikimit sipas KD dhe VKM për dispozitive zbatuese të KD. Me shkresën e datës 18.09.2017 përfaqësuesi ligjor i mbajtësve të së drejtës “Samsung Electronics Co.Ltd” dhe si person kontakti konfirmohet fallciteti i mallrave të pezulluara, dukë kërkuar vazhdimin e procedurave. Me shkresën nr. 18909/4, datë 25.10.2017 të DMPI në DPD, protokolluar ne DDR me nr. 3648, dt 07.11.2017 konfirmon fallcitetin e mallrave të bllokuara .

Nga auditimi u konstatuan këto të meta dhe mangësi:

Nuk u paraqit procesverbal apo akt konstatim dhe evidencë e kontrollit fizik për bllokimin/ pezullimin e mallrave për mallrat e bllokuara nga doganierët e kontrollit fizik tëD.D.Rinas, veprime në kundërshtim me Nenin 285, pika 3,4,5 të VKM 1090/2015, veprime në kundërshtim me Nenin 285, pika 3,4,5 të VKM 1090/2015.

a) Nuk u paraqit procesverbal për shkatërrimin me procedurë të përshpejtuar të mallrave të konfirmuara si fallco “karrikues” 330 copë dhe “data kabëll” 612 copë, megjithëse është konfirmuar fallciteti i tyre në kundërshtim me kërkesat VKM 1090, dt 28.12.2015, nenit 285 pika 3,4,5. Personi fizik “Mustaf Halilaj” nuk ka bërë deklarata doganore IM 9 .

Nga specialisti i kontrollit paszhdoganimit pranë kësaj dege doganore, nuk u paraqit asnjë dokumentacion shkresor për ndjekjen procedurat ligjore në zbatim të këtij vendimi , referuar neneve respektive mbi procedurën e asgjësimit., në kundërshtim me kërkesat e KD dhe Vendimit Administrativ Nr. 51, protokolluar, datë 10.11.2017

◆ Në lidhje me Vendimin Administrativ Nr. 67, protokolluar me nr. 4233 prot, datë 13.12.2017 për subjektin “Art-Klierg” me NIPT L71628006T, ka vendosur:

-Konfiskimin e mallrave të konfirmuara si fallco me përshkrimin “çanta” 102 copë të markës “Louis Vuiton” .

-Shkatërrimin/ asgjësimin e këtyre mallrave të cilat janë çenuese të të drejtave të pronësisë industriale të markës “Louis Vuiton” .

-Ndjekjen e procedurave ligjore për shkatërrimin e mallit në zbatim të këtij vendimi , konform rregullimeve ligjore mbi procedurën e asgjësimit.



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

-Shpenzimet për shkatërrimin e mallrave i ngarkohen deklaruesit.

-Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nga praktika dokumentare dhe të dhënat e sistemit asicuda rezulton se:

Në D.D.Rinas nga agjencia doganore “A&A Internacional” është deklaruar për zhdoganim deklarata doganore IM 4 R-26175, datë 14.11.2017, për llogari të subjektit “Art-Klierg” me NIPT L71628006T për “ora dore me bateri për rritur” dhe “çanta inkeliti për gra” me vlerë 3,304 USD, me vend origjine dhe dërgues nga Kina. D.D.Rinas bazuar në dyshimin e arsyeshëm mbi falsitetin e mallrave të importuara ka njoftuar subjektin për pezullimin e çlirimit të mallrave me shkresën nr. 3775, datë 16.11.2017. Me shkresën e datës 18.09.2017 përfaqësuesi ligjor i mbajtësve të së drejtës “Samsung Electronics Co.Ltd” dhe si person kontakti kofirmohet fallciteti i mallrave të pezulluara, duke kërkuar vazhdimin e procedurave. për kryerjen e procedurës së verifikimit sipas KD dhe VKM për dispozitave zbatuese të KD. Me shkresën e përfaqësuesit ligjor i mbajtësve të së drejtës “Louis Vouiton”, protokolluar me nr. 4163, 11.12.2017 është konfirmohet fallciteti i mallrave të pezulluara, duke kërkuar vazhdimin e procedurave. Nga dokumentacioni në dosje rezulton se personi fizik “Art-Klierg” nuk ka kundërshtuar vendimin pranë autoriteteve doganore. Me shkresën nr. 4291, datë 18.12.2017 është mbajtur proces verbal “Mbi shkatërrimin e mallrave cënuese të së drejtës së pronësisë intelektuale”

Nga auditimi u konstatuan këto të meta dhe mangësi:

Nuk u paraqit procesverbal apo akt konstatim dhe evidencë e kontrollit fizik për bllokimin/pezullimin e mallrave për mallrat e bllokuara nga doganierët e kontrollit fizik të D.D.Rinas, veprime në kundërshtim me Nenin 285, pika 3,4,5 të VKM 1090/2015.

Mallrat e bllokuara nuk janë magazinuar gjatë periudhës së pezullimit të çlirimit apo ndalimit të, sipas rregullave që duhet përcaktohen nga autoritetet doganore, veprime në kundërshtim me VKM 1090, dt 28.12.2015, Neni 120/3.

Është mbajtur procesverbal për shkatërrimin nr. 4291, datë 18.12.2017, për sasinë 102 copë çanta markë e mbrojtur.

Personi fizik “Art-Klierg” me NIPT L71628006T është bërë deklarata doganore IM 9 për shkatërrim mallrave markë e mbrojtur.

Nuk është bërë korrigjimi/ rregullimi i situatës nga specialisti i kontrollit paszhdoganimit, në kundërshtim me kërkesat e KD dhe Vendimit Administrativ Nr. 34, protokolluar, datë 19.07.2016

Në përfundim :

Nga auditimi i dokumentacionit shkresor në praktikat e vendimeve të nxjerra nga autoriteti vendimmarrës DD Rinas rezulton se

1-procesverbali i bllokimit, akt konstatimi dhe evidencë e kontrollit fizik për bllokimin i mbajtur për pezullimin e mallrave për mallrat e bllokuara nga doganierët e kontrollit fizik të D.D.Rinas, apo grupi i antikontrabandës , nuk janë protokolluar në zyrën e protokoll arshivës.

-Mallrat e bllokuara nuk janë magazinuar, veprime në kundërshtim me nenin 120/3 dhe nenin 285, pika 3,4,5 të VKM 1090/2015.

-Nuk ka mbajtur procesverbal për shkatërrimin e mallrave të konfirmuara si fallco, megjithëse është konfirmuar fallciteti i tyre, në kundërshtim me kërkesat VKM 1090, dt 28.12.2015, neni 285 pika 3,4,5. Nga disa subjekte nuk është bërë deklarata doganore IM 9, veprime në kundërshtim me KD.

-Nga specialisti i kontrollit paszhdoganimit pranë kësaj dege doganore, në disa raste nga aposteriori nuk është bërë korrigjimin/ rregullimin e situatës, veprime në kundërshtim me kërkesat e KD dhe Vendimit Administrativ të nxjerrë nga autoriteti doganor.



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

-Nga DDRinas për mallrat, për të cilat është pezulluar çlirimi i tyre apo janë sekuestruar, për arsye se dyshohen se çënojnë një të drejtë të pronësisë intelektuale, duhet ruhen nën mbikëqyrje doganore, në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit Doganor.

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 3, datë 02.03.2018 dhe për këtë çështje subjekti i audituar, ka bërë komente dhe shpjegime me shkresën nr. 1347/7 Prot KLSH datë 25.04.2018 dhe shkresën nr. 1597 prot DDRinas datë 24.04.2018.

Me shkresën nr. 1486 prot DDRinas datë 19.04.2017 i është kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe konkretisht Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Pronësisë Intelektuale dhe Drejtorisë Juridike kërkesë për përgatitjen e një Udhëzimi për të përcaktuar qartë veprimet procedurale gjatë procesit të konstatimit dhe veprime të tjera që kryhen për ndalimin dhe asgjësimin e mallrave të dyshuara apo të provuara si të falsifikuara

Gjetje dhe rekomandime nga pika 7 e auditimit
Drejtimi nr. 7 “Të tjera gjatë Auditimit”:

Titulli i Gjetjes 1

Zbatimin e legjislacionit doganor në përputhje me në VKM Nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar me VKM nr. 1090, datë 28.12.2015 , Titulli IX “Për mallrat e falsifikuara dhe mallrat pirate”

Situata:

Nga auditimi i procedurave administrative të ndjekura nga Autoriteti Doganor Rinas gjatë procedurave të shkatërrimit të mallrave piratë që ndalohet të hyjnë në kundërshtim me të drejtën e markave të mbrojtura në RSH u konstatua se dokumentacioni justifikues për bllokimin dhe pezullimin e hedhjes në qarkullim të mallrave të bllokuara nga doganierët e kontrollit fizik të D.D.Rinas nuk ishte i plotë, nuk janë protokolluar në zyrën e protokoll arshivëskëto akte, si dhe nuk janë magazinuar mallrat duke kryer veprime në kundërshtim me nenin 120 pika 3, nenin 285 pika 3,4,5 të VKM nr. 1090/2015 Titulli IX “Për mallrat e falsifikuara dhe mallrat pirate” si dhe nuk është mbajtur procesverbal për shkatërrimin e mallrave të konfirmuara sipas procedurës doganore tëshkatërrimitIM 9.

Kriteri

Konstatohen veprime nga personeli përpunues doganor jo në përputhje me përcaktimet ligjore në ligjin 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i RSH”, Neni 11 pika 5, neni 118, neni 119, neni 120; Neni 82 pika 4; Neni 285 pika 3,4,5 Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor në RSH” përcaktimet ligjore të bëra në VKM Nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, ndryshuar me VKM nr. 1090, datë 28.12.2015 , Titulli IX “Për mallrat e falsifikuara dhe mallrat pirate”, Neni 11 pika 5, neni 118, neni 119, neni 120; Neni 82 pika 4; Neni 285 pika 3,4,5 Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor në RSH”.

Ndikimi/Efekti

Moszbatim procedurash doganore të njohura me ligj dhe akte normative.

Rëndësia

E lartë.

Rekomandimi

Dega Doganore Rinas nëpërmjet personelit përpunues doganor të zbatojë në mënyrë korrekte dhe me përgjegësi të plotë procedurat e shkatërrimit të mallrave piratë që ndalohet të hyjnë në kundërshtim me të drejtën e



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

markave të mbrojtura në RSH duke kryer të gjitha detyrimet ligjore që lidhen me bllokimin, pezullimin, ndalimin e hedhjes në territorin doganor Shqiptar të mallrave piratë dhe të ndaluar dhe shkatërimin e tyre, bazuar në nenin 120 pika 3, nenin 285 pika 3, 4, 5 të VKM nr. 1090/2015 Titulli IX “Për mallrat e falsifikuara dhe mallrat pirate” si dhe në rastet e konstatimit të moskryerjes së kësaj procedure të detyrueshme doganore të nxirren përgjegjësitë konkrete të personelit përpunues doganor përmospërbushje të detyrave funksionale të ngarkuara nga legjislacioni doganor në fuqi.

Menjëherë

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si *më poshtë*:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se nuk rezultoi e zbatuar një masë për shpërblim dëmi e rekomanduar më parë në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr. 1112/8 prot, datë 31.03.2016, protokolluar pranë Degës Doganore Rinas me shkresën nr. 1084 prot, datë 05.04.2016 për subjektin “Agjencia Kombëtare e Bregdetit” me NIPT L41417451U për thyerjen e afatit të RLP-së është rekomanduar një kontabilizimi i njëdetyrim doganor në shumën 2,992,952 lekë dhe një gjobë sa njëfishi i detyrimit doganor, me një detyrim doganor për kontabilizim në shumën totale **5,985,904 lekë**.

Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 14-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit:

1.1 Rekomandimi Dega Doganore Rinas në cilësinë e organit administrativ juridiksional të analizojë rekomandimin e pazbatuar duke marrë masa të menjëhershme si dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme verifikuese administrative dhe ligjore me qëllim kontabilizimin e shumës prej 5,985,904 lekë, rekomanduar më parë në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr. 1112/8 prot, datë 31.03.2016, protokolluar pranë Degës Doganore Rinas me shkresën nr. 1084 prot, datë 05.04.2016.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i ushtruar mbi programimin dhe realizimin e të ardhurave doganore gjatë periudhës së audituar të viteve 2016 dhe 2017 u konstatua se nga Dega e Doganës Rinas nuk janë realizuar të ardhurat doganore në krahasim me programimin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, duke krijuar një diferencë të përgjithshmenë vlerën 239,029 mijë lekë, të cilat lidhen edhe me rënien e importeve të produkteve që zënë peshën kryesore në realizimin e të ardhurave, si programe software, licenca elektronike, importe nga ana e kompanive të telefonisë celulare në Shqipëri si dhe rënies së importeve të produkteve që kontraktohen nga institucione shtetërore për blerje që lidhen kryesisht me pagesa detyrimesh doganore në trajtën e detyrimeve të TVSH-së.

Trajtuar më hollësisht në faqet 27-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit:

2.1 Rekomandimi. Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas në vijim të marrë masa të plota ligjore e administrative me plane konkrete për të analizuar në mënyrë të përditësuar rritjen e mundësive mbikëqyrëse dhe kontrolluese gjatë deklarimeve doganore në funksion të realizimit të plotë të të ardhurave doganore të planifikuara më parë sipas programimit të kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave sipas zërave respektive që lidhen me arkëtimin e detyrimeve të TVSH-së, detyrimeve të pagesës së tarifës doganore, detyrimeve të pagesës të mallrave të akcizës dhe të tjera të ardhura doganore, për përmbushjen e misionit që i është ngarkuar sipas ligjit nr. 8449, datë 20.01.1999 “Kodi Doganor në RSH” i ndryshuar dhe ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi i Ri Doganor në RSH” i ndryshuar,



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

duke nxjerrë dhe përgjegjësitë përkatëse të stafit doganor në përputhje me funksionet që ata kryejnë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi mbi sistemin e vlerësimit dhe klasifikimit tarifor të mallrave u konstatua se nga personeli përpunues doganor nuk janë marrë në konsideratë përcaktimet ligjore të shpjegimeve të Udhërrëfyesit të MSABE “*Mbi Rregullat e Origjinës Preferenciale të përdorura në tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe Vendeve të tjera sipas Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë*” dalë sipas ligjit nr. 9590, datë 27.07.2006 duke mos dërguar për verifikim doganor Deklaratat Faturë dhe Certifikata Eur 1 sipas praktikave të evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit bazuar edhe në Udhëzimin nr. 2077 prot datë 06.08.2010 “*Mbi rregullat e Origjinës*”, neni 22 “*Kushtet për bërjen e një deklarate faturë*” pika 2, 3 4, 5 dhe 6.

Trajtuar në faqet nr.32-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit;

3. Rekomandimi. Dega Doganore Rinas të ndjekë të gjitha rrugët ligjore me qëllim verifikimin e dokumentacionit tregtar EUR.1 dhe Deklaratave Faturë të përdorur për përfitimin e kushtit të origjinës preferenciale MSABE dhe MTLTR pranë Autoriteteve Doganore Homologe sipas rasteve të përmendura në këtë Raport Përfundimtar Auditimi për 5 (pesë) raste, nga të cilat dy raste dërguar për verifikim pranë Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës pranë DPD, dhe bazuar në përcaktimet e nenit 84-90 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “*Kodi i Ri Doganor në RSH*” i ndryshuar, të kërkojë dhe garanci të borxhit doganor që mund të lindë për deklarime doganore të evidentuara sa më sipër deri në përfundim të verifikimit që do të kryhet nga Administrata Doganore Shqiptare pranë Autoriteteve Doganore Homologe

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi dhe analiza kryer mbi situatën e borxhit doganor gjendje, krijuar gjatë viteve deri në periudhën e fundvitit 2017 u konstatua se nga autoriteti doganor kompetent, reflektohet një gjëndje borxhi doganor në fund të periudhës së audituar në vlerën 2,186 mijë lekë për 21 raste debitorësh borxhi për 18 shoqëri tregtare nga të cilët 8 raste debitorësh mbuluar me urdhëra ekzekutimi nga organet gjyqësore në shumën 1,436 mijë lekë në fazë rikuperimi me forcë nga shërbimi përmbarimor privat dhe 13 raste debitorësh në shumën 750 mijë lekë të cilët janë në fazë ankimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave sipas përcaktimeve ligjore që njeh Kodi Doganor në RSH dhe për të cilët nuk mund të kërkohej rikuperimi me forcë i borxhit doganor deri në përfundim të procedurës ankimuese.

Trajtuar në faqet nr. 60-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit;

4.1 Rekomandimi. Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas të marrë masa të plota ligjore e administrative për rikuperimin e borxhit doganor të krijuar gjatë periudhës së viteve 2009 deri në periudhën 31.12.2017 në vlerën totale 2,186 mijë lekë, si dhe të hartojë një program konkret me persona përgjegjës dhe afate kohore konkrete për rikuperimin e borxhit në vijimësi duke bashkëpunuar intensivisht me të gjitha institucionet e ngarkuara sipas ligjit për rikuperimin e shumës së borxhit të mësipërm, bazuar në ligjin nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “*Kodi i Ri Doganor në RSH*”, Udhëzimin nr. 4, datë 07.04.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave “*Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës*”.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i procedurave administrative të ndjekura nga Autoriteti Doganor Rinas gjatë procedurave të shkatërrimit të mallrave të falsifikuara që ndalohej të hyjnë në kundërshtim me të drejtën e markave të mbrojtura në RSH, u konstatua se dokumentacioni justifikues për bllokimin dhe pezullimin e hedhjes në qarkullim të mallrave



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

nuk ishte i plotë, nuk rezultoi në protokolluar në zyrën e protokoll arshivës këto akte duke kryer veprime në kundërshtim me nenin 120 pika 3, nenin 285 pika 3, 4, 5 të VKM nr. 1090/2015 Titulli IX “Për mallrat e falsifikuara dhe mallrat pirate”, si dhe nuk është mbajtur procesverbal për shkatërrimin e mallrave të konfirmuara sipas procedurës doganore të shkatërrimit Imp 9.

Trajtuar në faqet nr. 77-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit;

5.1 Rekomandimi. Dega Doganore Rinas nëpërmjet personelit përpunues doganor të zbatojë në mënyrë korrekte dhe me përgjegjësi të plotë procedurat e shkatërrimit të mallrave piratë që ndalohet të hyjnë në kundërshtim me të drejtën e markave të mbrojtura në RSH, duke kryer të gjitha detyrimet ligjore që lidhen me bllokimin, pezullimin, ndalimin e hedhjes në territorin doganor Shqiptar të mallrave piratë dhe të ndaluar, bazuar në nenin 120 pika 3, nenin 285 pika 3, 4, 5 të VKM nr. 1090/2015 Titulli IX “Për mallrat e falsifikuara dhe mallrat pirate”, si dhe në rastet e konstatimit të moskryerjes së kësaj procedure të detyrueshme doganore të nxirren përgjegjësitë konkrete të personelit përpunues doganor për mospërbushje të detyrave funksionale të ngarkuara nga legjislacioni doganor në fuqi.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i procedurave administrative të ndjekura nga Autoriteti Doganor Rinas u konstatua se dy subjekte me NIPT K51724025E dhe me NIPT K51723037A kanë tejkalluar afatet autorizuese për mallra të futura dhe të autorizuara brenda përcaktimeve të regjimeve të lejimit të përkohshëm. Nga Dega Doganore Rinas për deklarimet e regjimeve RLP që rezultojnë në shkelje të afateve autorizuese, janë vendosur sanksionet administrative deri në 100% të detyrimit doganor statistikor të deklaruar sipas deklaratave doganore respektive, bazuar në nenin 256 dhe 273 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Autoriteti Doganor Rinas pasi ka vendosur sanksione administrative ndaj operatorëve të autorizuar, nuk ka kërkuar dhënien e destinacionit të ri doganor nga operatorët e mësipërm si dhe nuk ka ndërmarrë veprime të mëtejshme bazuar në nenin 83 dhe 160 të Kodit Doganor në RSH, me qëllim dhënien e destinacionit përfundimtar doganor për mallrat e hyra në territorin doganor shqiptar me deklarime doganore IMP5 sipas procedurave 5300 dhe 5500, sipas të dhënave të deklaratave doganore të pranura me një shumë statistikore të detyrimit doganor në vlerën 4,752,118 lekë.

Trajtuar në faqet nr. 65-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit;

6.1 Rekomandimi. Dega Doganore Rinas në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, bazuar në nenin 83 dhe 160 të KD të vlerësojë situatën doganore të konstatuar sa më sipër, në funksion të afateve autorizuese të shkelura nga subjektet me NIPT K51724025E dhe NIPT K51723037A, me qëllim kërkimin e dhënies së destinacionit përfundimtar doganor të mallit të autorizuar sa më sipër me një shumë statistikore të detyrimit doganor në vlerën 4,752,118 lekë sipas të dhënave të deklaratave doganore IM 5 me procedurë doganore 5500 dhe 5300. Gjithashtu të ndiqet nga nëpunësi doganor mbikëqyrës i autorizimeve doganor të regjimeve të lejimit të përkohshëm, dhënia dhe ndjekja përfundimtare e destinacionit të ri doganor të mallrave të përfshira në autorizimet e mësipërme, me qëllim mbylljen ose shtyrjen e procedurës doganore autorizuese në mbikëqyrje nga Dega e Doganës Rinas për mallrat e përfshira në këto autorizime.

Menjëherë

7. Gjetje nga Auditimi. Nga auditimi i procedurave doganore të vlerësimit dhe klasifikimit tarifor të mallrave u konstatuan në fazën audituese klasifikime të gabuara tarifore për mallra të natyrës mbajtës plastikë për të cilët u lanë rekomandime për riklasifikime në kodin tarifor



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE RINAS”

39231090 trajtuar me tarifë doganore bazë 6% dhe ndjekje të kontabilizimit të detyrimeve doganore në shumën 328 mijë lekë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit tregtar bashkëngjitur observacioneve të ardhura nga subjekti me Nipt K01621002N dhe subjekti me Nipt K621210390 gjatë fazës së përgatitjes së Raportit Përfundimtar të Auditimit u konstatua se mallrat e mësipërm janë të natyrës ekspozitorë plastikëtë klasifikuar në kodet tariforë *39269000* dhe *3926909790* trajtuar me tarifë doganore bazë 0% sipas dokumentacionit të deklaratave doganore të eksportit dhe kodeve tariforë faturat e mallit për çdo rast importi të kryer nga këta operatorë, në ndryshim nga konstatimi i mbajtur për trajtimin me tarifë doganore bazë 6% gjatë procedurës audituese.

Trajtuar në faqet nr. 32-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit;

7.1 Rekomandimi. Dega Doganore Rinas për subjektin me Nipt K01621002N dhe subjektin me nipt K621210390 të cilët kanë kryer transaksione nga vende të Komunitetit Evropian, në zbatim të pikës 3, 4 dhe 5 të shpjegimeve të Udhëzimit nr. 25 datë 16.05.2006 të MF, “*Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore*” të rikërkojë ndjekjen e procedurave doganore verifikuese pranë Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës në DPD, për verifikimin e plotë dhe të garantuar të klasifikimit të saktë tarifor të këtyre mallrave sipas deklarimeve nga prodhuesi, eksportuesi ose lëvruesi i mallit për praktika doganore të trajtuara në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit me detyrime doganore të konstatuara me efekt financiar në shumën 328 mijë lekë.

7.2 Rekomandimi. Dega Doganore Rinas nëpërmjet sektorit të kontrollit pas zhdoganimit bazuar në nenin 47, 48 dhe 49 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar, të kryejë veprime verifikuese doganore pranë selive të ushtrimit të aktivitetit të kompanive dhe pranë regjistrave të kontabilitetit financiar të kompanive me Nipt K01621002N dhe Nipt K621210390 bazuar në përcaktimet e pikës 1 dhe 2 të nenit 49, për saktësime të informacionit të dhënë në deklaratat doganore që lidhen me problemet e trajtuara më hollësisht në këtë Raport Përfundimtar Auditimi dhe të konstatuara më parë me detyrime doganore me efekt financiar në shumën 328 mijë lekë.

Menjëherë

B. MASA SHPERBLIM DEMI

